

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



RAPORTI VJETOR 2014

Shkup, prill 2015

Përkthim në gjuhën shqipe: Grupi punues i Fakultetit të biznesit dhe ekonomisë pran
Universitetit të Evropës Juglindore Tetovë.

Përmbajtja

Fjala e guvernatorit	4
I. Politika monetare në vitin 2014	7
II. Ambienti ekonomik ndërkombëtar.....	15
III. Lëvizjet makroekonomike gjatë vitit 2014	19
3.1. PBB dhe inflacioni	19
3.2. Tregu i punës	22
3.3. Financat publike.....	24
3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm	28
3.5. Agregat monetar dhe kreditor	33
IV. Ambienti makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2015 dhe 2016	38
V. Instrumentet monetare	42
5.1. Bonot e thesarit	42
Shtojca 1. Shqyrtimi flukseve të krijimit dhe tërheqjes së likuiditetit në vitin 2014.....	43
5.2. Depozitat dhe kreditë në dispozicion në Bankën popullore.....	44
5.3. Rezervat e detyrueshme	45
5.4. Operacione-repo për krijimin e likuiditetit në sistemin bankar	48
5.5. Mjetet e sigurimit të zbatimit të operacioneve monetare	48
Shtojca 2. Tregu i parave.....	48
VI. Menaxhimi i rezervave valutore	51
6.1. Udhëzime bazë për menaxhimin e rezervave të huaja	51
6.2. Kushtet për investime në tregjet financiare ndërkombëtare në vitin 2014	52
6.3. Investimi në rezerva valutore të huaja	54
6.3.1. Struktura valutore	55
6.3.2. Ekspozimi kreditor dhe likuiditetit të investimeve.....	55
6.3.3. Rezultatet nga investimi i rezervës valutore	57
VII. Roli i Bankës popullore në sistemin e pagesave.....	59
Shtojca 3. Trendet në pagesat jomonetare.....	61
VIII. Emetimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike në Republikën e Maqedonisë	64
8.1. Monedha në qarkullim.....	64
8.2. Furnizimi i bankave me kartëmonedha dhe monedha metalike.....	65
8.3. Përpunimi dhe riciklimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike	66
8.4. Ekspertiza për paratë të dyshimta/ falsifikuara.....	66
8.5. Shitja e monedhave metalike për çështje koleksionimi.....	67
IX. Statistika	68
X. Funkcioni mbikëqyrës dhe rregulator i Bankës popullore	71
10.1. On-site dhe off-site mbikëqyrje	71
XI. Auditimi i brendëshëm	74
XII. Përmirësimi i kapacitetit institucional i Bankës popullore	75
12.1. Planifikimi strategjik	75
12.2. Menaxhimi me rreziqet operative dhe sigurimi i vazhdimësisë në punë	75
12.3. Administrimi i burimeve njerëzore	76
12.4. Veprimtaria kërkimore.....	78
XIII. Aktivitete tjera	79
13.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar	79
13.2. Marrëdhëniet me publikun	80
13.3. Edukimi financiar	80
13.4. Veprimtari muzeore, bibliotekare dhe historike-arkivore.....	81
13.5. Zhvillimi në fushën e teknologjisë informative	82

Fjala e guvernatorit

Të nderuar,

Ashtu si në vitet e mëparshme, edhe 2014-ta ishte vit i pritshmërive tona për rimëkëmbjen e ekonomisë globale pas krizës. Nga ky aspekt, duhet të theksohet rimëkëmbja e shpejtë e ekonomisë amerikane kundruall asaj evropiane, e ndjekur nga rregullimet përkatëse në politikat e tyre monetare. Një karakteristikë tjetër e ambienti global ishte edhe rënia e çmimeve të naftës në tregun botëror, gjë që bëri ngadalësimin e inflacionit në nivel global, të ndikuar kryesisht nga faktorë të ofertës. Pritet që çmimet e ulëta të produkteve primare, ritmi i filluar i dobësimit të euros dhe lehtësimi sasior me bazë më të gjerë në eurozonë nga marsi i vitit 2015, të ndihmojnë në rimëkëmbjen e ekonomisë evropiane. Megjithatë, rreziqet për rimëkëmbjen globale dhe qarkullimi i çmimeve të produkteve themelore që ishin të pranishme në vitin 2014, pritet të mbeten edhe gjatë vitit 2015.

E rrethuar nga një zhvillim i jashtëm tejet dinamik dhe i pasigurt, ekonomia e Maqedonisë në vitin 2013 dhe në vitin 2014 arriti të bëjë një ndarje të dukshme të dinamikës së rritjes në krahasim me atë që e imponon rritja e vendeve të cilët i kemi partnerë kryesorë tregtarë. Kështu, pavarësisht nga mëkëmbja e brishtë e kërkesës efektive nga jashtë, në vitin 2014 ekonomia e Maqedonisë në mënyrë solide e ka përshpejtuar rritjen reale të PBB-së për 3.8%. Kjo rritje është mbështetur kryesisht nga shtytësit e brendshëm, para së gjithash, nga investimet dhe eksporti. Në kuadër të investimeve duhet të theksohet kontributi i investimeve publike, veçanërisht në infrastrukturë, si dhe investimet e huaja direkte. Rritja e eksportit dhe reduktimi i deficitit tregtar kryesisht e reflekton efektin e kompanive të reja me kapital të huaj në zonat zhvillimore teknologjike industriale, të cilat i kanë tejkaluar pritjet në projeksionet tona. Lidhur me performancën makroekonomike, është e rëndësishme të përmendet rënia mëtejshme graduale e shkallës së papunësisë, si dhe fakti se në vitin 2014 u arrit rritje e produktivitetit të punës.

Në përgjithësi, ambienti në të cilin zhvillohej politika monetare ishte i favorshëm, megjithatë mjaft kompleks. Gjatë vitit 2014 inflacioni shënoi një ritëm të ngadalësuar, në mënyrë që në tremujorin e dytë hyri në zonën e ndryshimit negativ vjetor duke u reduktuar mesatarisht në 0.3% në vit. Ngadalësimi i inflacionit ishte rezultat kryesisht i faktorëve në anën e ofertës, veçanërisht në kontributin negativ të çmimeve të ushqimit dhe karburanteve, në kushtet e vlerësimit të hendekut prodhues negativ dhe pritjet për mbylljen e tij në fund të vitit 2014. Njëkohësisht, inflacioni bazë, përjashtuar ushqimin dhe energjinë, në vitin 2014 ishte mesatarisht 0.5%, edhe pse nga fundi i vitit hyri në zonën e ndryshimeve negative vjetore. Gjatë vitit 2014, tregu valutor në esencë mbeti i balancuar, me një sasi relativisht të vogël të ndërhyrjeve në bazën neto. Niveli i rezervave valutore dhe treguesit për përshtatshmërinë e tyre gjatë vitit janë mbajtur në nivel kënaqshëm. Politika fiskale edhe në vitin 2014 e ka ruajtur karakterin stimulues dhe dukshëm e ka mbështetur rimëkëmbjen ekonomike. Gjithashtu, mbështetja kreditore nga ana e sektorit bankar gjatë vitit është forcuar, midis tjerash duke i reflektuar perceptimet e bankave për reduktimin e rreziqeve.

Në kushtet e tilla, analizat e rregullta të faktorëve të cilët ndikojnë në vendimet monetare gjatë vitit, vënë në dukje se autoritetet monetare kanë siguruar një stimul të mjaftueshëm monetar duke pasur parasysh edhe gërshetimin e gjithmbarshëm të rrethanave në ekonomi dhe zhvillimet e jashtme, norma bazë e interesit ka mbetur e pandryshuar. Domethënë, politika monetare e Bankës popullore në vitin 2014 dallonte nga politika monetare në eurozonë, si ekonomia-spirancë, në përputhje me ndarjen e ciklit

ekonomik në ekonominë e vendit nga cikli në euro-zonë. Nga ana tjetër, për të forcuar efektet e aplikimit të instrumenteve monetare dhe riorientimin e mëtejshëm të likuiditetit të tepërt në sektorin bankar për të mbështetur ekonominë, u bënë ndryshime te një pjesë e instrumenteve të tjera monetare. Në fakt, duke pasur parasysh interesin e vazhdueshëm të bankave për investimin e mjeteve në fondin e depozitave, që është në kundërshtim me funksionin e tyre themelor të instrumentit për rregullimin, që bërë ulja graduale e normave të interesit dhe, njëkohësisht që rishikuar edhe mekanizmi i vlerësimit të kërkesës potenciale në ankandet e bonove të thesarit dhe riorientimi i kërkesave të tepërta në fondin valutor pa interes. Gjithashtu, në shtator që zgjatur vlefshmëria e masës për lirim nga obligimet për rezerva të detyrueshme të kredive të reja në sektorin e eksportit dhe të energjisë në mënyrë të mbështetjes së mëtejshme të rritjes kreditore.

Ndër lëvizjet më të rëndësishme monetare gjatë vitit 2014 duhet të veçohet procesi i mëtejshëm i de euroizmit, si dhe përshpejtimi i rritjes kreditore për sektorin privat. Në vitin 2014, vazhdon ritmi i rritjes së pjesëmarrjes së denarit në depozitat e përgjithshme, në përputhje me derdhjet më të larta të instrumenteve në denarë, duke treguar njëkohësisht besueshmërinë e autoritetit monetar. Rritja e kredisë në fund të vitit 2014 arriti në 10%, e cila ishte mbi pritjet e projeksioneve tona të fundit. Gjithashtu, vlen të theksohet ringjallja e rritjes kreditore ndaj ndërmarrjeve, e cila është veçanërisht e rëndësishme për përshpejtimin e mëtejshëm të investimeve dhe ekonomisë. Në përgjithësi, sistemi bankar e ruajti stabilitetin dhe kapitalizmin e lartë, ndërsa cilësia e portofolit të kredisë ka mbetur pothuajse i pandryshuar në krahasim me vitin e kaluar, me pjesëmarrjen e kredive jofunksionale në plasmanin e përgjithshëm të sektorit jo-financiar me 11.3%. Dhe në vitin 2014, vazhduan përpjekjet për forcimin e mëtejshëm dhe përmirësimin e mbikëqyrjes bankare si dhe zbatimin e kërkesave rregullatore ndërkombëtare në fushën e bankave.

Forcimi i kapaciteteve institucionale në të gjitha fushat e operimit, është një nga prioritetet kryesore të Bankës popullore. Në këtë kuadër, investimet në burimet njerëzore nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm dhe përforcimit të burimeve njerëzore zënë një vend të veçantë. Gjithashtu, promovimi i aktiviteteve kërkimore dhe mbështetja e projektit për edukim financiar kanë efekte më të gjera pozitive në ekonominë në tërësi. Aktivitetet e përhershme për shqyrtimin në kohë dhe menaxhimin efektiv të rreziqeve në punën operacionale kontribuojnë në arritjen e rezultateve më të mira në punë dhe për një gatishmëri më të madhe për t'u përballur me sfidat në të ardhmen.

Marrë në përgjithësi, viti i kaluar (2014) rishtas i nxori në pah rreziqet e zhvillimeve të jashtme të pandryshueshme, të përforcuar nga rreziqet gjeopolitike dhe paqëndrueshmëria e tregjeve financiare. Në kushte të tilla, vlen të përmenden ndryshimet strukturore në ekonominë e vendit, që priren drejt diversifikimit gjithnjë e më të madh të eksportit, forcimit të pozitës konkurruese dhe, në këtë mënyrë, për një ekonomi më të qëndrueshme ndaj goditjeve të jashtme. Për shkak të gjitha këtyre, duhet të kenë prioritet edhe më tej reformat strukturore në të gjitha sferat e ekonomisë.

Gjatë vitit 2014 politika monetare e ka ruajtur fleksibilitetin e saj në ambientin e tanishëm dhe në kushtet e ruajtjes së stabilitetit të kursit të këmbimit dhe në presionet e ulëta inflacioniste të kushtëzuara nga faktorët e ofertës, edhe më tepër ka mbështetur rritjen kreditore, kryesisht nëpërmjet zbatimit të masave jomonetare dhe ndryshimeve në instrumentet e tjera. Sektori bankar në vitin 2014, në kushtet e ruajtjes së stabilitetit dhe burimeve solide të financimit, tregoi përgjegjshmëri të fortë në ofertën e kredisë. Megjithatë, bankat edhe më tej e kanë ruajtur interesin e plasmanëve pa rrezik me bankën popullore, që në likuiditet solid, krijon hapësirë për një kreditim më të madh të sektorit privat. Ruajtja e normave solide të rritjes kreditore, si dhe ballafaqimi me sfidat e kërkesave

të reja rregullatore në suaza globale, vazhdojnë të jenë sfida kryesore në sektorin bankar në periudhën e ardhshme. Në fushën e menaxhimit të rezervave valutore, në kontekst të zhvillimeve dinamike të tregjeve financiare ndërkombëtare, mbetet sfida për të ruajtur fleksibilitetin e ndryshimeve të tregut dhe forcimin e ekspertizës profesionale në përzgjedhjen përkatëse të mundësive investuese.

Zhvillimet dinamike të jashtme, rreziqet shoqëruese dhe ndikimi i tyre i mundshëm në ekonominë e vendit, duke përfshirë edhe pozicionimin e politikave të tjera makroekonomike imponojnë nevojën për analiza gjithëpërfshirëse dhe kujdes në drejtimin e politikës monetare edhe në të ardhmen. Banka popullore mbetet e gatshme për monitorimin e rregullt, reagimin në kohë dhe përshtatjen e politikave që synojnë arritjen e objektivave kryesorë dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik.

Shkup, prill 2015

*Guvernator dhe kryesues
i Këshillit të BPRM-së
Dimitar Bogov*


I. Politika monetare në vitin 2014

1.1. Objektivat e politikës monetare


Ruajtja e stabilitetit të çmimeve paraqet objektivin kryesor ligjor të politikës monetare të BPRM. Objektivi tjetër i BPRM i cili është në varësi të objektivit kryesor, është të kontribuoj drejtë ruajtjes së sistemit financiar stabël, konkurrues dhe orientues kah tregu. BPRM e mbështet politikat e përgjithshme ekonomike pa rrezikuar arritjen e objektivit kryesor dhe në përputhje me parimin e ekonomisë së hapur të tregut me konkurrencë të lirë. Në aspekt strategjik, nga shtatori i vitit 1995 BPRM e aplikon strategjinë e ruajtjes stabël të kursit nominal të këmbimit të denarit, gjer më vitin 2001 në raport me markën gjermane dhe më pas në raport me euron.

Nisur nga dispozitat ligjore, BPRM edhe për gjatë vitit 2014 e përshtati politikën monetare për të arritur vazhdimësi në arritjen e qëllimeve monetare. Objektivat e politikës monetare u realizuar me sukses, siç shihet nga ruajtja e mëtejshme e stabilitetit të çmimeve, stabilitetit të kursit të këmbimit, e në të njëjtën kohë duke mbajtur ambientin e përshtatshëm për aktivitetet ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Në përgjithësi kursi i këmbimit ishte stabël, ndërsa BPRM intervenoi në tejkalimin e mospërputhjeve të përkohshme në mes ofertës dhe kërkesës së valutave. Gjithashtu, kursi i këmbimit ngeli stabël, ndërsa rezervat valutore shënuan rritje. Nga pikëpamja e treguesve të mjaftueshmërisë, edhe për gjatë vitit 2014 rezervat valutore u ruajtën në nivel adekuat, duke siguruar hapësirë të mjaftueshme për të amortizuar shoqet eventuale të papërshtatshme. Në vitin 2014 u arrit normë e ulët dhe pak negative e inflacioni. Për gjatë vitit ndryshimet në inflacionin vendor ishin të shkaktuar kryesisht nga faktorë e anës së ofertës, apo nga çmimet më të ulëta importuese të ushqimit dhe energjisë. Kah fundi i vitit, janë evidentuar rënie të inflacionit bazë, e cila megjithatë mesatarisht ngeli pozitiv. Arritjet e sektorit real vendor ishin të përshtatshme, me çka kërkesa vendore vazhdoi të rimëkëmbet, ndërsa hendeku negativ i prodhimit gradualisht ngushtohej. Prandaj u vlerësua se ka të bëjë me përshtatshmërinë e përkohshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve, e cili nuk krijon rrezikun e zgjatjes së deflacionit dhe të ndikimit eventuale të papërshtatshëm të çmimeve të ulëta në aktivitetin e brendshëm ekonomik në periudhën e ardhshme.

Grafik 1
Hendeku i prodhimit dhe inflacioni*




Grafik 2
Rezervat valutore bruto




* Hendeku i prodhimit paraqet indikatorin për gjendjen ciklike të ekonomisë dhe përlogaritët si raport në mes të shmangies së PBB së realizuar nga PBB potenciale dhe nivelit të PBB potenciale ($GDP_a = \frac{GDP_a - GDP_p}{GDP_p}$). Te inflacioni dhe inflacioni bazë përfaqësohet norma mesatare vjetore në tremujore.

Grafik 3
Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore



Grafik 4
Treguesit e zgjedhur për stabilitetin financiar



* Sipas rregullës së Grinspan dhe Gvidoti (Greenspan-Guidotti rule) është e nevojshme që vendi të ruaj mbulimin e plotë të borxhit afatshkurtër (maturimi rezidual) me rezervat valutore.

** Aktivi likuid përbëhet nga likuiditeti i lartë i aktivitetit dhe depozitave afatshkurtra të afatizuara te bankat e huaja. Aktivi gjithsej nuk i inkorporon mjetet te bankat vendore.

*** Treguesi i referohet kredive kah sektorin financiar dhe jofinanciar.

Burimi: BPRM dhe ESHS.

1.2. Pozicionimi i politikës monetare

Gjatë vitit 2014 BPRM vazhdoi me aplikimin e riaftësimin e politikave monetare duke mbajtur normën bazë të interesit në një nivel të ulët se 3.25%. Gjithashtu, BPRM realizoi ndryshime në instrumentet tjera monetare¹ dhe solli masa të caktuara makroprodente², me të cilat siguroi përkrahje të mëtejme të aktiviteteve kreditore, duke kontribuar në ruajtjen e ambientit të përshtatshëm për rritje ekonomike. Disa nga këto masa ishin me më dedikim, përkatësisht të orientuar kah përkrahja e kreditimit të sektorit korporativ, si segment i kreditimit si një segment të tregut të kredive që shënoi një rikuperim të ngadaltë nga pasojat e krizës globale në krahasim me popullatën. Pikërisht, prania e disa faktorëve jomonetar (në lidhje me pritjet e bankave, vlerësimet për rrezikun e kërkesës për kredi, ndryshimet në cilësinë e portofolit të kredisë, strategjitë e grupimeve bankare amë, dhe të ngjashme), solli gjer te çrregullimi i transmissioinit monetar në vitet pas fazës akute të krizës globale, duke pamundësuar bartjen e plotë të efekteve të masave monetare të ndërmarra gjer më tani ndaj aktiviteteve kredituese. Arritjet gjatë vitit 2014 treguan se këto situata dalëngadalë tejkalohen dhe efikasiteti i transmetimit monetar përmirësohet, me çfarë cikli i relaksimit monetar paraqitet diku ka fundi i vitit 2009 duke kontribuar në rigjallërimin e tregut kreditues dhe në rritjen e përkrahjes kredituese. Ashtu që ka fundi i vitit të kaluar dhe veçanërisht për gjatë vitit 2014, ndryshimet në tregun kreditues ishin në drejtim pothuajse të një përsheptimi të vazhdueshëm të rritjes së kreditimit, veçanërisht kah sektori i korporatave. Karakteri i përshtatshmërisë së politikës monetare ngeli gjatë vitit, në kushte relativisht të përshtatshme të një ambienti makroekonomik. Pikërisht për gjatë vitit 2014 ambienti i aplikimit të politikës monetare karakterizohej me ruajtjen e rritjes së aktiviteteve


¹ Në vitin 2014, BPRM brenda dy herësh u zvogëlua norma e interesit të depozitave të disponueshme në shtatë ditë (shkurt dhe tetor) dhe në një herë u zvogëlua norma e interesit të depozitave të disponueshme brenda natës (në tetor). Si rezultat i kësaj normat e interesit të depozitave të disponueshme brenda natës dhe atyre për shtatë ditë u reduktuan në 0.5% dhe në 1%, përkatësisht. Në shtator, BPRM e revidoi mekanizmin e transmetimit të kërkesës së bonave të thesarit e cila është mbi potencialin të instrumentet tjera, dmth instrumenti depozitat e disponueshme në shtatë ditë sollën vendimin për vazhdimin e aplikimit të masave jostandarde për zvogëlimin e bazës për rezervat e detyrueshme të bankave afariste për vlerën e kredive të reja të aprovuara ndaj neto eksportuesve dhe ndaj prodhuesve vendor të energjisë elektrike. Për më tepër detaje rreth këtyre ndryshimeve, shiko në suazat e pjesës së instrumenteve monetare.

² Në prill, BPRM solli vendim për ndryshim dhe plotësim të metodologjisë për përcaktimin e kapitalit adekuat, e cila krahas aspekteve makroprodente, përmbajnë edhe ndryshime të cilat priten të kontribuojnë pozitivisht në përkrahjen kreditore të subjekteve ekonomike nga ana e bankave afariste.

ekonomike vendoren në kushte të mbajtjes permanente të niveli të duhur të rezervave valutore dhe mungesës së presioneve inflacioniste. Rreziqet ndaj ekonomisë vendore ishin të pranishme gjatë vitit 2014 dhe kryesisht ishin të lidhur me ambientin e jashtëm.


BPRM vazhdoi edhe për gjatë vitit 2014 me vlerësimin e rregullt mujor të pozicionimit të politikës monetare³. Vendimet monetare të cilat u sollën për gjatë vitit u bazuan në projeksionet makroekonomike dhe në bazë të analizave të fundme e të dhënave në dispozicion për treguesit kryesor makroekonomik dhe financiar në vend dhe jashtë vendit dhe rëndësia e tyre në kontekst të projeksioneve. Gjatë analizave u morën parasysh edhe vlerësimi i rreziqeve dhe gjasat e realizimit të tyre dhe në bazën të gjithë këtyre informacioneve u sollën vlerësime për ndikimin ndaj vendosjes së politikës monetare.

Grafik 5
Rishikimet e rritjes ekonomike globale, ndryshimet vjetore, në %



Burimi: Pasqyra ekonomike botërore (PEB) të FMN dhe BQE.

Grafik 6
Rishikimet e rritjes ekonomike në Euro zonë, ndryshimet vjetore, në %



Ambienti global gjatë vitit 2014 ngeli i cenuar, i përcjellur me shkallë të lartë të pasigurisë dhe tendenca rënëse të rreziqeve në raport me pritjet e rritjes ekonomike. Parashikimet paraprake për rritjen ekonomike globale kanë qenë në drejtim të përsheptimit të saj, të bazuar në pritjet për presion të reduktuar nga konsolidimi fiskal dhe përfundimin e procesit të reduktimit të stokut të borxhit financiar të sektorit privat. Mbajtja e përbashkët e një politike monetare më të lirshme në më shumë vende të zhvilluara, pritet që këto faktor të nxisin rritjen dhe të gjenerojnë transmetime pozitive edhe në vendet në zhvillim. Megjithatë, arritjet ishin më të dobëta nga ato të parashikuarat, ashtu që edhe vlerësimet për ambientin global u ndryshuan në tendenca rënëse. Disbalancat e pranishme në më shumë sektor, të akumuluar në periudhën para dhe përgjatë krizës globale, vazhduan të kufizojnë rritjen, duke treguar se për tejkalimin e tyre do të nevojitet një periudhë kohore më e gjatë nga ajo e pritura. Faktori shtesë i rrezikut paraqiten trazirat gjeopolitike kryesisht lidhur me konfliktin ruso-ukrainas. Si rezultat i këtyre lëvizjeve, rritja ekonomike globale për gjatë vitit ishte rishikuar në ulje, një rishikim në ulje pati edhe rritja e euro-zonës si një nga partnerët tonë më të mëdhenj tregtar. Josiguria e ambientit ekonomik dhe tensionet gjeopolitike shkaktuan pasiguri edhe rreth dinamikës së çmimeve të prodhimeve primare, të cilët për gjatë vitit kryesisht kishin karakter rënës. Përveç çmimeve ushqimore dhe energjisë, për gjatë vitit ishin karakteristike edhe trendet e ndryshme për çmimet e metaleve, që në mënyrë shtesë e rritën pasigurinë rreth ndryshimit të kushteve të këmbimit. Në kësi kushte, ambienti global vazhdoi të krijojë rreziqe për ekonominë vendore, duke krijuar pasiguri rreth intensitetit të rimëkëmbjes ekonomike, dinamikës së inflacionit dhe të rezervave valutore. Si rrjedhojë e kësaj, BPRM për gjatë vitit 2014 ka ndjekur nga afër ngjarjet

³ Gjatë vitit 2014 janë mbajtur 12 takime të Komitetit për politikë monetare operative të BPRM, nga të cilat u sollën vendime për nivelin e normës së interesit. Informimet në lidhje me sjelljen e vendimeve për normën e interesit për gjatë vitit janë të disponueshme në linkun vijues: <http://www.nbkm.mk/?ItemID=CB52909D9FD4E14089BD66D493A5AF70>.

globale, duke tentuar në kohë të identifikon rreziqet dhe efektet drejt ekonomisë vendore dhe politikës monetare.


Në suaza të ambientit vendor, politika fiskale paraqet një nga faktorët që merret parasysh gjatë sjelljes së vendimeve monetare. Pozicionimi i saj për gjatë vitit ka pësuar ndryshime të caktuara në raport me ecurinë që ishte paralajmëruar në fillim. Këto ndryshime kishin të bëjnë në madhësinë, por jo edhe në strukturën e deficitit buxhetor. Ashtu që në qershor të vitit 2014 shteti vendosi të ngarkohet me borxh në tregun ndërkombëtar të kapitalit duke lëshuar euro-obligacionin e tretë⁴. Ajo donte të thotë ndryshim në strukturën e financimit krahasuar me buxhetin fillestar, i cili parashikonte mbështetje më të lartë të deficitit buxhetor në burimet financiare vendore. Huazimi i shtetit nga jashtë në mënyrë plotësuese e përkrahu rritjen rezervave valutore, i cili nuk ishte i planifikuar me parashikimet fillestare⁵. Gjithashtu, në shtator u soll rebalanci i Buxhetit për 2014 me të cilin u parashikua zvogëlimi i të hyrave dhe të dalave buxhetore në raport me planin fillestar dhe realizim më të lartë të deficitit buxhetor prej 3.7% të PBB (3.5% të PBB me Buxhetin fillestar). Deficiti buxhetor i realizuar për 2014 ishte më i lartë në raport me parashikimin e rebalancit dhe ishte 4.2% të PBB). Megjithatë, ndryshimet në pozicionin fiskal nuk kanë pasur efekte të rëndësishme mbi mjedisin e përgjithshëm të zbatimit të politikës monetare, me çka edhe për gjatë vitit 2014 ishte siguruar koordinimi i duhur i politikave si një parakusht i rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik.

⁴ Euro-obligacioni ishte lëshuar në vlerë prej 500 milionë euro, me afat maturimi prej 7 viteve dhe normë përfitimi prej 4.25%, përkatësisht normë interesi prej 3.975% në nivel vjetor.

⁵ Lëshimi i euro-obligacionit nuk ishte paraparë me planin fillestar të Buxhetit të 2014, por me rebalancin e shtatorit, me atë që edhe rritja e rezervave valutore ishte dukshëm më e lartë se sa pritej me parashikimet në tetor 2013 dhe prill 2014.

Grafik 7

Revidimi i parashikimeve makroekonomike



Parashikimet për të gjithë treguesit ka të bëjë me parashikimet makroekonomike të Bankës popullore, me një përjashtim të projeksonit të saldës buxhetore dhe financimin e tij, e cila është marrë nga Ministria e financave.
Burimi: BPRM, ESHS dhe FMN.


Në kushte të këtilla, jostabiliteti global i mjedisit paraqite burimin kryesor të pasigurisë në procesin e vendimmarrjes edhe për gjatë vitit 2014. Megjithatë, e rëndësishme është ajo që efektet e ngjarjeve globale ndaj ekonomisë vendore ngelën të kufizuara. Arritjet e treguesve kyç makroekonomik për gjatë vitit nuk pësuan shmangie të mëdha nga dinamika e parashikuar, me çka ecuria të disa tregues ishte më e mirë se sa ato të pritshmet. Rezervat valutore për gjatë gjithë vitit u mbajtën në nivelin e duhur, me çkaliti mbaroi me shkallë të lartë të rezervave valutore. Këto zhvillime të rezervave valutore në masë të madhe e pasqyrojnë huamarrjen e jashtme të shtetit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit si rrjedhojë e lëshimit në korrik të euro-obligacioneve të treta. Megjithatë, edhe nëse do të përjashtohej efekti i huamarrjes së shtetit, zhvillimet në sektorin e jashtëm ishin të favorshme dhe nuk sinjalizonin një disbalancim të madh të jashtëm. Arritjet në llogarinë rrjedhëse në bilancin e pagesave ishin më të volitshme nga ato të priturat si rezultat i arritjeve më të mira të eksportit, para së gjithash i kapaciteteve të huaja, të transferove private më të larta dhe në pjesë më të vogël nga presioni më i dobët i importit sesa pritej dhe pjesërisht si rezultat i çmimeve më të ulëta të produkteve ushqimore dhe të energjisë.

Në kushte të këtilla kur deficitin në llogarinë rrjedhëse vazhdoi të ruhet në një nivel relativ të ulët, zhvillimet në tregun valutor për gjatë vitit ishin relativisht stabil, edhe për kundër faktit që realizimet nga prurjet e flukseve të kapitalit neto (pa prurjet nga euro-obligacioneve) ishin më të dobëta se sa pritjet. Ndryshimet e tregut valutor më 2014 nuk patën shumë shmanjie nga dinamika e zakonshme sezonale. Ashtu që në gjysmë vjetorin e parë BPRM realizoi shitje-neto të mjeteve valutore në masë më të madhe si rezultat i arritjeve të tremujorit të dytë⁶. Arritjet e gjysmë vjetorit të dytë ishin orientuar kah grumbullimi-neto i mjeteve valutore, kryesisht në tremujorin e tretë si pasojë e prurjeve më të larta sezonale të transfereve private. Në kushte të këtilla, tregu valutor me transaksionet e realizuara në nivel vjetor me bankat-përkrahëse, NBRM realizoi një shitje neto të vogël të mjeteve valutore në vlerë prej 5.5 milionë euro.

Zhvillimet e tregut valutor për gjatë vitit 2014 i konfirmuan pritjet stabile të kursit të këmbimit, duke mbajtur stabile pritjet inflacioniste. Arritjet për gjatë vitit tek inflacioni treguan presione më të dobëta inflacioniste se sa pritjet nga projeksionet fillestare të BPRM. Projektioni i inflacionit për gjatë vitit është rishikuar në ulje, kryesisht si rezultat i presioneve më të ulëta të çmimeve importuese, në pajtueshmëri me trendin ulës të çmimeve të produkteve ushqimore dhe energjetike në bursat botërore. Për gjatë gjithë vitit 2014 është realizuar norma mesatare vjetore e inflacionit në nivel prej -0.3%, që në realizimin e saj kontribuan dy komponentat çmimet e ushqimeve dhe çmimet e energjisë. Duke pasur parasysh se dinamika e inflacionit varet nga ndryshimet e çmimeve të luhatshme, u vlerësua se bëhet fjalë për përshtatshmëri e përkohshme e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Për gjatë vitit supozimet për veprimin e kërkesës vendore ndaj inflacionit nuk pësuan ndryshime të mëdha, për gjatë pritjeve për mbylljen e hendekut të prodhimit diku kah fundi i vitit, dhe si rezultat i asaj gradualisht do efektuohet te kërkesa ndaj çmimeve. Inflacioni bazik (pa ushqimet dhe energjinë, edhe pse me tendencë të zvogëlimit gjatë vitit, në bazë vjetore ngeli pozitiv dhe mesatarisht ishte 0.5%.

Grafik 8


Shkalla e euroizimit, pjesëmarrja e depozitave valutore në gjithsej depozitat (me para depozituese), në %



Burimi: BPRM.

Grafik 9

Kontribut në ndryshimet vjetore të kredive gjithsej, në p.p.




Në kushte të pritjeve stabile të kursit të këmbimit dhe të inflacionit dhe perceptimet më të përshatshme ndaj rrezikut të subjekteve private ishin regjistruar ndryshimet më të volitshme në strukturën e kursimeve të sektorit privat. Pikërisht, rritja e kursimeve në pjesë

⁶ Në tremujorin e dytë si zakonisht realizohet riatdhesimi i dividendëve nga ana e një kompanie e madhe vendore kah investitori i huaj. Pasi që dividendat paguhen nga depozitat e kompanive në sektorin bankar (në të shumtën e rasteve në valutë vendore), operacioni i këtillë si zakonisht imponon nevojën e shitjes së valutave nga tregu valutor nga ana e BPRM. Gjatë vitit 2014 riatdhesimi i dividendëve nga kompanitë tjera janë kryer edhe në pjesën tjetër të vitit, megjithatë ata nuk kishin efekte të rëndësishme në tregun valutor.

më të madhe ka të bënë me rritjen e depozitave denarike dhe të depozitave në afat gjatë. Kjo pikërisht ka të bëjë me popullatën, duke pasur parasysh se shkalla euroizimit të depozitave të qytetarëve vazhdoi të zvogëlohet dhe në dhjetor të viti 2014 ishte 47,8% (50% në dhjetor të vitit 2013), ndërsa pjesëmarrja e depozitave afatgjata në gjithsej depozitat e amvisërive kishte trend rritës dhe arriti 32.3% në dhjetor (nga 29.1% në dhjetor të vitit 2013)⁷.

Grafik 10

Struktura e aktiveve të bankave– kontribut në ndryshimin vjetor , në p.p.



Burimi: BPRM.

Arritjet në sektorin e jashtëm dhe të inflacioni konfirmoi ekzistimin e ambientit të favorshëm në ekonominë vendore për rritje solide ekonomike, i cili nuk krijon disbalancë përmes presioneve inflacioniste ose presioneve për të reduktuar rezervat valutore. Kështu, rritja ekonomike në vitin 2014 u përshpejtua dhe ishte brenda pritshmërisë, i mbështetur në ciklin investiv pozitiv dhe rritjes së aktivitetit eksportues. Rritja edhe në vitin 2014 ishte rishpërndarë në më shumë sektor ekonomik.


Gjatë vitit 2014 bankat siguruan mbështetje aktive të procesit të rimëkëmbjes ekonomike nëpërmjet forcimit të mëtejshëm të aktivitetit kreditor. Në tregun kreditor, lëvizjet gjatë vitit kanë qenë vazhdimisht të favorshme, ndërsa sjellja e bankave vuri në dukje përmirësimin e pritjeve të tyre dhe vlerësimet e tyre për profilin e riskut të kërkesës për kredi. Kjo u konfirmua përmes vlerësimeve të sondazheve të aktiviteve kredituese të BPRM të cilat treguan lehtësimin e kushteve të kreditimit nga bankat për familjet dhe sektorin e korporatës (edhe pse në numër të vogël), gjatë rritjes së njëkohshme të kërkesës së kredive. Se flukset e kredive gradualisht normalizohen treguan edhe ndryshimet e regjistruara në faktorët e perceptimit të riskut të bankave, posaçërisht ka sektori korporativ, i cili nga tremujori i dytë i vitit⁸ shënoi përmirësim më të theksuar, për herë të parë pas fazës akute të krizës globale. Gjatë vitit, kreditimi rritej me një rritëm të fuqishëm nga ajo që pritjet, që solli gjer në rritje si pasojë rishikimit të projeksionit për rritjen e kredisë. Viti u mbyll me një rritje më të lartë të rritjes së kredisë nga ajo që pritej kundrejt projeksionit të fundit (nga tetori i vitit 2014), i cili për nga vëllimi ishte më i lartë nga rritja e arritur në vitin paraprak për 1.6 herë. Lëvizje pozitive u vërejtën edhe në aspekt të strukturës së rritjes së kredisë në drejtim të rritjes së kreditimit të sektorit korporativ.

⁷ Analiza i referohet totalit të depozitave të qytetarëve, duke përfshirë paratë e depozitave.

⁸ Duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2014, Anketat për aktivitetin kreditor të BPRM treguan stabilizim të perceptimit të bankave për rrezikun në sferën e kreditimit të sektorit të korporatave. Përmirësimi ishte shënuar te të gjithë faktorët për perceptimin ndaj rrezikut, me ç'rast faktori që i referohet pritjeve për aktivitetin ekonomik në tremujorin e fundit ndikoi në drejtim të lehtësimit të kushteve të kreditimit. Te popullata stabilizimi i perceptimit u çfaq më herët, diku ka fundi i vitit 2011. Më detajisht rreth anketave për aktivitetin kreditues të BPRM mund të shihni linkun vijues: <http://www.nbrm.mk/?ItemID=F7AC78DEE498764FBAF39049F726CE3C>.

Grafik 11

Ecuria e normave të interesit , në p.p..



Norma bazë e interesit të BPRM – norma e interesit e bonave të thesarit të BPRM.

Norma bazë e interesit të BQE – norma e interesit të operacioneve bazike për rifinansim të BQE.

Burimi: BPRM dhe BQE.

Në kushtet de fakto kursi i këmbimit nominal fiks të denarit në raport me euron, rol të rëndësishëm në reagimin monetar është edhe ndryshimi i normave të interesit në eurozonë, si një espiranicë ekonomike. Gjatë vitit 2014, politika monetare e BQE ishte orientuar ka lehtësimi i kushteve monetare në zonën e euros. Kështu, BQE e zvogëloi normën bazë të interesit në dy raste (në qershor dhe shtator), me çka ajo u soll gjer më 0.05%. Gjithashtu brenda natës është kryer zvogëlimin edhe i normës së interesit të kredisë në dispozicion edhe i depozitave në dispozicion, me çka ato u sollën në 0.3% dhe -0.2%, përkatësisht. Krahas reagimit të normave amatore, gjatë vitit BQE ndërmoi edhe masa tjera jo standarde⁹. Relaksimi i politikave monetare të BQE u realizua në kushte të inflacionit të ulët, rritje e dobët ekonomike, si dhe dhe një zvogëlim i mëtejshëm i aktivitetit kreditues në zonën e euros. Duke pasur parasysh pozicionimin e këtillë të politikave të interesit të BQE në vitin 2014, ecuria e normave bazë të interesit të BPRM dhe normave bazë të interesit të BQE në mënyrë të moderuar u zgjerua në dhjetor duke shënuar 3.2 p.p. (3 p.p. në dhjetor të vitit 2013). Në tregun vendor, në suaza të normave bankare të interesit, zhvillimet për gjatë vitit ishin në drejtim të moderuar drejtë shtrëngimit të ecurisë së interesit në mes të normave të interesit të depozitave në denarë dhe atyre në valutë të huaj. Megjithatë, ndryshimet e këtilla nuk patën efekt të rëndësishëm ndaj prirjeve valutore të kursimtarëve, të cilët edhe në vitin 2014 ishin në dobi të kursyerit në valutë vendore.


⁹ Më detajisht rreth ndryshimeve të politikës monetare të BQE shiko në suaza të pjesës Ambienti ekonomik ndërkombëtar.

II. Ambienti ekonomik ndërkombëtar

Rritja ekonomike globale në vitin 2014 shënonte 3.3%, më çka ritmi i rimëkëmbjes ekonomike ngeli i njëjtë si në vitin e kaluar. Karakteristika kryesore e ekonomisë globale për gjatë këtij viti ishte "ndarja" e procesit të rimëkëmbjes ekonomike në mesin e vendeve të zhvilluara. Në fakt, ekonomia e SHBA-së shënoi arritje më të mira, stimuluar nga konsumi individual, me zvogëlim të mëtejshëm të papunësisë dhe aplikimin e politikave monetare të përshtatura dhe neutrale. Zhvillimet pozitive ishin shënuar edhe në Britaninë e Madhe, nën ndikim të kushteve të përmirësuar të tregut të patundshmërive dhe rritja e aktiviteteve kredituese. Në anën tjetër, për së pari herë pas dy viteve zona e euros doli nga zona me aktivitete rënës, por akoma rimëkëmbja ekonomike në vitin 2014 është më e ngadalësuar në raport me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe, që pjesërisht reflekton pasojat ende aktuale të krizës së borxhit. Ekonomia e Japonisë në tremujorin e tretë hyri në recesion teknik, për të cilën kontribuoi konsumi privat i ulët në kushte të rritjes së tatimit në konsum. Rritje vjetore më të ulëta realizuan edhe ekonomitë me rritje të shpejt si dhe vendet në zhvillim, si pasojë e rezultateve më të ulëta eksportuese të vendeve eksportuese të naftës, pasiguria politike dhe problemet strukturore, si dhe shtrëngimi i politikave monetare dhe fiskale të disa nga to. Rritja modeste e aktivitetit ekonomik është pasqyruar edhe në tregtinë botërore, e cila realizoi një normë rritëse pak më të ulët se sa vitin e kaluar dhe shënonte 3.1%.


Grafik 12

Rritja ekonomike globale (në %)




Grafik 13

Rritja e tregtisë globale (në %)



Grafik 14

Rritja reale e PBB në vendet e zhvilluara (në %)




Burimi: Pasqyra ekonomike Botërore, tetor, viti 2014 dhe përditësimi në të vitit 2015, Eurostat.


Inflacioni global¹⁰ realizoi një ngadalësim të mëtejshëm dhe shënoi 3.2% kundrejt 3.6% në vitin e kaluar. Zhvillimet e këtyra në kushte të rënies të vazhdueshme të çmimeve të naftës, mosshfrytëzimin e potencialit prodhues dhe pritjet inflacioniste stabile. Me atë rast, vendet e zhvilluara realizuan normë të inflacionit mesatarisht prej 1.4%, ndërsa në ekonomitë me zhvillim të përshpejtuar dhe vendet në zhvillim inflacioni shënonte 5.3%.

Në aspektin e indikatorëve sasiorë specifikë, të cilat pasqyrojnë mjedisin e jashtëm të ekonomisë së Maqedonisë, kërkesa e huaj efektive¹¹ ndaj prodhimeve të Maqedonisë në vitin 2014 realizoi rritje prej 0.8% kundrejt rënies së realizuar në dy vitet e fundit, në një rritje ekonomike të moderuar të një pjese e partnerëve më të rëndësishëm tregtarë. Kontributin më të madh pozitiv në realizimin vjetor e kishin ekonomitë e Gjermanisë dhe Bullgarisë, kundrejt kontributit negativ të Serbisë dhe Kroacisë.

Grafik 15
Kërkesa e huaj efektive (indeks, 2005=100)



Grafik 16
Normat vjetore të rritjes së kërkesës së huaj efektive (në %)



Burimi: Përlogaritjet e BPRM.

Në vitin 2014, në tregun e produkteve primare vazhdoi ulja e çmimeve të energjisë, metaleve dhe prodhimeve bazike ushqimore. Në korrigjim më të theksuar përsoi çmimi i naftës, e cila pas një periudhe disavjeçare të mbajtjes në nivel të lartë dhe stabil, shënoi një rënie të theksuar për gjatë gjysmës së dytë të vitit¹². Rolin kyç në këto zhvillime e kishin faktorët në anën e ofertës, të cilët në mënyrë të vazhdueshme rriteshin. Në një pjesë këto ndryshime kanë karakter strukturor, që kryesisht ka të bëjë me rritjen e prodhimeve jokonvencionale të naftës e fituar nga masa argjilore e sjellur nga SHBA-ja dhe Kanada. Në drejtim të rritjes së ofertës ndikuan edhe vendet e OPEK-ut, të cilët me qëllim të ruajtjes pjesë të tregut, në nëntor të vitit 2014 vendosën të mos reagojnë ndaj rënies së çmimeve duke vazhduar me sasi të mëdha të prodhimit. Gjithashtu në vitin 2014, pritjet rreth rreziqeve të larta ndaj çmimeve të naftës të cilat ishin të ndërlidhura me tensionet gjeopolitike në më shumë vende të botës nuk u realizuan. Nga ana tjetër, aktiviteti ekonomik i dobët i në pjese të vendeve të zhvilluara, si dhe përdorimi i rritur i lëndëve djegëse alternative, kryen presion drejtë uljes së kërkesës së naftës. Për këtë arsye, çmimi i naftës së papërpunuar "Brent" mesatarisht ishte 74.2 euro për barel, që paraqiste rënie prej 9.5% në nivel vjetor. Rënia e çmimeve të metaleve vazhdoi edhe në vitin 2014 me një rritëm të përshpejtuar dhe shënonte 10.3% për të cilën më së shumti uljen e çmimeve

¹⁰ Burimi: FMN (International Financial Statistics).


¹¹ Kërkesa e huaj efektive është përlogaritur si shumë e indekseve të ponderuara të prodhimit të brendshëm bruto të partnerëve më të rëndësishëm tregtar të Republikës së Maqedonisë. Në përlogaritjen e indeksit janë inkomporuar: Gjermania, Greqia, Italia, Belgjika, Spanja, Serbia, Kroacia, Slovenia dhe Bullgaria. Ponderët janë përlogaritur në bazë të pjesëmarrjes së eksportit të këtyre vendeve në gjithsej eksportin.

¹² Kohëve të fundit rënia e çmimeve të naftës konsiderohet rënia e tretë më e madhe në tridhjetë vitet e fundit (Burimi: Banka botërore, Commodity Markets Outlook, Janar, 2015).

kontribuoi bakri dhe plumbi, në kushte të prodhimit të ulët industrial në Kinë dhe rezervave të larta në nivel global. Kundrejt kësaj, çmimet e nikelit në këtë periudhë kohore arritën rritje të theksuar, kryesisht si rezultat i ndalimit të eksporteve të vendosura nga Indonezia në fillim të këtij viti, e cila ngriti shqetësime për paraqitjen e mungesës së metalit në tregun global, në kushte kur kërkesa shënonte rritje të theksuar. Në vitin 2014 indeksi i prodhimeve ushqimore u zvogëlua për 4.3% në krahasim me vitin paraprak, që pasoi nga rënia e çmimeve të kulturave të drithërave, vajrave ushqimore dhe produkteve të tjera ushqimore. Rënie e çmimeve të prodhimeve primare e shprehur në euro, pjesërisht ishte zbutur si pasojë e aprecimit të dollarit në raport me euron (prej 0.9%), si refleksim i pritjeve divergjente për lëvizjen e politikave monetare të SHBA-së dhe Eurozonës.

Grafik 17


Lëvizjet e çmimeve të produkteve primare, energjetike dhe joenergjetike



Burimi: Baza e të dhënave e FMN për produktet primare.

Grafik 18

Lëvizjet e çmimeve të naftës së papërpunuar, metaleve dhe ushqimeve



Ndryshimet në vendosjen e politikave monetare nga ana e bankave qendrore të vendeve të zhvilluara në vitin 2014 ishin në drejtime të ndryshme. Ashtu që BQE dhe Banka e Japonisë aplikuan masa për lehtësime të mëtejme, në funksion të përkrahjes së procesit të rimëkëmbjes së ekonomisë dhe rikthimin e normës së inflacionit në përputhje me objektivin. Në aspekt të politikave të interesit, BQE brenda dy herësh (qershor dhe shtator) e zvogëloi normën e interesit të aktiviteteve bazike të refinancimit, më ç'rast ajo u soll në një nivel historik më të ulët prej 0.05%. Përkatësisht, korrigjim rënës pësuan edhe normat e interesit të kredisë në dispozicion brenda natës (në nivel prej 0.30%), ndërsa u inkomorua edhe norma negative e interesit të depozitave në dispozicion (-0.20%). Në aspekt të masave të pazakonshme, në shtator dhe dhjetor janë aplikuar dy nga 8 operacionet afatgjata shënjestruese të paralajmëruara të refinancimit (TLTRO¹³), me të cilët u lejohet huazim afatgjatë të mjeteve të bankave të euro-zonës, në drejtim për të përmirësuar transmetimin monetar dhe rritjen e aktivitetit kreditor. Gjithashtu, në tre mujorin e fundit të vitit 2014 ishin aktivizuar dy programe direkte për riblerjen e letrave me vlerë lëshuar nga sektori privat, që përbëhen nga riblerja obligacioneve të siguruara të lëshuar nga institucionet financiare të euro zonës të denominuar në euro (TCBPP¹⁴) dhe letra me vlerë të siguruara me aktivin (ABSPP¹⁵). Së fundmi në janar të vitit 2015 BQE paralajmëroi programin e zgjeruar për riblerjen e aktivitetit financiar në eurozonën (EAPP¹⁶), i cili në mënyrë shtesë inkomoron riblerjen e letrave me vlerë të sektorit publik, pikërisht nga vendet anëtare të eurozonës dhe institucioneve të caktuara evropiane. Me këtë masë lehtësuese sasiore parashikohet rritje e theksuar e bilancit të BQE, që duhet të mundëson një stimul të fuqishëm ekonomik duke stabilizuar pritjet e inflacionit, ruajtja e normave reale afatgjata të

¹³ Targeted Longer-Term Refinancing Operations.

¹⁴ Third Covered Bond Purchase Programme.

¹⁵ Asset-Backed Securities Purchase Programme.

¹⁶ Expanded Asset Purchase Programme.

interesit në nivel të ulët dhe përmirësimin e financimit të kompanive. Në tetor banka e Japonisë solli vendim për zgjerimin e programit të gjeratëhershëm për lehtësime sasiore e cilësor, duke rritur riblerjen e rregullt të obligacioneve të qeverisë japoneze, që do të reflekton drejtë zgjerimit të bilancit të saj. Nga ana tjetër, në pajtueshmëri me arritjet e përmirësuar të ekonomisë amerikane, rezervat federale (FED) nëpërmjet masave jostandarde reagueshan në drejtim gradual të zvogëlimit të stimujve monetar. Gjatë vitit vazhdoi zvogëlimi gradual i riblerjeve të obligacioneve hipotekare dhe i obligacioneve shtetërore afatgjata edhe atë deri në tetor kur ishte vendosur për një ndërprerje të plotë, a me te edhe mbarimi i fazës së tretë të programit për lehtësim sasior. Me atë rast, u ruajt praktika për reinvestim të borxhit të maturuar në aktiv të ri, me qëllim të ruhen kushtet e volitshme të financimit nëpërmjet nivelit stabël të bilancit të FED-it. Norma bazë e interesit të FED-it nuk pësoi ndryshime, me çka u vlerësua se niveli aktual do të ngel në nivel të përshtatshëm për një periudhë më të gjatë kohore. Mandej, nga përmirësimet e mëtejme perspektivës ekonomike të SHBA-së do të varet edhe fillimi i rritjeve të normave të interesit dhe gradualisht normalizimi i politikave monetare. Në vitin e kaluar, Banka e Anglisë nuk realizoi ndryshime në politikën monetare.


III. Lëvizjet makroekonomike gjatë vitit 2014

3.1. PBB dhe inflacioni

Ekonomia kombëtare vazhdoi të rritet me tempo të përsheptuar edhe gjatë vitit 2014. Sipas të dhënave në disponim, viti 2014 shënoi një Prodhim të Brendshëm Bruto të zmadhuar për 3.8%. Krahasuar me vitin paraprak, mjedisi i jashtëm ka luajtur rol stimulues në përsheptimin e Bruto Prodhimtarisë Vendore gjatë vitit 2014. Megjithatë edhe këtë vit, rritja e ekonomisë kombëtare në masë të konsiderueshme mundet të përshkruhet funksionimit të kapaciteteve të reja të orientuara drejt eksportit, aktiviteti i të cilave rezultoi me një rritje të konsiderueshme të prodhimtarisë dhe eksportit. Krahas kësaj, edhe investimet publike në infrastrukturë kanë ndikim stimulues mbi rritjen e ekonomisë kombëtare. Përmirësimi i mjedisit të jashtëm dhe efektet pozitive nga veprimi i kapaciteteve të reja rezultuan me përmirësim të ambientit afarist në ekonominë vendore. Ky konstatim pjesërisht vërtetohet përmes shkallës më të lartë të disperzimit të rritjes në vitin 2014, përkatësisht faktit që më shumë sektorë ekonomik kanë shërbyer si burim i vlerës së shtuar në ekonominë kombëtare.

Grafik 19


PBB dhe kërkesa efektive e jashtme
(shkalla vjetore e ndryshimit real, në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe "Consensus Forecast", Shkurt 2015. Janë shfrytëzuar të dhëna paraprake të PBB ndërsa për vitin 2014 janë shfrytëzuar të dhëna të vlerësuara.

Grafik 20

Vlerësime të aktivitetit aktual ekonomik të subjekteve afariste
(pasqyra e përgjigjeve)*



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave


*Bilanci paraqet dallim në mes përgjigjeve të ponderuara pozitive dhe negative të shprehura në përqindje. Bilanci tregon lëvizjen e treguesit të analizuar ekonomik, e jo lartësinë e tij reale.

Në vitin 2014 të gjitha veprimtaritë ekonomike ndikuan pozitivisht në rritjen e ekonomisë kombëtare, me atë që ndikim më të lartë individual ka pasur industria përpunuese si rezultat i shkallës së rritur të shfrytëzimit të kapaciteteve vendore dhe të huaja të orientuara drejt eksportit. Analiza strukturore nxjerr në pah se lëvizjet pozitive në industrinë përpunuese kryesisht mundet të përshkruhen rritjes së prodhimtarisë së automjeteve, makinave dhe pajisjeve elektronike. Krahas kësaj një ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike gjatë vitit 2014 ka patur edhe industria e ndërtimtarisë si rezultat i intensitetit të rritur në ndërtimin e objekteve për banim dhe atyre nga fusha e hidro ndërtimtarisë. Rritja e prodhimtarisë industriale gjatë vitit afektoi pozitivisht edhe tregtinë, transportin dhe komunikacionin të cilat bashkërisht përbëjnë komponentin e tretë për nga rëndësia dhe ndikimi në rritjen ekonomike. Pjesa më e madhe e rritjes së tregtisë¹⁷ mundet

¹⁷ Analiza e lëvizjeve në tregti është realizuar në bazë të dhënave për qarkullimin tregtar.

ti përshkruhet rritjes së këmbimit në shumicë, përderisa rritja e aktivitetit në sektorin e transportit¹⁸ kryesisht i përshkruhet rritjes së shkallës së transportit të udhëtarëve dhe mallrave.


Grafik 21
Kontribut në rritjen vjetore të PBB
(në pikë përqindje)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulimet e BPRM.

Janë shfrytëzuar të dhëna paraprake të PBB ndërsa për vitin 2014 janë shfrytëzuar të dhëna të vlerësuara.

Grafik 22
PBB, industria dhe shfrytëzimi i kapaciteteve



Shikuar nga këndvështrimi i kërkesës, rritja ekonomike e vitit 2014 mundet të kundrohet si rezultat i rritjes paralele të kërkesës vendore dhe aktivitetit eksportues. Vazhdimi i ndryshimeve strukturore të ndërlidhura me funksionimin e kapaciteteve të reja prodhuese përbëjnë faktorët kyç për rritjen e eksportit gjatë vitit 2014, andaj eksporti ishte sektori me ndikim më të lartë individual në rritjen ekonomike. Një përkrahje të konsiderueshme për rritjen ekonomike gjatë vitit 2014 ka dhënë edhe kërkesa vendore, në ç'rast veçohet rritja e investimeve bruto, pjesërisht të nxitura nga investimet e rritura shtetërore. Krahas kësaj duhet theksuar që lëvizjet e volitshme në tregun e punës dhe rritja e pagave reale gjatë vitit ka afektuar në mënyrë shtesë rritjen e konsumit të amvisërive. Komponenti i vetëm i cili ka shënuar rënie në kërkesën vendore është kërkesa publike. Kërkesa e rritur vendore dhe zmadhimi i aktivitetit eksportues shkaktuan rritje të importit dhe për pasojë u paraqit kontribut negativ i neto kërkesës eksportuese ndaj rritjes ekonomike.


Në vitin 2014 ndryshimi mesatar vjetor i çmimeve të konsumit ishte negativ (0.3%), krahasuar me shkallën pozitive të rritjes prej 2.8% në vitin 2013. Hyrja në zonën e ndryshimeve negative, kryesisht mundet të sqarohet me ndryshimet në komponentin ushqimor e cila shënoi rënie kundrejt rritjes së shënuar në vitin 2013. Ndikim në këtë drejtim ka patur edhe inflacioni bazë i cili në vitin 2014 vazhdoi të rritet me një tempo të konsiderueshme të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Ndikim shtesë negative ka patur edhe komponenta e energjetikës në suaza të së cilës në vitin 2014 erdhi deri në përshkallëzim të rënies së çmimeve, paralelisht më rënien e çmimeve të derivateve të naftës në vend. Shikuar sipas dinamikës, çmimet filluan të zvogëlohen që në fillim të vitit, në ç'rast gjatë gjysmës së parë të vitit shkalla mesatare e inflacionit ishte negative (0.2%). Trendi i

¹⁸ Analiza e ndryshimeve në transport është realizuar duke marrë për bazë të dhënat për transportin e udhëtarëve dhe mallrave.

tillë vazhdoi edhe në gjysmë e dytë të vitit kur erdhi deri në përshkallëzimin e rënies së çmimeve (shkallë negative mesatare e inflacionit prej 0.4%).

Grafik 23

Inflacioni mesatar vjetor (në %), efekt i transferuar dhe rritje e re (në pikë përqindje)



Brimi: Enti shtetërorë i statistikve dhe kalkulimet e BPRM.

shënuan rënie prej 0.9% (kontribut prej -0.3 p.p. në ndryshimin e përgjithshëm të çmimeve). Krahas çmimeve të zvogëluara importuese, ndikim shtesë kishte edhe baza e lartë e vitit 2013, në situatë të rritjes së konsiderueshme të çmimeve të frutave të perimeve dhe pemëve të freskëta si rezultat i kushteve të pavolitshme klimatike në pjesët lindore të Maqedonisë. Kur bëhet fjalë për komponentin energjetike duhet theksuar që produktet nga kjo lëmi shënuan rënie prej 1.4% të çmimeve (kontribut i përgjithshëm prej -0.2 p.p. në shkallën e përgjithshme të inflacionit), si rezultat i çmimeve më të ulta të derivateve të naftës²⁰ si rezultat i ndryshimeve në çmimin e naftës së papërpunuar, e cila shënoi rënie të zmadhuar të çmimit në gjysmën e dytë të vitit. Nga ana tjetër, komponenta afatgjatë çmimore në vitin 2014 mbeti pozitive në shkallë prej 0.5% (kontribut prej 0.3 p.p.) në ç'rast mungesa e presioneve nga kërkesa, kryesisht sqarohet me faktorë të karakterit të përkohshëm dhe të njehershëm (rritja e çmimeve të produkteve farmaceutike në janar dhe qershor, rritja e çmimeve të duhanit²¹ dhe pijeve alkoolike). Megjithatë sipas dinamikës rritja e kësaj komponente çmimore gjatë vitit kishte trend ngadalësues, ndërsa gjatë tremujorit të fundit hyri në zonën e ndryshimeve negative, pjesërisht duke reflektuar efektet e transferuara nga lëvizja rrenëse e produkteve ushqimore dhe energjisë.

Trendi i lëvizjes së çmimeve në vend, edhe gjatë vitit 2014 në masë të madhe ishte nën ndikimin e lëvizjes së çmimeve të produkteve primare në tregun botërorë, çmime këto që gjatë vitit të kaluar në përgjithësi marrë shënuan trend rrenës. Një faktor shtesë që duhet pasur në konsideratë ishin çmimet e produkteve të importuara për konsum personal, përkatësisht ngadalësimin e konsiderueshëm të çmimeve efektive të huaja nga 1.9% në 0% gjatë vitit 2014.¹⁹ Ndryshimet e tilla në plan global, shkaktuan rënie të çmimeve të produkteve ushqimore dhe energjisë në vend. Kështu çmimet e produkteve ushqimore në vitin 2014


¹⁹ Kalkulimi i inflacionit efektiv të jashtëm është nxjerrë nga shuma e ponderuar e indekseve të çmimeve të konsumit të shteteve që janë partner më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë në lëminë e importit të mallrave për konsum të gjerë. Struktura e ponderuar është e bazuar në participimet e normalizuara të importit nominal nga çdo shtet në importin e përgjithshëm nominal në periudhën 2010-2012. Në kalkulimin e treguesit në fjalë janë kyçur: Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia dhe Serbia.

²⁰ Korrigjimi rrenës i çmimeve të derivateve të naftës në tërësi e neutralizoi korrigjimin telartë të çmimit të energjisë elektrike (zmadhim i çmimit të energjisë elektrike për 3.5% nga korriku i vitit 2014).

²¹ Nga 1. Korrik 2014 u rrit akciza e cigareve (0.15 denarë për cigare. Në përputhshmëri me Ligjin për Akciza kjo është pjesë e kalendarit dhjetëvjeçarë për zmadhimin e akcizave, me çka është paraparë që akciza të rritet çdo vit me atë që nga 1 Korriku 2016 ajo do të rritet për 0.20 denarë çdo vit.

Grafik 24


Inflacioni vendor dhe inflacioni efektiv i jashtëm, shkallë vjetore të rritjes (në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulimet e BPRM.

Grafik 25

Komponenta të ndryshueshme (ushqim dhe energji) dhe afatgjata të inflacionit, (participim vjetor, në pikë përqindje)



3.2. Tregu i punës

Në vitin 2014, pjesa më e madhe e treguesve të tregut të punës tregojnë një vazhdimësi të trendeve pozitive. Këto lëvizje koincidojnë me rezultatet pozitive të realizuara në sektorin real. Përndryshe, gjatë disa viteve të fundit, në vazhdimësi, përmirësim i i disa nga treguesit kyç të tregut të punës ndërlidhet me funksionimin e kapaciteteve të reja në zonat zhvillimore teknologjike-industriale, si dhe me ndikimet e politikës fiskale përmes masave aktive për punësim²², projektet infrastrukturore të financuara me para publike si dhe politikat e subvencionimit të bujqësisë.

Numri i të punësuarve në vitin 2014 u zmadhua për 1.7%, përkatësisht më pak se në vitin paraprak. Shikuar sipas sektorëve ekonomik, rritja e punësisë në masë të madhe ka të bëjë me sektorin e shërbimeve, sektor në suaza të së cilit bëjnë pjesë "transporti, magazinimi dhe lidhjet", e që është komplementarë me industrinë dhe ndërtimin ku rritja e shkallës së punësimit është stimuluar nga lëvizjet pozitive në këto segmente të ekonomisë kombëtare. Krahas kësaj, një kontribut solid individual ka pasur edhe zmadhimi i numrit të të punësuarve në drejtoritë publike dhe mbrojtje si dhe në sigurimin obligator pensional. Rritja e shkallës së punësisë në industri vazhdoi edhe në vitin 2014, kryesisht në industrinë përpunuese dhe ndërtimtare. Nga ana tjetër, pas rezultateve jashtëzakonisht të larta të vitit të kaluar, punësimi në bujqësi shënon një lëvizje rritëse të butë, si rezultat i së cilit kontributi i tij në shkallën e përgjithshme të punësisë ishte neutral.


Rritja në shkallën e kërkesës reflektoi edhe me rritje të ofertës së fuqisë punëtore. Kështu në vitin 2014, numri i përgjithshëm i popullsisë aktive shënoi rritje prej 0.3% që duke pasur parasysh rënien e butë në numrin e popullsisë joaktive, shkaktoi një zhvendosje të vogël të shkallës së aktivitetit të popullsisë dhe pozicionimin e saj në 57.3%. Rritja ,më e madhe e kërkesës për fuqi punëtore krahasuar me ofertën e saj, rezultoi me zhvendosje rrenëse të papunësisë. Komfor kësaj, në vitin 2014, shkalla mesatare e papunësisë ishte 28%, përderisa shkalla e papunësisë shënoi rritje dhe arriti nivelin prej 41.2%. Shikuar sipas

²² Edhe gjatë vitit 2014, Qeveria e Republikës së Maqedonisë përmes Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe Agjencinë për punësim, vazhdoi me implementimin e programeve dhe masave aktive për të stimuluar shkallën e punësimit të tilla si programe për vetëpunësim, ofrim i përkrahjes financiare për ndërmarrje mikro dhe të vogla dhe zejtarë për të hapur vende të reja pune, programe për subvencionim të punësimeve, programe për përgatitje të kuadrit për tu punësuar, programe për punë të dobishme për bashkësinë etj.

grup moshave, një kontribut të konsiderueshëm në zvogëlimin e shkallës së përgjithshme të papunësisë ka dhënë rënia e papunësisë te popullsia e grup moshave 25 deri 49 vjeçare, grup moshë kjo që merr pjesë me mbi 60% në numrin e përgjithshëm të papunësuarve. Duke pasur parasysh që rreth 80% i të papunësuarve të kësaj grup moshe bëjnë pjesë në kategorinë e papunësisë afatgjatë, këto trende tregojnë një zvogëlim potencial të papunësisë afatgjatë.

Grafik 26


Disa tregues të tregut të punës
(ndryshime vjetore, në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulimet e BPRM.

Grafik 27

Shkalla e papunësisë në %, sipas grup moshave




Në vitin 2014 është shënuar një rritje nominale e pagave mesatare të paguara me një dinamikë gati identike me atë të vitit paraprak. Krahës kësaj, për herë të parë përmes trendit trevjetor të zvogëlimit, është shënuar edhe zmadhim real i pagave. Kështu, neto dhe bruto pagat nominale²³ shënuan rritje vjetore prej 1.2% përkatësisht 1%, në ç'rast rritje shënojnë të gjithë sektorët dhe veprimtaritë. Në kushte të përshtatjes rrenëse të nivelit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit prej 0.3% bëhet fjalë për rritje prej 1.5% përkatësisht 1.3% të neto dhe bruto pagave. Në vitin 2014 është shënuar përmirësim edhe i treguesve të konkurrencës.²⁴ Kështu, në kushte të rritjes më të lartë të aktivitetit ekonomik krahasuar me rritjen e punësisë, produktiviteti i fuqisë punëtore shënon rritje prej 2%. Rritja më intensive e produktivitetit krahasuar me bruto pagat shkaktoi zvogëlim të shpenzimeve për fuqinë punëtore prej 1% për njësi.

²³ Bruto paga e përgjithshme e paguar përfshin: neto pagat e paguara për muajin përkatës, tatim personal i paguar dhe kontribute të paguara (për sigurim pensional dhe invalidor, për sigurim shëndetësorë, për punësim, për sëmundje profesionale dhe për ekonominë e ujërave). Të dhënat e mësipërme kanë të bëjnë me pagat e paguara.


²⁴ Produktiviteti dhe kostot e punës për njësi produkti në nivel të ekonomisë kombëtare janë kalkuluar në bazë të dhënave për PBB, numrin e përgjithshëm të punësuarve, Anketës për fuqinë punëtore të Enti Statistikorë të Republikës së Maqedonisë si dhe të dhënave për bruto-pagat mesatare.

Grafik 28
Bruto dhe neto paga vjetore
(ndryshime vjetore, në %)




Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulimet e BPRM.

Grafik 29
Neto paga mesatare sipas sektorëve
(ndryshime vjetore, në %)




Grafik 30
Produktiviteti i fuqisë punëtore
(ndryshime vjetore, në %)



Burimi: Enti shtetërorë statistikore dhe kalkulime të BPRM

Grafik 31
Kosto për fuqinë punëtore, për njësi produkti
(ndryshime vjetore, në %)



3.3. Financat publike

Në vitin 2014 deficitin buxhetor vazhdoi trendin rritës duke arritur në 4.2\$ të PBB me çka u tejkalua jo vetëm plani fillestarë buxhetorë për edhe rebalanci i bërë gjatë vitit. Në fakt, edhe gjatë këtij viti një pjesë e konsiderueshme e deficitit u krijua në fillim të vitit²⁵, si rezultat i shkallës më të lartë të pagesës së subvencioneve në bujqësi, zmadhimit të sasisë së mjeteve që u paguhen kategorive të prekshme të qytetarëve²⁶ si dhe rritjes së aktiviteteve në ndërtimin e infrastrukturës. Duke marrë parasysh që dinamika e realizimit të pjesës shpenzuese të buxhetit edhe në periudhën vijuese ishte më e lartë se realizimi i të ardhurave të pritura, e në situatë të realizimit të gati të plotë të deficitit të planifikuar për tetë muajt e para të vitit²⁷, u imponua nevoja për sjelljen e ligjit për Ndryshim dhe plotësim të buxhetit për vitin 2014²⁸. Me rebalancin e miratuar u bë korrigjimi rrenës si i anës së të ardhurave ashtu edhe asaj shpenzuese (për 1.7% përkatësisht për 0.8%). Si rezultat i përshtatjes jo të barabartë të parametrave buxhetorë erdhi deri në zmadhim të deficitit të planifikuar me rebalancin në 3.7% të PBB, krahas 3.5% të paraparë me buxhetin fillestarë.

²⁵ Rreth 3/5 e deficitit të planifikuar me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë u realizuan në tremujorin e parë të vitit.


²⁶ Këtu bën pjesë zmadhimi i pensioneve dhe ndihmës sociale për 5% të paguara në shkurt, përkatësisht mars të vitit 2014.

²⁷ Nga fillimi i vitit, përfundimisht me muajin gusht u realizuan rreth 93% i deficitit të paraparë për vitin 2014.

²⁸ "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 133/2014 e 9.9.2014.

Paralelisht me përkeqësimin e deficitit të përgjithshëm buxhetorë, u shënua thellim edhe i deficitit buxhetor primar²⁹, i cili shënoi rritje prej 0.3 p.p. krahasuar me vitin 2013 dhe arriti në 3.2% të PBB. Përkundër kësaj, deficit buxhetor rrjedhës³⁰ qëndroi në nivelin e 2% të vitit paraprak, në kushte të rritjes së ngjashme të ardhurave dhe shpenzimeve rrjedhëse si përqindje e PBB. Deficiti i rritur buxhetor kontribuo në rritjen e mëtejme të borxhit të qeverisë qendrore dhe të borxhit të përgjithshëm publik, i cili në vitin 2014 ishte në nivelin 38% përkatësisht 45.9% të PBB. Në këtë rast duhet theksuar se një pjesë e zmadhimit të borxhit erdhi si rezultat i huazimit të qeverisë në tregjet ndërkombëtare financiare me qëllim të shfrytëzimit të kushteve të volitshme për sigurim të mjeteve për para financim të detyrimeve që maturojnë në vitin 2015.

Grafik 32
Treguesit fiskal



Burimi: Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë dhe kalkulimet e BPRM.

Në vitin 2014, ndryshimet në komponentin e diskrecionit të politikës fiskale sërish ishin pozitive respektivisht kishin ndikim stimulues mbi kërkesën agregate. Kështu, deficit i përgjithshëm strukturor³¹ u rrit për 1 p.p. krahasuar me vitin paraprak dhe arriti në 5.2% të PBB, në kushte të përkeqësimit paralel të deficitit strukturor primar (nga 3.1% në vitin 2013 në 4% në vitin 2014). Kështu, përmes këtyre indikatorë të thjeshtë mundet të

²⁹ Saldoja primare buxhetore paraqet dallim në mes të ardhurave të përgjithshme buxhetore dhe të dalave të përgjithshme buxhetore, të zvogëluara për nivelin e pagesës së obligimeve rrjedhëse në bazë të borxheve të marra (norma të interesit). Ky tregues fiskal konsiderohet të jetë më adekuat gjatë analizës së kursit aktual të politikës, meqë ai integron shpenzimet fiskale që rrjedhojnë nga menaxhimi i kaluar i politikës fiskale në pjesën e borxhit publik.


³⁰ Saldoja rrjedhëse buxhetore paraqet dallimin në mes të ardhurave rrjedhëse (të ardhura nga kontribute tatimore si dhe të ardhura jotatimore) dhe të dalat rrjedhëse buxhetore (për paga dhe kontribute, për mallra dhe shërbime, transfere dhe norma të interesit). Shikuar historikisht, në kalkulimet e saldove rrjedhëse buxhetore dividendi nga "Telekomi" është përfshirë nga kategoria e të ardhurave jotatimore dhe është kyçur në kategorinë e të ardhurave kapitale (në përputhshmëri me ndryshimet metodologjike të vitit 2011).

³¹ Deficiti i përgjithshëm buxhetorë fitohet po qese nga deficitit faktik buxhetorë largohet komponenta ciklike buxhetore. Ai kalkulohe si dallim në mes të ardhurave të përgjithshme buxhetore të përshtatura sipas efektit të dallimit në mes PBB potencial dhe faktit me koeficient të elasticitetit 1 dhe të dalurat reale buxhetore të përshtatura sipas efektit të dallimit në mes PBB potencial dhe faktit me koeficient të elasticitetit 0. Deficiti primar strukturor kalkulohe ashtu që nga deficitit i përgjithshëm strukturorë minusohet efekti i kostove për norma të interesit.

përfundohet se impulsi³² fiskal në vitin 2014 sërish ishte pozitiv dhe më i fuqishëm krahasuar me vitin paraprak. Në kushte të ngushtimit gradual por një rendit mbetjes në zonën negative të jazit prodhues mundet të kolaudohet se politika fiskale edhe në vitin 2014 ishte në funksion të përkrahjes së ekonomisë kombëtare në suaza të ciklit ekonomik rrjedhës.

Grafik 33


Struktura e financimit të saldoshetore (në milionë denarë)³³



Burimi: Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë dhe kalkulimet e BPRM.

Grafik 34

Qarkullimi me letra shtetërore me vlerë në tregun primar (përqindje e PBB)



Financimi i deficitit buxhetor në vitin 2014 u realizua në tërësi përmes huamarrjes së jashtme, edhe pranë faktit që në Rebalancin e buxhetit ishte paraparë që një pjesë e këtij jazi të mbulohej përmes burimeve të brendshme. Megjithatë, analiza e nënperiudhave të vitit dëshmon një pasqyrë më ndryshe kur bëhet fjalë për burimet e financimit. Kështu, në gjysmën e parë të vitit 2014 financimi realizohej kryesisht duke shfrytëzuar depozitat e shtetit të BPRM dhe në masë më të vogël përmes mobilizimit të mjeteve në tregun e brendshëm financiar, për dallim nga gjysma e dytë e vitit kur huamarrja e jashtme ishte burimi i vetëm i neto të ardhurave të mjeteve në kushte të neto huamarrjes negative të brendshme dhe akumulimit të konsiderueshëm të depozitave. Ky dallim në strukturë rrjedhoi nga rritja e shkallës së të ardhurave nga huamarrjet e jashtme në këtë periudhë. Shkallë më e lartë e huazimit u shënua në muajin korrik, kur për nevojat e mbulimit të nevojave për financim të vitit rrjedhës dhe të ardhshëm u botua euro-obligacioni i tretë në tregun ndërkombëtar të kapitalit në bazë të së cilës u realizuan të ardhura prej 491 milionë euro. Edhe pranë faktit që në periudha të caktuara shteti siguronte mjete përmes huamarrjes në tregun vendor, në nivel vjetorë u bënë më shumë pagesa në bazë të borxhit ekzistues. Për pasojë, realizimi i përgjithshëm i tregut primar të letrave me vlerë gjatë vitit 2014 u përgjysmua dhe arriti në 10.5% të PBB krahasuar me 21.3 në vitin 2013 që në tërësi rezultoi nga emisioni i zvogëluar i titujve të shtetit. Nga ana tjetër, edhe në vitin 2014 vazhdoi trendi i huazimit përmes obligacioneve shtetërore³⁴, në pajtueshmëri me përcaktimin për vazhdim të afatizimeve të portofolit të letrave shtetërore me vlerë.

³² Impulsi fiskal definohet si dallim në mes saldoshetore të përshtatur ciklike në vitin paraprak dhe atë vijues.


³³ *Dallim në mes të ardhurave të përgjithshme nga letrat me vlerë kontinuele dhe strukturore (tituj shtetërorë dhe obligacione) dhe të dalave të përgjithshme për pagesa të borxhit të brendshëm.

**Ndryshimi negativ të depozitave shtetërore nënkupton deponim të tyre te BPRM.

³⁴ Norma mesatare e ponderuar e interesit të obligacioneve shtetërore rra në nivelin më të ulët historik prej 3.8% krahasuar me 4.6% në vitin 2013.

Grafik 35

Stoku i borxhit të pushtetit qendror dhe borxhi i përgjithshëm publik



Burimi: Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë dhe kalkulimet e BPRM.

Në vitin 2014 borxhi i qeverisë qendrore³⁵ arriti në 3,246.4 milionë euro përkatësisht u rrit për 17.8% krahasuar me vitin paraprak. Pjesëmarrja e borxhit të qeverisë qendrore në PBB arriti në 38% nga 34% në vitin 2013. Rritja e stoku të borxhit në tërësi është rezultat i zmadhimit të konsiderueshëm të borxhit të jashtëm (kontribut prej 18 p.p.), që rezultoi nga emisioni i euro obligacionit të ri, për dallim nga borxhi i brendshëm i cili shënoi një rënie minimale. Nga ana tjetër, stoku i borxhit publik³⁶ në vitin 2014 shënoi rritje për 19.5% dhe arriti në 3,921 milionë euro. Rritja nominale e borxhit publik shënoi edhe rritje të participimit të tij në PBB duke arritur në 45.9% krahasuar me 40.5% në vitin 2013. Dinamika e tillë e zhvillimit të borxhit publik kryesisht ka të bëjë me rritjen e borxhit shtetëror³⁷, respektivisht rritjes së borxhit të jashtëm të qeverisë qendrore, përderisa një pjesë më e vogël mundet ti përshkruhet rritjes së borxhit të garantuar të jashtëm të ndërmarrjeve publike dhe të shoqërive aksionare në pronësi shtetërore. Në kontekst të komponentëve të lartpërmendura të borxhit publik vazhdoi tendenca e zvogëlimit të pjesëmarrjes së borxhit shtetërorë në borxhin publik (nga 84.5% në vitin 2013 në 83.2% në vitin 2014), por e ndjekur me zmadhim të pjesëmarrjes së borxhit të garantuar (nga 15.5% në 16.8%). Shikuar nga aspekti i strukturës rezidente të borxhit publik, pjesëmarrja e borxhit publik të jashtëm në PBB u rrit për 6.3 p.p. në krahasim me viti, 2013 dhe arriti në 31.9%, përderisa pjesëmarrja e borxhit të brendshëm për herë të parë pas disa viteve shënoi rënie dhe arriti nivelin prej 14% (nga 14.8% në vitin 2013).

³⁵ Kat ë bëjë me borxhin e qeverisë qendrore përfshirë këtu edhe fondet publike, por pa komunat.


³⁶ Borxhi publik është i definuar me ligjin për borxhin publik („Gazeta zyrtare e RM“ nr. 165/14), sipas së cilit ai paraqet shumën e borxhit shtetërorë dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga ana e shtetit ose komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, si dhe ndërmarrjet tregtare të cilat shteti ose komunat, komunat në qytetin e Shkupit ose qyteti i Shkupit paraqiten si pronar kryesor ose i vetëm, e për të cilat shteti ka dhënë garancinë shtetërore.

³⁷ Borxhi shtetërorë përfshin shumën e borxheve të qeverisë qendrore dhe pushteteve lokale.

3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm


Në vitin 2014 deficitin në llogarinë rrjedhëse vazhdoi të zvogëlohet dhe arriti nivelin më të ulët në tetë vitet e fundit, përkatësisht 1.3% i PBB (për 0.5 p.p. më pak krahasuar me vitin paraprak). Arsyeja kryesore për zvogëlimin e deficitit në llogarinë rrjedhëse është përmirësimi i saldosit në këmbimin e mallrave, me një përkeqësim të vogël të ardhurat sekondare dhe shërbimet. Zhvendosjet e tilla të volitshme në tregtinë e jashtme në masë të madhe rrjedhin nga ndryshimet strukturore në sektorin e eksportit, kurse një impuls shtesë dha edhe shëndetësimi i matur i kërkesës së jashtme, si dhe rënia e çmimeve të energjisë në bursë në gjysmën e dytë të vitit që rezultoi me presion më të ulët importues. Një faktor tjetër me ndikim mbi këtë pozitë të jashtme "beninje" është edhe jazi negativ prodhues, me çka kufizohet presioni i kërkesës së brendshme mbi importin. Rrjedhat financiare gjatë vitit 2014 ishin të mjaftueshme për të financuar deficitin në llogarinë rrjedhëse, por edhe për një akumulim të konsiderueshëm të rezervave valutore gjatë vitit. Rrjedha kryesore financiare në këtë rast ishte huazimi i shtetit. Në fakt, në kushte të stabilizimit të tregjeve financiare u krijuan kushte të volitshme për huazim të shtetit në tregjet financiare ndërkombëtare përmes botimit të euro obligacionit të tretë në vitin 2014. Megjithatë, gjatë këtij viti u realizuan edhe neto të ardhura solide përmes investimeve të huaja të drejtpërdrejta, të cilat ruajtën nivelin stabil, përkatësisht mbetën të pandryshuara krahasuar me vitin paraprak.

Grafik 36
Llogaria vjetore, kapitale dhe financiare
(në milionë euro)



Burimi: BPRM.


Grafik 37
Participimi i komponentëve të veçanta në
ndryshimin vjetor të llogarisë rrjedhëse
(në p.p. të PBB)



Analiza e komponentëve të veçanta të këmbimit me jashtë në vitin 2014 tregon në rritje të konsiderueshme të dy kategoritë, ndonëse eksporti u rrit me një dinamikë më të lartë krahasuar me importin. Aktiviteti eksportues kryesisht erdhi në shprehje si rezultat i rritjes së eksportit të investitorëve të huaj, kapaciteti i rritur dhe vlera e shtuar nga të cilët vazhdon të mbetet fuqi lëvizëse për rritjen e eksportit, në kushte kur sektorët tradicional eksportues, e në veçanti industria e përpunimit të metaleve, sërish shënoi kontribut negativ. Rritja e importit nuk pati ndonjë efekt të veçantë mbi aktivitetin eksportues, meqë kryesisht zmadhimi i importit doli nga rritja e shkallës së importimit të lëndës së parë për kapacitetet e reja industriale në ekonominë kombëtare. Importi i zmadhuar i lëndës së parë për industrinë u mbi plotësua edhe me një import të rritur investues, që është edhe e pritshme në kushte të rritjes së investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe aktiviteteve intensive investuese të sektorit publik. Nga ana tjetër, importi i energjisë nuk shënoi ndonjë ndryshim të veçantë krahasuar me vitin paraprak edhe pranë çmimeve të volitshme të naftës së papërpunuar në bursë. Lëvizjet e tillë të kërkesa importuese për energji janë të shkaktuara nga rritja e sasisë së importuar të energjisë elektrike gjatë vitit 2014 si


rezultat i uljes së shënuar në prodhimtarinë vendore të këtij energjensi me rëndësi të veçantë.

Grafik 38
Kontribut në ndryshimin vjetor të eksportit
(në p.p.)




Burimi: ESHS.

Grafik 39
Kontribut në ndryshimin vjetor të importit
(në p.p.)




Ndonëse në vitin paraprak u shënuar një përmirësim i konsiderueshëm i suficitit të shërbimit, këtë vit kjo kategori shënoi një përkeqësim të matur prej 0.2 p.p. të PBB. Saldoja pozitive e zvogëluar të shërbimit vjen si rezultat i të dalave neto të shërbimit e ndërtimtarisë³⁸, si dhe zmadhimit të dalave neto të shërbimit prodhues për përpunim të mëtejshëm dhe të shërbimit turistike. Njëkohësisht edhe komponenta më e rëndësishme për financim të deficitit tregtar, të ardhurat sekondare, shënoi zvogëlim të pjesëmarrjes relative në neto të ardhurave në PBB për 0.4 p.p. Krahasuar me vitin 2013, zvogëlimi i pjesëmarrjes relative është veçanërisht e shprehur të transferet e sektorit privat, kundruar përmjet rënies së efektivës së blerë të huaj në tregun e këmbimit. Megjithatë analiza sipas vlerave nominale, neto të ardhurat në këtë kategori shënuan rritje krahasuar me vitin 2013 dhe ishin të mjaftueshme për mbulim të plotë të deficitit tregtar të realizuar gjatë vitit. Ndryshimi të ta ardhurat primare kishte efekt neutral mbi ndryshimin vjetor të llogarisë rrjedhëse, ndërsa të dalat neto nga investimet e drejtpërdrejta mbetën të pandryshuara.

Grafik 40
KKEN и KREK, (Kalkuluar sipas indeksit të shpenzimeve për jetesë dhe çmimeve të prodhuesve, 2010=100)



Burimi: BPRM.


Grafik 41
Çmimet relative (2010=100)



³⁸ Shkalla e lartë e të dalurave të shërbimit e ndërtimtarisë parasë gjithash kanë të bëjnë me dhënien e avanseve për kryerjen e punëve ndërtimore në suaza të projekteve për ndërtimin e autostradave. Këto transaksione një rendit u regjistruan edhe në llogarinë financiare, si krijim i neto obligimeve në bazë të borxheve të destinuara për financim të infrastrukturës rrugore, edhe atë në po të njëjtën shumë si shërbimet.


Analiza e treguesve të konkurrencës së çmimeve të ekonomisë maqedonase³⁹ nuk tregon ndryshime të veçanta krahasuar me vitin paraprak. Në fakt, kursi real efektin i këmbimit i kalkuluar sipas kostos së jetesës shënoi një deprecim të vogël prej 0.1%, ndërsa KREK i deflacionuar me çmimet e prodhuesve të produkteve industrial është shënuar një aprecim i vogël prej 0.2%. Ndryshimet e tilla gjatë vitit u ndikuan nga aprecimi i kursit nominal efektiv të këmbimit të denarit krahasuar me lirën turke dhe dinarin serb në kushte të lëvizjeve të volitshme të çmimeve vendore krahasuar me ato të jashtme të dy indekset e çmimeve.

Grafik 42
Llogaria financiare (% e PBB)



Burimi: BPRM.

Grafik 43
Investime të drejtpërdrejta (% e PBB)




Në vitin 2014 përmes llogarisë financiare të bilancit të pagesave u realizuan të ardhura të larta që arritën në 5.4% të PBB, që paraqet në rritje prej 4.8 p.p. të PBB në bazë vjetore. Faktori kyç në krijimin e rrjedhave të tilla ishte huazimi i jashtëm i shtetit, me rreth 5.4% të PBB. Një kontribut të rëndësishëm në rrjedhat e llogarisë financiare patën edhe investimet e huaja të drejtpërdrejta, të cilat në vitin 2014 përbënin rreth 3.3% të PBB dhe kryesisht erdhën në shprehje në formë të huazimeve nga kompanitë amë, me një kontribut më të vogël të kapitalit aksionar. Shikuar sipas veprimtarive, pjesa më e madhe e investimeve të huaja të drejtpërdrejta ishin në sektorin e prodhimit (prodhim i produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, por edhe në industrinë automobilistike)) dhe në sektorin e shërbimeve, kryesisht në aktivitete financiare dhe të sigurimeve. Neto-huazimi i sektorit privat jashtë (1.2% i PBB) në pjesë më të madhe i përshkruhet huazimit të sektorëve tjerë të ekonomisë, në pjesë të madhe huazimeve të marra nga ndërmarrjet publike më qëllim të financimit të projekteve në ndërtimin e infrastrukturës rrugore. Këto realizime në masë të madhe u neutralizuan nga rritja e mjeteve neto të kategorisë "valuta dhe depozita të huaja", kryesisht për shkak të rritjes së mjeteve të sektorit tjerë, por një rendit edhe për shkak të rritjes së mjeteve të institucioneve depozituese.

Në fund të vitit 2014 pozita negative ndërkombëtare investuese e Republikës së Maqedonisë ishte 4,781.6 milionë euro, përkatësisht 56% nga PBB. Krahasuar me gjendjen në fund të vitit paraprak, neto-obligimet ndaj pjesës tjetër të botës shënuan një rënie të matur prej 0.2 p.p. të PBB, në situatë të një rritje më dinamike të mjeteve ndërkombëtare krahasuar me rritjen e obligimeve ndërkombëtare. Analiza sektoriale e pozitës ndërkombëtare investuese të ekonomisë kombëtare tregon përmirësim të bankës qendrore dhe institucionet depozituese, por me lëvizje të kundërta të sektorit "shtet" dhe "sektorë tjerë". Ndryshimi pozitiv të bankës qendrore i përshkruhet rritjes së lartë vjetore të mjetet

³⁹Analiza e treguesve për konkurrencën në çmim është e bazuar në indekset e RKEK, të kalkuluar me ponder të bazuar në këmbimin me jashtë pa produkte primare. Produktet primare që mbeten të pa përfshira në përllogaritje janë: nafta dhe derivatet e naftës, çeliku dhe hekuri, mineralet dhe lëndët e para të importuara për kapacitetet e reja prodhuese në zonat e lira ekonomike.


neto, si rezultat i rezervave valutore të rritura. Krahas kësaj, ndryshim pozitiv vjetorë vërehet edhe te institucionet depozituese, ku rënia e obligimeve neto në pjesën më të madhe erdhi si rezultat i zmadhimit të mjeteve në formë të valutave dhe depozitave. Kundrejt të arriturave të këto dy sektorë, se sektori shtet, përkeqësimi vjetorë në tërësi është shkaktuar nga zmadhimi i obligimeve për portfolio investimet e huazara⁴⁰, përderisa rritje e obligimeve neto të "sektorë tjerë" erdhi si rezultat i zmadhimit të obligimeve neto ndaj investitorëve të huaj të drejtpërdrejtë dhe obligimeve për huazimet afatgjata.

Grafik 44
Pozita ndërkombëtare investuese (% e PBB)




Burimi: BPRM.

Grafik 45
Pozita ndërkombëtare investuese sipas sektorëve (% e PBB)




Në fund të vitit, borxhi i jashtëm bruto ishte 5,944.4 milionë euro, përkatësisht 69.8% të PBB, që paraqet një rritje prej 5.4 p.p. nga PBB krahasuar me fundin e vitit 2013. Deri te zmadhimi i borxhit të jashtëm bruto erdhi si rezultat i rritjes së borxhit publik, në rrethana të uljes vjetorë të borxhit të sektorit publik. Rritja e lartë e borxhit publik pasqyrohet gjithashtu nga obligimet afatgjata të qeverisë qendrore në formë të letrave huazuese me vlerë, si rezultat i botimit të euro-obligacionit, situatë kjo e ngarkuar në mënyrë shtesë edhe nga huazimet afatgjata financiare të ndërmarrjeve publike.⁴¹

Grafik 46
Borxhi i jashtëm bruto, klasifikim sipas huazuesve dhe sektorëve institucional (% e PBB)



* Me repo-transakcione të përjashtuara tek borxhi i pushtetit monetar.

Burimi: BPRM.



* Me repo-transakcione të përjashtuara tek borxhi i pushtetit monetar.

⁴⁰ Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014 shteti huazoi në tregjet ndërkombëtare financiare përmes botimit të euro-obligacionit të tretë në vlerë prej 500 milionë euro, si rezultat i çkajit erdhi deri në rritjen e obligimeve të shtetit në bazë të portfolio investimeve. Një rendit, krahas zmadhimit të obligimeve, u shkaktua dhe një akumulim i rritur i rezervave valutore, përkatësisht rritje e duhur e mjeteve neto.

⁴¹ Obligimet e rritura në bazë të huazimeve afatgjata nga jashtë në masë të madhe rezultojnë nga huazimi i ndërmarrjeve publike për financim të infrastrukturës rrugore.

Në përgjithësi marrë, treguesit e huazimit të jashtëm të ekonomisë kombëtare dëshmojnë se borxhi i jashtëm bruto vazhdon të mbetet në suaza të zonës së sigurt. Treguesi i vetëm sipas së cilit shteti mundet të klasifikohet në kategorinë e shteteve me borxh të lartë është participimi i borxhit të jashtëm bruto në PBB. Analiza e dinamikës së huazimit të jashtëm⁴², tregon një përkeqësim të matur te të gjithë treguesit e solventitetit për vitin 2014, krahasuar me fundin e vitit 2013. Nga ana tjetër, treguesit e likuiditetit tregojnë një pozitë më të volitshme të jashtme, me një përmirësim të treguesit përkatës dhe rruajtjes së mbulese së plotë për të gjitha obligimet në bazë të borxheve afatshkurta në maturim me mjete nga rezervat valutore.

Niveli i borxhit të jashtëm neto, si një tregues shtesë për pozitën e jashtme të ekonomisë kombëtare, në fund të vitit 2014 ishte 1,812.8 milionë euro, përkatësisht 21.2% nga PBB. Krahasuar me 31.12.2013 edhe ky tregues tregon një përkeqësim të matur, meqë borxhi i jashtëm neto shënoi rritje prej 2.6 p.p. të PBB. Rritja më e vogël të borxhi i jashtëm neto, në krahasim me rritjen e borxhit bruto vjen si rezultat i shkallës më të lartë të bruto kërkesave të jashtme (për 2.9 p.p. të PBB), për shkak të rezervave të rritura valutore, që dëshmon se një pjesë e të ardhurave nga huazimi i jashtëm në këtë periudhë janë ruajtur në formë të rezervave valutore.

Tabelë 1.

Tregues të stokut të borxhit të jashtëm

	<i>Solventiteti</i>				<i>Likuiditeti</i>		
	Pagesa e interesit/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto-Borxh/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto-Borxh/ PBB	Pagesa e borxhit/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Rezervat valutore/ Borxhi afatshkurtër	Rezervat valutore/ Borxhi afatshkurtër, me maturim të mbetur*	Borxhi afat shkurtër/ Gjithsej borxhi
	në %				raport	raport	në %
12/31/2004	2.41	129.3	47.3	12.4	1.14	0.89	30.3
12/31/2005	2.66	147.0	54.2	11.06	1.67	1.04	26.7
12/31/2006	3.44	131.3	49.8	21.7	1.95	1.34	29.0
12/31/2007	2.78	119.3	51.3	19.4	1.35	1.08	39.8
12/31/2008	2.66	116.9	54.1	10.2	1.29	0.95	35.2
12/31/2009	2.43	131.0	57.8	11.8	1.29	0.94	32.9
12/31/2010	3.22	140.4	59.7	13.9	1.49	0.99	27.9
12/31/2011	3.12	148.4	64.6	16.8	1.78	1.18	25.2
12/31/2012	2.92	141.9	67.6	13.1	1.64	1.03	26.7
12/31/2013	2.51	137.6	67.4	15.8	1.64	1.08	23.3
12/31/2014	3.00	149.2	73.7	17.1	1.88	1.15	21.7
<i>Kriteret për borxh të moderuar</i>	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%	1.00		

* Kriteri për borxh të matur është kalkuluar sipas metodologjisë së Bankës Botërore për kalkulimin e treguesve të huazimit, e cila nënkupton shfrytëzimin e mesatarëve të lëvizshme tremujore të PBB dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve si dhe të ardhurave tjera si faktorë në kalkulimin e treguesve.

E përpunuar në përputhshmëri me "Statistikat e borxhit të jashtëm: Udhëzues për përpilues dhe shfrytëzues" e publikuar nga FMN.

* Sipas rregullës së Grinpan dhe Gvidoti shteti duhet të ketë mbulueshmëri të plotë të borxhit afatgjatë (maturim residual) me rezerva valutore.


Burimi: BPRM.

⁴² Analiza e indikatorëve të borxhit të jashtëm është e përpiluar në bazë të dhënave nga bilanci i pagesave në përputhshmëri me "Rregulloren për bilanc të pagesave dhe pozitën ndërkombëtare investuese" (BPM6) dhe të dhënat për borxh bruto të jashtë në pajtueshmëri me "Doracakun për borxh të jashtëm" (2013). Ndryshimet metodologjike nuk shkaktuan ndryshime në nivelin e borxhit të jashtëm, ndonëse ndikuan mbi strukturën maturuese dhe sektoriale të borxhit. Në përputhshmëri me këtë, niveli i borxhit afatshkurtër sipas metodologjisë së re është më i ulët në llogari të rritjes së komponentës afatgjatë të borxhit, që shkaktoi ndryshime të indikatorët e likuiditetit, përkatësisht përmirësim të tyre krahasuar me analizat e bëra sipas metodologjisë paraprake. Nga ana tjetër, ndryshimet metodologjike të eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të ardhurat tjera shkaktuan përkeqësim të indikatorëve pjesëmarrje e eksportit të mallrave dhe shërbimeve dhe të ardhura tjera në borxhin e jashtëm bruto dhe pagesë e borxhit në relacion me eksportin e mallrave dhe shërbimeve dhe të ardhura tjera, krahasuar me indikatorët e përllogaritur sipas metodologjisë paraprake.

3.5. Agregat monetar dhe kreditor


Gjatë vitit 2014, rritja e aktivitetit në sektorin real, paralelisht me analizat e përmirësuar të bankave për riskun kreditorë dhe pritjet e volitshme për periudhën e ardhshme mundësuan një zmadhim më dinamik të bazës depozituese dhe përshpejtim të përkrahjes kreditore të bankave për sektorin privat. Rritja e realizuar monetare dhe kreditore në vitin 2014 ishte më e lartë se rritja mesatare e këtyre agregat në periudhën pas fazës akute të krizës, përkatësisht pas vitit 2009. Një përmirësim i shprehur u shënua në veçanti të tregu kreditorë, ku u shënuan shkallë më të larta të rritjes së kredive për tërë periudhën e pas krizës. Zhvendosje pozitive u shënuan edhe në aspekt të strukturës së rritjes së kredive në drejtim të kreditimit të zmadhuar për sektorin korporativ. Lëvizjet e tilla treguan një rritje të përshkallëzuar të pritjeve të bankave si dhe të vlerësimeve të tyre për profilin e riskut të kërkesës për kredi, që u vërtetua edhe përmes Anketave për aktivitetin kreditorë të BPRM. Nga ana tjetër, edhe politika monetare vazhdoi ta stimulojë rritjen e kredive përmes politikës së shkallëve të ulëta të interesit. Një përkrahje shtesë për kreditimin u dha edhe përmes masave jostandarde⁴³ dhe ndryshimit të politikës makroprudente që u miratuan gjatë vitit. Zhvendosjet pozitive në tregun e kredive u përkrahën edhe me ndryshimet në cilësinë e portfolit kreditorë në përputhshmëri me dinamikën e ulur të rritjes së kredive jofunkionale.

Grafik 47
Ndryshim vjetor në kreditë dhe depozitat vjetore, në %



Burimi: BPRM.


Grafik 48
Relacioni në mes kredive dhe depozitave



⁴³ Në vitin 2014, kreditë e reja të miratuara në suaza të masës jo standarde për nxitje të aktivitetit kreditues në neto-eksportuesve dhe prodhuesve të energjisë elektrike arritën në 2,883 milionë denarë.

Grafik 49


Pjesëmarrja e kredive të përgjithshme dhe masës valutore M4 në PBB, në %



Burimi: BPRM.

Grafik 50

Pjesëmarrja e ndryshimit vjetorë të kredive të përgjithshme dhe masës valutore M4 në PBB, në %



Shkalla vjetore e rritjes së agregatit më të gjerë monetarë M4 shënoi një përsheptim të konsiderueshëm prej 5.3% në vitin 2013 në 10,5 në fund të vitit 2014. Intensifikimi i tillë i shkallës së rritjes monetare, kryesisht sqarohet me rritjen e depozitëve të sektorit bankar si burim kryesorë i financave të bankave. Në fakt, në kushte të shkallës relativisht të lartë të rritjes së ekonomisë vendore dhe lëvizjeve të volitshme në tregun e punës, vërehet një rritje e kapaciteteve të sektorit korporativ dhe të amvisërive për të krijuar të ardhura shtesë dhe për të plasuar mjetet e lira financiare në sektorin bankar. Kështu, karakteristikë për vitin 2014 ishte përsheptimi i shkallës së rritjes së depozitëve të amvisërive, e në veçanti të sektorit korporativ, që tregon një likuiditet të përmirësuar të ndërmarrjeve me efekte pozitive edhe mbi aftësinë kredituese të sektorit korporativ. Shikuar në strukturë, depozitat afatgjata janë bartësit kryesorë të rritjes së depozitave për tre vite me radhë, që në mënyrë shtesë kontribuon në rritjen e stabilitetit të bazës depozituese. Pritjet stabël për periudhën e ardhshme, besimi në sektorin vendor bankar si dhe përfitimet e rritura nga kursimi afatgjatë janë faktorë që kontribuojnë në rritjen e kursimeve afatgjata gjatë disa viteve të fundit. Depozitat afatshkurta shënuan një rritje të matur në vitin 2014, rritje kjo që erdhi pas zvogëlimit të këtyre depozite gjatë dy viteve paraprake. Paratë e gatshme në qarkullim, si komponenta më likuide e masës valutore, shënuan një rritje të shprehur në krahasim me vitin paraprak, pjesërisht si efekt kumulativ nga pagat dhe pension et e rritura si dhe subvencionet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Tabelë 2.

Komponenta të agregatëve monetarë

	Gjendja			Ndryshimet vjetore			Kontributi në rritjen vjetore të M4		
	12/31/2012	12/31/2013	12/31/2014	12/31/2012	12/31/2013	12/31/2014	12/31/2012	12/31/2013	12/31/2014
	në milion denar	në milion denar	në milion denar	në %	në %	në %	në %	në %	në %
Paratë e gatshme në qarkullim	20,118	20,706	23,221	4.2	2.9	12.1	7.2	4.2	8.5
Paratë në depozitë	45,823	49,299	62,326	9.1	7.6	26.4	34.1	24.7	44.1
M1	65,940	70,005	85,549	7.6	6.2	22.2	41.3	28.9	52.7
Depozitat afatshkurta në denar	57,541	57,112	57,151	-1.3	-0.7	0.1	-6.7	-3.0	0.1
Краткорочни девизни депозити Depozitat	94,228	90,949	90,980	-3.0	-3.5	0.0	-25.6	-23.3	0.1
M2	217,709	218,066	233,679	0.5	0.2	7.2	9.0	2.5	52.9
Depozitat afatgjata në denar	31,688	41,509	51,673	44.3	31.0	24.5	86.4	69.8	34.4
Depozitat afatgjata në valutë të huaj	16,887	20,788	24,527	3.1	23.1	18.0	4.6	27.7	12.7
Gjithsej depozitat (pa paratë në depozitë)	200,344	210,358	224,330	3.4	5.0	6.6	58.7	71.1	47.3
Gjithsej depozitat (me paratë në depozita)	246,167	259,657	286,657	4.4	5.5	10.4	92.8	95.8	91.5
M4	266,284	280,363	309,879	4.4	5.3	10.5	100	100	100


Burimi: BPRM.

Analiza e strukturës valutore të rritjes vjetore të bazës depozitore tregon një rritje në kontinuitet të depozitëve në denarë, që dëshmon besimin e kursyesve në stabilitetin e kursit të këmbimit. Në vitin 2014 u shënuar një rritje e përsheptuar e depozitave në deviza në

krahasim me vitin paraprak, që mundet pjesërisht të sqarohet përmes ndryshimeve të depozitave korporative, si një kategori më e ndryshueshme e cila është nën ndikimin e nevojave për likuiditet të sektorit korporativ⁴⁴. Edhe të amvisëritë u shënua një zmadhim i rritjes së depozitave në valuta të huaja, që mundet të shërbejë si një tregues për shterimin permanent të efekteve të faktorëve të jashtëzakonshëm që në shkallë të madhe kontribuuan në denarizimin e rritur në ekonominë kombëtare në periudhën paraprake⁴⁵ si dhe normalizimin e preferencave valutore për kursim të sektorit privat. Edhe përpos lëvizjeve të tilla, preference për të kursyes në valutën vendore edhe më tej mbeti e shprehur, që mundet të dëshmohet përmes shkallës së rritur të participimit të depozitëve në denarë në rritjen e depozitëve të përgjithshme, që në vitin 2014 arriti në 86%. Rritja më dinamike e depozitëve në denarë në krahasim me rritjen e depozitëve në valuta të huaja kontribuoi për një zvogëlim të mëtejshëm të euroizimit (i matur përmes participimit të depozitave valutore në depozitat e përgjithshme) nga mesatarisht 44.4% në vitin 2013 në 42.4% në vitin 2014. Një konstatim i tillë rezulton edhe nga analiza e strukturës valutore të depozitëve të përgjithshme pa para depozituese. Kështu pjesëmarrja e depozitave valutore në depozitat e përgjithshme (pa para depozituese) në vitin 2014 ishte mesatarisht 52.6% krahasuar me 54.1% në vitin 2013.

Grafik 51

Struktura valutore dhe sektoriale e depozitave të përgjithshme (me para depozituese)



Burimi: BPRM.

Përkrahja solide kreditore e sektorit bankar për ekonominë kombëtare vazhdoi edhe në vitin 2014 edhe atë me një dinamikë të përshpejtuar krahasuar me rritjen mesatare për periudhën pas fazës akute të krizës (2009-2013). Në fund të Dhjetorit, shkalla vjetore e rritjes së kredive të përgjithshme ishte 10% krahasuar me 6.4% në fund të vitit 2013. Rritja vjetore e kredive në vitin 2014 është me e lartë për 1.6 herë krahasuar me vitin paraprak dhe kështu ka shënuar shkallën më të lartë që nga fillimi i krizës globale. Krahas përshpejtimit të rritjes kreditore, karakteristikë e vitit 2014 ishin edhe ndryshimet në strukturën e tij. Në fakt, gjatë vitit 2014 bankat siguruan përkrahje gati se të barabartë për sektorin korporativ dhe për atë "popullsi", për dallim nga viti paraprak kur kreditë për amvisëri shënuan participim më të lartë në shkallën e përgjithshme të kredive të miratuara. Trendet pozitive të aktivitetit kreditorë u konfirmuan edhe me rezultatet nga Anketat për aktivitetin kreditorë të cilat dëshmuan një lehtësim të kërkesave për marrje të kredisë nga ana e bankave për amvisëritë kurse në shkallë më të lartë edhe për sektorin korporativ, paralelisht me rritjen e kërkesës për kredi. Anketat treguan edhe një optimizëm të rritur të bankave lidhur me pritjet e tyre për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik si dhe qëndrime të

⁴⁴ Ndikim të rëndësishëm mbi depozitat e ndërmarrjeve kishte edhe pagesa e dividendit nga ana e një kompanie të madhe vendore ndaj shtetit dhe investitorit të huaj, e cila në vite të ndryshme realizohet me strukturë të ndryshueshme të depozitave, duke shkaktuar ndryshim të strukturës valutore të sektorit korporativ.

⁴⁵ Kjo parasë gjithashtu ka të bëjë me efektet nga eskalimi i krizës evropiane kah fundi i vitit 2011, që rezultoi me rritje të mosbesimit në euro-valutë dhe zmadhim të kursimeve në valutën vendore.


përmirësuar për riskun krahasuar me dy vitet paraprake që në veçanti ka të bëjë me sektorin korporativ⁴⁶. Në fakt, pas një periudhe më të gjatë kohore duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2014, anketat për aktivitetin kreditues të BPRM tregojnë një stabilizim të qëndrimeve të bankave për riskun e kredive për sektorin korporativ. U shënua përmirësim te të gjithë treguesit e analizës së riskut, në ç'rast pritjet për aktivitetin ekonomik në tremujorin e fundit ndikuan për lehtësimin e kërkesave për miratim të kredisë. Te popullsia, pritjet u stabilizuan më herët, përkatësisht diku nga fundi i vitit 2011. Zhvendosjet e tilla nënkuptonin edhe zvogëlim të ndikimit të riskut si faktor kufizues për aktivitetin kreditor. Krahas kësaj u shënua një përmirësim edhe në cilësinë e portofolit kreditor. Kështu kërkesat e dyshimta dhe të kontestueshme gjatë vitit 2014 shënuan një shkallë të ngadalësuar të rritjes prej mesatarisht 18.5% në vitin 2013 në 7.5% në vitin 2014. Në fund të Dhjetorit, pjesëmarrja e kredive jofunksionale në stokun e përgjithshëm të kredive ishte 11.1% (11.3% në vitin 2013).

Grafik 52


Oferta, kërkesa dhe shqyrtimi i riskut të bankave⁴⁷

(Neto-përqindje)

Sektori korporativ



Sektori "popullsisë"




Burimi: Anketat për aktivitetin kreditor, BPRM.

Të arriturat në aktivitetin kreditorë në vitin 2014 janë një sinjal i mirë që tregon një ringjallje të aktivitetit kreditorë si dhe shëndetësim të përsheptuar të tregut kreditor. Ato gjithashtu dëshmojnë një efekt të transferuar të relaksimit të deritanishëm monetar dhe karakterit adaptues të politikës monetare edhe gjatë vitit 2014. Kjo në veçanti ka të bëjë me sektorin korporativ i cili shënoi një intensitet më të lartë të plasimit të kredive në vitin 2014 që nga fillimi i krizës. Paralelisht me këtë, u shënua edhe rritje e kredive afatgjata të ndërmarrjeve për dallim nga viti paraprak kur në bazë vjetore u shënua një stagnim i kreditimit afatgjatë. Megjithatë, edhe pranë zhvendosjeve pozitive, duhet pasur parasysh se bëhet fjalë për një periudhë relativisht të shkurtër të ngjalljes intensive të aktivitetit kreditues ndaj sektorit korporativ. Pra, nevojitet një periudhë më e gjatë kohore për të përfunduar një ndryshim të qëndrimeve të bankave vendore ndaj këtij segmenti.


⁴⁶ Për më shumë detaje në lidhje me Anketat për aktivitetin kreditorë të BPRM shfrytëzo linkun në vijim: <http://ëëë.nbrm.mk/?ItemID=F7AC78DEE498764FBAF39049F726CE3C>.

⁴⁷ Sqarim: Oferta ka të bëjë me ndryshimin e kushteve kredituese (po qese përqindja neto është pozitive në atë rast kushtet kredituese janë të ashpërsuara kurse po qese është zero në atë rast ato janë më të relaksuara); kërkesa për kredi (po qese përqindja neto është pozitive në atë rast kërkesa është rritur, kurse po qese ajo është negative atëherë kërkesa është zvogëluar); faktorët e riskut që ndikojnë mbi parakushtet për kreditim (po qese përqindja neto është pozitive në atë rast kushtet kredituese janë të ashpërsuara kurse po qese është negativ në atë rast ato janë më të relaksuara). Në Grafikun që ka të bëjë me popullsinë është paraqitur mesatarja e përqindjes neto të faktorëve të riskut që ndikojnë mbi kushtet kredituese gjatë miratimit të kredive banesore si dhe të atyre që ndikojnë mbi kreditë për konsum. Në faqen zyrtare të BPRM mundet të gjendet informata më të detajuara mbi aktivitetin kreditues.

Grafik 53
Struktura valutore dhe sektoriale e kredisë së përgjithshme



Burimi: BPRM.



IV. Ambienti makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2015 dhe 2016

Në pajtim me dispozitat ligjore, politika monetare e BPRM edhe në periudhën e ardhshme do të fokusohet në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si qëllim kryesor monetar, dhe do të vazhdojë të kontribuojë drejt ruajtjes së një sistemi të qëndrueshëm dhe konkurrues financiar të orientuar drejt tregut. BPRM do t'a mbështesë edhe politikën e përgjithshme ekonomike pa e rrezikuar realizimin e qëllimit kryesor dhe në përputhje me parimin e një ekonomie të hapur të tregut me konkurrencë të lirë. Në aspekt të strategjisë monetare, BPRM edhe me tej do të vazhdojë me zbatimin e strategjisë së ruajtjes së kursit të qëndrueshëm nominal të këmbimit kundrejt euros. Roli i kursit të këmbimit si një esperancë nominale buron nga karakteristikat e ekonomisë së vendit, si një ekonomi e vogël dhe e hapur me varshmëri të lartë nga importet e produkteve primare. Në kushte të këtilla, rritet rëndësia e kursit të këmbimit në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe pritjeve inflacioniste të qëndrueshme të subjekteve ekonomikë. Sipas pritjeve, zbatimi i politikës monetare në dy vitet e ardhshme do të zhvillohet në një mjedis relativisht të qëndrueshëm, pa ndikimin e pabarazive të rëndësishme të brendshme dhe të jashtme. Projektionet e fundit të BPRM në tetor 2014, parashikojnë ekonomia të vazhdojë të rritet me një ritëm të përsheptuar, para së gjithash për shkak të eksporteve dhe investimeve. Pritet që sektori bankar të vazhdojë të mbështesë rritjen ekonomike nëpërmjet rritjes së aktivitetit kreditues. Pritet një gjendje e favorshme në sektorin e jashtëm edhe në dy vitet e ardhshme, edhe përkundrejt vlerësimeve për zgjerimin e moderuar të deficitit në pajtueshmëri me përforcimin e aktivitetit ekonomik. Rruga e projektuar e rezervave valutore edhe më tej udhëzon në ruajtjen e treguesve të mjaftueshmërisë në zonën e sigurt. Inflacioni do të jetë i moderuar dhe do të lëviz rreth mesatares historike prej rreth 2%, në prani të rreziqeve në rëni, për shkak të lëvizjeve të çmimeve të importit. Në kushte të këtilla të favorshme ekonomike, në periudhën e ardhshme BPRM kryesisht do të synojë drejt ndjekjes së realizimit të trajektores së projektuar të rezervave valutore dhe zhvillimeve në tregun valutor, dhe në përputhje me të do të rregullojë politikën monetare.

Realizimi i kornizës së projektuar makroekonomike është e shoqëruar me rreziqe të cilët kryesisht dalin nga mjedisi i jashtëm. Pastaj, rreziqet që mund të rrjedhin në ekonominë e vendit nëpërmjet kanaleve të ndryshme kryesisht janë të lidhura me dinamikën e rimëkëmbjes së rritjes ekonomike globale, si dhe lëvizjeve të çmimeve të produkteve primare në bursat botërore. Kjo veçanërisht vlen për euro zonën, si partneri më i madh i jonë tregtar, ku rimëkëmbja ekonomike zhvillohet me një ritëm më të ngadalësuar dhe çon në prolongim të rimëkëmbjes. Masa e fundit e ndërmarrë e BQE në janar të vitit 2015⁴⁸, e cila parashikon lehtësim të rëndësishëm sasior që i zbut rreziqet negative për rritjen e ekonomisë evropiane. Megjithatë, merr kohë për të parë se në çfarë mase do të përcjellët kjo politikë në sektorin real të ekonomisë së eurozonës. Si faktor rreziku mbeten dhe efektet e trazirave gjeopolitike, kryesisht që lidhen me situatën në Lindjen e afërt dhe Ukrainën. Rreziqet e këtyre zhvillimeve mund të shihen nga parashikimet e rënda dhe të paqëndrueshme të çmimeve të energjisë dhe të produkteve të drithërave, dhe gjithashtu mund të ndikojnë edhe në rimëkëmbjen pritur ekonomik. Realizimi eventual i rreziqeve të lartpërmendura do të thotë edhe ndryshim i ambientit për realizimin e politikës monetare, krahasuar me pritjet kryesore.

⁴⁸ Për detajet mbi masat e lehtësimit sasior të ndërmarra nga BQE në janar, shih në kuadër të pjesës Mjedisi ekonomik ndërkombëtar.

Në kushte të përforcimit të rritjes së ekonomisë së vendit, në periudhën e ardhshme pritet rritje graduale e inflacionit, e cila sipas parashikimeve të tetorit do të lëviz rreth 1% për vitin 2015 dhe rreth 2% për vitin 2016. Rritja e çmimeve në vitin 2015 kryesisht do t'i pasqyrojë ndryshimet e çmimeve të produkteve ushqimore, dhe pak rritjen e mëtejshme të kërkesës vendore. Pritet që çmimet e energjisë të kenë një kontribut negativ në inflacion në vitin 2015⁴⁹. Një përshpejtim i moderuar i inflacionit do të vazhdojë edhe në vitin 2016 me pritje për stabilizim të çmimeve të importit dhe rritje të presioneve të çmimeve nga kërkesat. Rreziqet për inflacion kryesisht janë nga natyra e jashtme dhe janë të lidhura me pasigurinë e efekteve nga faktorët klimatik dhe nga marrëdhëniet gjeopolitike – kriza në Lindjen e afërt dhe kriza e Ukrainës. Informacionet më të reja në dispozicion drejtojnë në përgjithësi në rreziqe që janë në rënie për inflacionin në periudhën e ardhshme. Vlerësimet e këtilla lidhen me ndryshimet në projeksionet për çmimet botërore të produkteve primare, kryesisht në çmimet e energjisë, të cilat në periudhën pas projeksioneve të tetorit në mënyrë të konsiderueshme ishin të reviduara. Megjithatë, duhet pasur parasysh se supozimet e jashtme janë objekt i korrigjimeve të shpeshta dhe mundësitë për ndryshime të papritura tek këto kategori janë të mëdha, e cila e rrit pasigurinë në lidhje me trendet e ardhshme të çmimeve të importit dhe me këtë edhe efektet e tyre në inflacionin e vendit. Në lidhje me faktorët vendor, kushtet jo të volitshme të motit në ekonominë e vendit nga fillimi i vitit 2015 konsiderohen si faktor shtesë të rrezikut për inflacion, që ka mund të veprojnë në drejtim të lartë, edhe pse efekti i tyre tani vështirë mund të vlerësohet.

Pritet që trendet e favorshme ekonomike, që ishin karakteristike për vitin 2014, të vazhdojnë edhe në periudhën e ardhshme dyvjeçare, me një përshpejtim gradual të normës së rritjes ekonomike. Gjegjësisht, shfrytëzimi më i madh i kapaciteteve të investitorëve të huaj të pranishëm, si dhe hyrja e investitorëve të ri dhe pulsi fiskal⁵⁰ edhe më tej pritet që t'i stimulojnë eksportet dhe investimet. Këta faktorë pasqyrohen si kushte të volitshme edhe në tregun e punës edhe në pritjet e konsumatorëve, me të cilën pritet që konsumi të vazhdojë të rritet dhe të ketë një kontribut solide pozitive në rritjen ekonomike. Sipas supozimeve të këtilla, pritet që kërkesa vendore edhe më tej të paraqitet si i burim i rritjes ekonomike, me aktivitet të dukshëm më intensiv të investimeve, derisa neto eksporti do të ketë një kontribut negativ në rritjen ekonomike. Megjithatë, deri në fund të periudhës së parashikimeve, vlerësimet tregojnë një balancim gradual të strukturës së rritjes, me një reduktim gradual të kontributit negativ të neto eksporteve. Në kushte të këtilla, vlerësohet se rritja e PBB në vitin 2015 do të arrijë në 4.1%, dhe në vitin 2016 të rritet në 4.5%. Duke pasur parasysh ekonominë tepër të hapur, rreziqet për rritjen e projektuar edhe më tej dalin nga mjedisi global dhe zhvillimet në mjedisin e jashtëm.

Në kushte solide të likuiditetit dhe solventitetit, pritet rimëkëmbja ekonomike, mjedisi më stabil, rritja e potencialit depozitues të bankave, si dhe masat tashmë të ndërmarra nga autoritetet monetare, të kontribuojnë për mbështetje më të madhe financiare për ekonominë e vendit përmes sektorit bankar. Në vitin 2014 ishte realizuar një rritje solide kreditore prej 10% në bazë vjetore, që njëkohësisht është edhe mbi pritjet në kuadër të projeksionit të tetorit. Rritja e gjithsej e kredive në vitin 2015 është projektuar në 9%, përderisa deri në fund të vitit 2016 vlerësohet se rritja kreditore do të përshpejtohet dhe do të arrijë në 10%. Rritja kreditore e pritur i reflekton sinjalet pozitive të anës së kërkesës dhe ofertës. Gjegjësisht, rritja e pritshme e konsumit të brendshëm do të kontribuojë në rritjen e kërkesës për kredi. Për më tepër, në kushte të përshpejtimit të pritur të rritjes ekonomike pritet rritje e mëtejshme të burimit kryesor të financimit të bankave - bazës së depozitave, i

⁴⁹ Këto pritje janë të bazuar në supozimin se nuk do të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike. Efekti i vlerësuar në inflacionin mesatar vjetor nga një rritje e mundshme të çmimit të energjisë elektrike në mes të viti 2015 prej 10% do të ishte 0.4 pikë përqindje.

⁵⁰ Në përputhje me strategjinë fiskale viti 2015 - 2017.

cili do të kontribuojë në rritjen e ofertës së kredisë së bankave. Gjithashtu në këtë drejtim do të veprojnë edhe perceptimet stabile për rrezik të bankave dhe masat deri tani të ndërmarra nga BPRM. Në kuadër të rreziqeve, dinamikës së aktivitetit kreditues në periudhën e ardhshme, si deri më tani, mbetet për t'u përcaktuar nga shkalla e rimëkëmbjes së ekonomisë, si parakusht për rritjen e depozitave potenciale dhe faktor që ndikon mbi pritshmëritë e bankave dhe prirjen për huamarrjen e sektorit privat.

Projeksionet për vitin 2015 dhe 2016 tregojnë një pozicion të jashtëm e cila do të sigurojë mbajtjen e mëtejshëm të rezervave valutore në nivelin e duhur. Pritet që deficitin i llogarisë rrjedhëse të zgjerohet në 3.9% të PBB-së në vitin 2015 dhe 4.6% të PBB-së në vitin 2016. Vlerësimet e këtilla bazohen në supozimet për reduktimin e pjesëmarrjen relative të të ardhurave sekondare (transferimeve rrjedhëse) të PBB-së. Në anën tjetër, pritet stabilizimi i deficitit në këmbimin e mallrave dhe shërbimeve, ku në këtë domen ekzistojnë rreziqe pozitive për efekte më të mëdha nga kompanitë e reja të eksportit në krahasimin me pritjet. Kështu rruga e projektuar e deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe struktura e saj na tregojnë në jobarasueshmëri më të mëdha në ekonomi, ku në një periudhë afatmesme pritet ngushtimin i deficitit si një efekt pozitiv nga vlera e shtuar gjithnjë më e madhe e investimeve të huaja. Në kuadër të financimit, pritet që edhe në periudhën e ardhshme struktura e të ardhurave kapitale të paraqesë kombinim të flukseve të borxhit dhe atyre jo të borxhit. Pritet që investimet direkte gradualisht të rriten dhe të arrijnë 3.8% të PBB-së në vitin 2015 dhe 4% e PBB-së në vitin 2016. Në aspekt të rezervave valutore, pas rritjes së tyre në vitin 2014, në vitin 2015 pritet që transaksionet në bilancin e pagesave të çojnë në rënien e rezervave valutore. Dinamika e këtyre rezervave valutore në pjesën më të madhe është kushtëzuar nga shteti, gjegjësisht nga sasitë e larta për shlyerjen e borxhit të jashtëm të këtij sektori që maturojnë në vitin 2015 në kushte kur mjetet për shlyerjen e këtyre detyrimeve ishin të siguruara nga huamarrja e shtetit në tregun ndërkombëtar të kapitalit në vitin 2014⁵¹. Gjatë vitit 2016 përsëri krijohet hapësirë për akumulimin e rezervave valutore, në bazë të supozimeve për rritje graduale të investimeve të huaja dhe borxhit financiar të sektorit privat, por edhe në bazë të të ardhurave të mëtejshme nga borxhi për shtetin (në përputhje me strukturën e financimit të nevojave buxhetore, e dhënë në strategjinë e fundit fiskal të vitit 2015-2017). Rruga e projektuar e rezervave valutore edhe më tej drejton në ruajtjen e treguesëve të mjaftueshmërisë së rezervave në zonën e sigurt. Rreziqet kryesore rreth pozicionit të jashtëm të ekonomisë në periudhën e ardhshme dhe më tej rrjedhin nga dinamika e rimëkëmbjes globale, dhe me atë, edhe në rritjen ekonomike të vendit dhe ndikimi i tij në perceptimet e investitorëve.

Në dy vitet e ardhshme pritet një politikë e matur fiskale, me një konsolidimin gradual të deficitit buxhetor dhe nivel relativisht të qëndrueshëm të borxhit publik⁵². Politika fiskale është një faktor i rëndësishëm që ndikon në pozicionimin e politikës monetare, dhe një koordinimi i duhur i këtyre politikave është një faktor kyç në arritjen e qëndrueshmërisë së pozicionit të jashtëm të vendit dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Në periudhën e ardhshme pritet një ngushtim gradual i deficitit buxhetor deri në 3.2% të PBB-së në vitin 2016. Investimet publike edhe me tej mbeten qëllim parësor i politikës fiskale. Pra, në periudhën e ardhshme është e parashikuar realizimi i projekteve të mëdha investimeve në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, në infrastrukturën komunale dhe në sektorin e energjisë, në bujqësi dhe kështu me radhë. Është e parashikuar financimi i deficitit të sigurohet nga burime të vendit dhe te jashtme. Për më tepër, në kuadër të burimeve të

⁵¹ Në vitin 2014, shteti emetoi Eurobond-in e tretë në vlerë prej 500 milionë euro, me afat maturimi prej shtatë vjet dhe me normë të kthimit prej 4.25%, përkatësisht normë interesi prej 3.975% në vit. Në fillim të vitit 2015 shteti realizoi pagesë të parakohshme të detyrimeve në bazë të linjës kreditore për maturi nga FMN-ja.

⁵² Projeksionet në fushën e politikës fiskale janë të marra nga Strategjia Fiskale e Republikës së Maqedonisë për vitin 2015 – 2017, tetor 2014.

brendshme është planifikuar shfrytëzimi i një pjese të depozitave të akumuluar të shtetit në Bankën popullore, si dhe emetimin e letrave me vlerë të shtetit me afat maturimi më të gjatë, që pritet të kontribuojë në përforcim dhe zhvillimin të mëtejshëm të tregut të letrave me vlerë të vendit. Korniza e këtillë fiskale e përcaktuar parashikon një rritje të moderuar të borxhit të shtetit në periudhën e ardhshme, e cila nuk do ta rrezikojë qëndrueshmërinë e financave publike. Politika e përcaktuar fiskale ndiqet me rreziqe të cilat, njëjtë si tek politika monetare, burojnë kryesisht nga mjedisi i jashtëm dhe ndikimi i tij mbi aktivitetin ekonomik vendor, si dhe mundësinë e qasjes në tregje të huaja financiare.

V. Instrumentet monetare


Banka popullore në vitin 2014 i mbajti të pandryshuara normën bazë të interesit dhe ofertën e ankandeve të bonove të thesarit, ndërsa për të kanalizuar likuiditetin e tepërt drejt sektorit privat jo-financiar i uli normat e interesit të depozitave në dispozicion. Duke pasur parasysh kontributin pozitiv të masës jo-standarde rezervave të detyrueshme⁵³ të bankave në vitin e kaluar, dhe për të siguruar mbështetje shtesë për sektorë me rëndësi sistematike për ekonominë vendase, Banka popullore ka vazhduar zbatimin e kësaj mase edhe për një vit, deri në fund të vitit 2015.

5.1. Bonot e thesarit

Në vitin 2014, në ankandet e bonove të thesarit Banka popullore ka vazhduar të zbatojë tenderë me sasi (sasi të kufizuara të ofertës dhe normë interesi fikse).⁵⁴ Ndërsa, në funksion të shërimit gradual dhe të qëndrueshëm të sektorit privat, Banka popullore e ruante sasinë e bonove të thesarit në nivel të 25,500 milionë denarë. Në kushtet e rritjes ekonomike solide, mungesa e presioneve të çmimeve dhe e pozicionit të favorshëm të bilancit të pagesave, të cilat krijojnë kushte për mirëmbajtjen e rezervave valutore në nivelin e duhur, Banka popullore e mbajti normën e interesit të instrumentin bazik në të njëjtin nivel prej 3.25%.⁵⁵


Në gjysmën e parë të vitit 2014, interesi i bankave për bonot e thesarit është mbajtur në nivel relativisht stabil krahasuar me potencialin e tyre likuidues. Kërkesa e bankave për bonot e thesarit ishte mesatarisht 33,860 milionë denarë dhe ishte më e lartë se likuiditeti i tyre potencial për 10%.⁵⁶

Grafik 54
Ankandet e bonove të thesarit



Burimi: BPRM.

Grafik 55
Raporti kërkesë/potencial



⁵³ Masa, e cila mundëson reduktim të bazës së rezervave të detyrueshme të bankave për shumën e kredive të reja dhe investimeve në letrat me vlerë të borxhit në valutën vendase pa klauzolë valutore emetuar nga eksportuesit neto dhe prodhuesit vendas të energjisë elektrike, u fut në fund të vitit 2012 dhe ka filluar të zbatohet nga viti 2013.

⁵⁴ Ankandet e bonove të thesarit mbahen në ditën e parë të periudhës së rezervave të detyrueshme (Vendimi mbi bonot e thesarit, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 166/13).

⁵⁵ Ndryshimi i fundit në normën e interesit të bonove të thesarit është bërë në korrik të vitit 2013, kur filloi të aplikohet tenderi me sasi (sasi të kufizuara të ofertës dhe normë interesi fikse).

⁵⁶ Likuiditeti potencial i bankave është llogaritur në bazë të Metodologjisë për përcaktimin e kërkesës potenciale për bonot e thesarit. Metodologjia u prezantua në dhjetor të vitit 2013, me qëllim të përcaktimit të kërkesës për bonot e thesarit nga bankat në nivelin e likuiditetit potencial të bankave.


Në gjysmën e dytë të vitit u rrit interesi i bankave për të investuar në bonot e thesarit. Në funksion të kanalizimit të likuiditetit të tepërt në sektorin privat jo-financiar, në shtator Banka popullore *ka rishikuar mekanizmin për transmetimin e kërkesës më të lartë për bonot e thesarit mbi potencialin depozitave në disponim në shtatë ditë*, me çka mjeteve të ndara në këtë bazë ka filluar t'u zbatojë normë interesi prej 0%. Ky ndryshim çoi në një reduktim të njehershëm të kërkesës për bono thesari në nivelin e likuiditetit potencial. Deri në fund të vitit, me rritje të vazhdueshme të likuiditetit potencial të bankave nën ndikimin e faktorëve autonome, bankat kishin rritur interesin për bonot e thesarit të Bankës popullore, me çka ankandonin dukshëm mbi potencialin e tyre të likuiditetit.

Shtojca 1. Shqyrtimi flukseve të krijimit dhe tërheqjes së likuiditetit në vitin 2014

Likuiditeti në sistemin bankar, analizuar nëpërmjet gjendjes së llogarive të bankave në Bankën popullore, në fund të vitit 2014 ishte 19,908 milionë denarë dhe ishte më i lartë për 4,088 milionë denarë krahasuar me fundin e vitit 2013. Duke analizuar sipas dinamikës, rritja më e shpejtë e likuiditetit të bankës u gjenerua në tremujorin e fundit të vitit, kur likuiditeti i bankës u rrit për 3,061 milionë denarë.


Ndikimi i faktorëve autonome në vitin 2014 ishte në drejtim të rritjes së likuiditetit të bankave për 11,449 milionë denarë. Në korniza të tyre, transaksionet qeveritare kishin një efekt në rritjen e likuiditetit të bankës⁵⁷, ndërkohë që rritja e parasë në qarkullim⁵⁸ dhe ndërhyrjet valutore të Bankës popullore me bankat-mbështetëse vepronin për të zvogëluar likuiditetin e bankave.

Grafik 56
Rrjedhat e krijimit dhe tërheqjes
së likuiditetit



Burimi: BPRM.

Grafik 57
Teprica mesatare e likuiditetit
mbi rezervat e detyrueshme



Në kushtet kur faktorët autonome ndikonin në rritjen e likuiditetit, ndërsa oferta e ankandit të bonove të thesarit në vitin 2014 mbahej në nivelin e vitit 2013, një pjesë e likuiditetit të tepërt të bankave janë vendosur në depozita në dispozicion tek Banka Popullore, me çka nëpërmjet instrumenteve monetare në vitin 2014 janë tërhequr 7,361 milionë denarë. Teprica mesatare e aktiveve likuide mbi rezervat e detyrueshme për vitin

⁵⁷ Në vitin 2014 u realizua deficit buxhetor prej 4.2% të PBB.


⁵⁸ Mbi rritjen e parasë në qarkullim, e cila ishte më e fortë në bazë vjetore, kontribut më të madh kishte forcimi i konsumit privat, i mbështetur kryesisht nga: rritja e pagave reale neto në vend (në krahasim me rënien e vazhdueshme në tre vitet e fundit), shpenzimet më të larta buxhetore për mbështetje të prodhimit bujqësor, rritja e pensione dhe rritja më e madhe vjetore në kreditë konsumatore.

2014 do të ishte 1.7% dhe në krahasim me vitin 2013 ishte më e lartë për 0.9 p.p. Mbi tepricën mesatare më të lartë ka ndikuar efekti i njëhershëm në tremujorin e parë të vitit.⁵⁹ Po që se izolohet efekti i këtij faktori, likuiditeti i tepërt mesatar në llogaritë e bankave mbi rezervën e detyrueshme për vitin 2014 do të kishte qenë 0.6% (më i ulët për 0.2 p.p. krahasuar me vitin 2013), që tregon një vazhdimësi të trendit të uljes së tepricës mesatare të mjeteve likuide të bankave në raport me rezervën e detyrueshme, si një tregues i rritjes së efikasitetit në menaxhimin e likuiditetit.

5.2. Depozitat dhe kreditë në dispozicion në Bankën popullore


Në vitin 2014, bankat në mënyrë aktive i kanë përdorur depozitat në dispozicion në Bankën popullore për menaxhimin e likuiditetit brenda periudhës së rezervës së detyrueshme.⁶⁰ Rritje më e shpejtë e depozitave në dispozicion të bankave në Bankën popullore është regjistruar në fund të vitit, që përgjigjet me rritjen e likuiditetit të bankave nën ndikimin e faktorëve autonome. Gjithashtu, mbi gjendjen e depozitave në dispozicion me afat maturimi prej shtatë ditësh kishte ndikim edhe prirja e madhe e bankave për të rritur pjesëmarrjen në gjendjen e bonove të thesarit⁶¹, që do të thoshte një ndryshim në dinamikën e këtij instrumenti brenda periudhës të rezervës së detyrueshme. Në vitin 2014, gjendja e depozitave në dispozicion me afat maturimi prej shtatë ditësh ishte mesatarisht 5,934 milionë denarë dhe ishte më e lartë për 1,862 milionë denarë (ose për 46%), në krahasim me gjendjen mesatare gjatë vitit 2013.

Grafik 58
Gjendja e depozitave në dispozicion



Burimi: BPRM.

Grafik 59
Dinamika e depozitave shtatë ditore




⁵⁹ Mbatja e një niveli relativisht të lartë të aktiveve likuide është kryesisht ishte një reflektim i strategjisë për kufizimin e shumës së plasimeve me qeverinë monetare dhe shtetërore tek një bankë mesatare.

⁶⁰ Plasimi i mjeteve likuide në depozita të disponueshme në Bankën popullore është nën iniciativën e bankave. Për dallim nga depozitat njëditore në dispozicion të cilat janë në dispozicion të bankave çdo ditë, mundësia për plasimin e mjeteve likuide në depozita me afat shtatë-ditor është në dispozicion të bankave njëherë në javë, gjegjësisht çdo të mërkurë.


⁶¹ Në kushte të zbatimit të rregullës për shpërndarje konforme të bonove të thesarit, bankat bënë ankande me shumë më të mëdha me qëllim të realizimit të pjesëmarrjes më të madhe në shumën e bonove të thesarit.

Grafik 60
Korridori i normave të interesit



Burimi: BPRM.

Grafik 61
Dinamika e depozitave njëditore



Bankat i kanë përdorur depozitat njëditore në dispozicion për plasimin e likuiditetit të tepërt në fund të ditës së punës, me çka interesi i bankave për këtë instrument ka qenë më i lartë në fund të periudhës së rezervës së detyrueshme. Në vitin 2014, gjendja e aktiveve likuide të bankave të plasura në depozitat njëditore ishin mesatarisht 999 milionë denarë, që është mesatarisht shumë më e lartë (rreth 297 milionë denarë) krahasuar me vitin e kaluar.

Në qëllim që të forcohen mekanizmi për drejtimin e tepërisë së mjeteve likuide të bankave në investime afatgjata, duke pasur parasysh se funksioni themelor i depozitave në dispozicion është neutralizimi i luhatjeve afatshkurtra të likuiditetit brenda periudhës së rezervës së detyrueshme, në vitin 2014, Banka popullore i uli normat e interesit të depozitave në dispozicion. Në shkurt të vitit 2014, norma e interesit për depozitat shtatëditore në dispozicion u zvogëlua nga 1.5% në 1.25%, ndërsa në tetor të vitit 2014, njëkohësisht u reduktuan normat e interesit për të dy instrumentet, për 0.25 p.p., në nivel prej 1.0% dhe 0.5%, respektivisht.

Në vitin 2014, bankat përdorën kreditë njëditore në dispozicion vetëm dy herë, për një shumë totale prej 1,100 milionë denarë. Norma e interesit për këtë instrument në vitin 2014 ka mbetur e pandryshuar dhe ishte 3.75%.

5.3. Rezervat e detyrueshme


Në vitin 2014, Banka popullore vazhdoi të zbatojë normat e diferencuara të rezervave të detyrueshme⁶², gjë që ka ndikuar në mbështetjen e mëtejshme të kursimeve në valutën vendase. Detyrimet e bankave për valutën vendase kishin kontribut të qëndrueshëm dhe dominant (prej 7.3 p.p.) në rritjen vjetore të totalit të detyrimeve që përbëjnë bazën e rezervave të detyrueshme (8.4%). Pjesëmarrja relative e detyrimeve në valutën vendase në totalin e detyrimeve të bankave u rrit për 2.7 p.p. çdo vit dhe në fund të vitit 2014 arriti

⁶² Norma e rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutën vendase është 8%, për detyrimet në valutë të huaj është vendosur në një nivel prej 15%, ndërsa një normë prej 20% aplikohet për detyrimet në valutën vendase me klauzolë valutore. Normë e rezervës së detyrueshme prej 0% zbatohet për detyrimet e bankave për persona fizik me maturitetin kontraktual mbi dy vite; repo-transaksionet në valutën vendase; letra me vlerë të borxhit të emetuara në monedhën vendase dhe maturimin origjinal prej sëpaku dy vjet; dhe për shoqëritë jorezidente - financiare në valutë vendase, në valutë vendase me klauzolë në valutë të huaj dhe në valutë të huaj, me maturitetin kontraktual mbi një vit dhe detyrimet ndaj jorezidentëve në valutë vendase, në valutë vendase me klauzolë valutore dhe në valutë të huaj, me maturitetin kontraktual mbi dy vjet. Për më tepër, 30% e rezervës së detyrueshme në valutë të huaj përmbushet në denarë. Që nga shkurti 2014, Banka popullore nuk paguan kompensim për rezervën e detyrueshme.

nivelin më të lartë historik prej 55.1%⁶³, që tregon një trend të vazhdueshëm të de euroizimit.


Zbatimi i normës së rezervave të detyrueshme prej 0% në një pjesë të detyrimeve të personave fizik⁶⁴ ka kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së maturimit të detyrimeve bankare. Kështu, në vitin 2014, rritja e depozitave të ekonomive familjare ishte kryesisht për shkak të rritjes së depozitave me afat (në monedhën vendase dhe të huaj), të cilat ishin subjekt rezervës së detyrueshme prej 0%, ndërsa depozitat afatshkurtra kishin një kontribut të vogël në ndryshimin e depozitave të personave fizik. Nga ana tjetër, aplikimi i 0% në një pjesë të detyrimeve ndaj jo-rezidentëve ka pasur një ndikim relativisht të kufizuar mbi rezervat e detyrueshme, duke pasur parasysh kthimin e mëtutjeshëm të borxhit nga bankat në bazë të linjave të kreditit nga jashtë. Në përputhje me këto trende, aplikimi i normës së rezervave të detyrueshme prej 0% në një pjesë të detyrimeve të bankave në vitin 2014 ka ndikuar në lirin e mjeteve likuide në sistemin bankar në vlerë totale prej 66 milionë denarë.

Grafik 62
Kontributet në normat e rritjes vjetore të detyrimeve të bankave




Burimi: BPRM.

Grafik 63
Kontributet në normat e rritjes vjetore të depozitave të ekonomive familjare




Grafik 64
Kreditë e reja të miratuara në sektorë të zgjedhur



Burimi: BPRM.

Grafik 65
Efekti kumulativ i likuiditetit prej masave në rezervën e detyrueshme



Në kushte të zbatimit të mëtejshëm të matësit jo-standard për rezerva të detyrueshme, shumica e kredive të miratuara tek sektorët me rëndësi sistematike të


⁶³ Efektet nga zbatimi i normave të diferencuara mbi rezervat e detyrueshme vlerësohen në bazë të të dhënave për detyrimet e bankave të përfshira në bazën për llogaritjen e rezervës së detyrueshme.

⁶⁴ Që nga fillimi i vitit 2012 për këto depozita zbatohet normë e rezervës së detyrueshme prej 0%.

ekonomisë së vendit në vitin 2014 u rrit për 2.883 milionë denarë (në nivel të 9.878 milionë denarë), ashtu që ky matës kishte një kontribut shtesë në rritjen e veprimtarisë e kreditorë të bankave. Duke analizuar strukturën, rritja vjetore (41%) në totalin e kredive të miratuara për këta sektorë (eksportuesit-neto dhe prodhuesit e energjisë elektrike) ishte për shkak të kredive për eksportuesit neto, të cilat kanë pjesëmarrjen dominante (prej 96%) ke kreditë e miratuara tek sektorët me rëndësi sistematike të ekonomisë së vendit. Trende relativisht të volitshme janë vërejtur edhe në strukturën valutore të kredive të miratuara tek neto-eksportuesit dhe prodhuesit e energjisë elektrike, kështu që në vitin 2014 regjistruan rritje më të fortë kreditë në denarë (për 2,573 milionë denarë), pjesëmarrja relative e të cilëve në shumën e kredive të reja, të targtuara në fund të vitit arriti në 59%. Analizuar sipas bankave, interes më të madh për shfrytëzimin e matësit kanë bankat e mëdha të cilat janë të përfshira në shumën totale të kredive të reja të dhëna me 83%, ndërkohë që bankat e vogla dhe të mesme kanë aktivitet dukshëm më të ulët në këtë segment të kreditimit. Si rezultat i reduktimit të bazës së rezervës së detyrueshme në denarë bazuar në kreditë e reja të miratuara për eksportuesit-neto dhe prodhuesit e energjisë elektrike, në vitin 2014 rezerva e detyrueshme në denarë ishte më e ulët për 262 milionë denarë.


Zbatimi i këtyre masave makropudente tek rezerva e detyrueshme në vitin 2014 kishte për qëllim lëshimin e mjeteve likuide në sistemin bankar në vlerë prej 328 milionë denarë, me çka efektin kumulativ i këtyre masave nga fillimi i zbatimit të tyre, përfundimisht me dhjetor 2014, është 3,519 milionë denarë. Efekti i kombinuar i aplikimit të masave jo-standarde në rezervat e detyrueshme dhe rritja e detyrimeve të bankave në vitin 2014, çoi në një rritje në rezervat e detyrueshme totale të bankave për 1,494 milionë denarë.

Grafik 66
Aplikimi i rezervës së detyrueshme



Burimi: BPRM.

Grafik 67
Zbatimi i rezervës së detyrueshme



Në vitin 2014, dinamika e përmbushjes së rezervës së detyrueshme dallonte nga viti paraparak. Kështu që, për dallim nga viti 2013, kur bankat në fillim të periudhave të rezervave të detyrueshme akumulonin tepriçë të mjeteve likuide, në vitin 2014 bankat i fillonin periudhat e përmbushjes me nivele më të ulëta të mjeteve likuide në raport me rezervën e detyrueshme, ndërsa deri në fund të periudhës akumulonin mjete likuide për t'a përmbushur rezervën e detyrueshme. Ndikim më të madh për ndryshimin e strategjisë për përmbushjen e rezervës së detyrueshme kishte interesi i rritur i bankave për bonot e thesarit dhe sasia e lartë e mjeteve të vendosura në depozitat në dispozicion me afat shtatë-ditor në fillim të periudhës së rezervës së detyrueshme.

5.4. Operacione-repo për krijimin e likuiditetit në sistemin bankar

Në vitin 2014, Banka popullore ka vazhduar të zhvillojë ankande të rregullta javore për transaksione-repo për të siguruar mbështetjen e likuiditetit dhe në fund të fundit të stimulojë vendosje afatgjate të bankave.⁶⁵ Në ankandet për transaksionet-repo, oferta ishte mesatarisht 520 milionë denarë, ndërsa bankat kishin interes vetëm për gjashtë ankande, në të cilat janë miratuar mesatarisht mjete likuide në vlerë prej 312 milionë denarë (në sasi prej 50 milionë denarë deri në 1,200 milionë denarë).

5.5. Mjetet e sigurimin e zbatimit të operacioneve monetare


Në vitin 2014, Banka popullore e zgjeroi *Listën e letrave me vlerë për kryerjen e operacioneve monetare*, përmes përfshirjes së obligacioneve qeveritare me afat maturimi prej tre viteve deri në dhjetë vjet⁶⁶ dhe i revidoi koeficientët e sigurisë. Kështu, me vazhdimin e maturimit të letrave me vlerë të emetuara të qeverisë në tregun primar dhe rritjen e investimeve të bankave në instrumentet me afatgjata, sigurohet një fleksibilitet më i madh në menaxhimin e likuiditetit të bankave.

Shtojca 2. Tregu i parave

Në vitin 2014, bankat tregtonin në mënyrë aktive në tregjet e parasë⁶⁷, me çka tregtia me depozita ndërbankare ishte më e larta në pesë vjetët e fundit, ndërsa qarkullimi me letra me vlerë arriti nivelin më të lartë historik. Për një qëndrim të pandryshuar të politikës monetare, dhe në drejtim të reduktimit të normave të interesit për depozitat në dispozicion të bankave tek Banka popullore dhe rritja e likuiditetit në ndikimin e faktorëve autonome, normat e interesit të tregut shënuan një rënie të moderuar.


Roli i tregjeve të parasë në procesin e transferimit të efekteve të masave të politikës monetare është i një rëndësie të veçantë për bankat qendrore. Në vitin 2014 në tregjet e parasë në Republikën e Maqedonisë është regjistruar rritje në vëllimin e tregtimit, ashtu që qarkullimi i përgjithshëm në bazë vjetore ishte më e lartë për 71%, kryesisht për shkak të rritjes së tregtimit në tregun ndërbankar të depozitave të pasiguruara.

Grafik 68
Qarkullimi në tregun ndërbankar



Burimi: BPRM.

Grafik 69
Struktura e qarkullimit të segmentit të pasiguar të tregut



⁶⁵ Aukcionet për të siguruar likuiditet për shtatë ditë realizohen një herë në javë, përkatësisht çdo të premte.


⁶⁶ Në vitin 2014, Ministria e Financave për herë të parë emtoi bono qeveritare me maturitet prej dhjetë viteve.

⁶⁷ Tregu i parasë në Maqedoni përfshin segmentet e mëposhtme: Tregu i depozitave të pasiguruara, tregu sekondar i letrave me vlerë afatshkurtra dhe letra me vlerë afatgjata, tregu i depozitave të siguruara (tregu-repo).

Në tregun e depozitave të pasiguruara, analizuar sipas dinamikës, tregtia kishte një prirje rritëse në shtatë muajt e parë. Deri në fund të vitit, në kushte të rritjes së likuiditetit të bankave, kërkesa për mjete likuide është zvogëluar dyfish. Duke analizuar në aspekt të strukturës së maturimit të qarkullimit në tregun ndërbankar të depozitave të pasiguruara, në qarkullim dominonin transaksionet me afat maturimi njëditor, njëkohësisht me rritjen e pjesëmarrjes së transaksioneve me maturitet më të gjatë se një ditë.


Gjatë likuiditetit relativisht të lartë në sistemin bankar, normat e interesit në tregun ndërbankar të parasë me depozita të pasiguruara kishin prirje të moderuar rënëse. Pra, norma mesatare e interesit MKDONIA në vitin 2014 ishte 1.79% dhe ishte më e ulët për 0.07 p.p. në raport me nivelin e vitit të kaluar. Gjithashtu, ulja e normës së interesit për depozitat me afat maturimi prej shtatë ditësh për 0.5 p.p. kumulative, kishte një ndikim të caktuar në formimin e normave të interesit të tregut për depozitat e pasiguruara, me maturitet përkatëse, në mënyrë që në fund të vitit, norma e interesit e depozitave ndërbankare me maturim prej një jave (1.4%) ishte më e ulët për 0.9 p.p në nivel vjetor. Normat e interesit e kotuar SKIBOR në vitin 2014 realizuan një lëvizje rënëse përgjatë lakores së të ardhurave.

Grafik 70
Normat e interesit në tregun e depozitave të pasiguruara




Burimi: BPRM.

Grafik 71
Normat e interesit të kotuara SKIBOR




Grafik 72
Struktura e segmentit të siguar në tregun e parasë



Burimi: BPRM.

Grafik 73
Të ardhurat nga segmenti i siguar në tregun e parasë



Në vitin 2014, rritja vjetore në qarkullim është regjistruar edhe në tregun sekondar të parave, apo është rritur ndjeshëm tregtimi i letrave me vlerë. Tregtimi në këtë segment të tregut arriti në 10% të totalit të tregut në tregun e parasë, që paraqet një tregues të rëndësishëm për thellimin e tregut dhe ishte pothuajse dyfish më i lartë në bazë vjetore, me

çka ka arritur nivelin më të lartë historik (prej 5,939 milionë denarë). Gjithashtu, rritje e qarkullimit është regjistruar tek transaksionet-repo të realizuara me letra me vlerë të qeverisë afatgjate, në kushte të pjesëmarrjes së rritur të këtij lloji të letrave me vlerë në portofolet e pjesëmarrësve të tregut. Gjatë uljes së normave të interesit për letrat me vlerë të qeverisë në tregun primar në vitin 2014, të ardhurat në tregun sekondar të letrave me vlerë të qeverisë kanë lëvizur në një drejtim rënës.

VI. Menaxhimi i rezervave valutore

Menaxhimi i rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: rezervat valutore) është një nga funksionet kryesore të Bankës popullore, në përputhje me Ligjin për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë. Duke pasur parasysh rendimentet e ulëta dhe luhatje të ndjeshme në tregjeve financiare ndërkombëtare, ndarja strategjike e rezervave valutore në vitin 2014 ishte vendosur në mënyrë që të siguron një ekuilibër optimal të plotësimit të parimeve të sigurisë, likuiditetit dhe rentabilitetit nga menaxhimi.

Menaxhimi i rezervave valutore është i lidhur ngushtë me realizimin e politikës monetare, kështu që në këtë drejtim, një pjesë dominuese në strukturën valutore të rezervave valutore ka euroja, me qëllim që të mbështes zbatimin e strategjisë monetare të de facto kursit fiks të këmbimit të denarit kundrejt euros. Mbajtja e një niveli të duhur të likuiditetit të rezervave valutore arrihet duke menaxhuar dy portofole - portofolin e likuiditetit dhe të investimeve, ku:

- Portofoli i likuiditetit ka për qëllim të ketë në dispozicion mjete të mjaftueshme për të përmbushur nevojat ditore për likuiditet të nevojshme për të ndërhyrë në tregun valutor, dhe për të kryer transaksionet e shtetit me jashtë vendit.
- Portofoli i investimeve ka për qëllim të investoj në mjete me afat të gjatë për të arritur fitime më të larta, me çka pjesa më e madhe e investimeve orientohen drejt letrave me vlerë likuide, të cilat në rast të nevojës për likuiditet shtesë, lehtë mund të shndërrohen në para të gatshme pa shpenzime shtesë.

Gjithashtu, në mënyrë që të sigurohet pasuri kombëtare, në kuadër të rezervave valutore mbahet sasi e qëndrueshme e arit, si një përcaktim strategjik për të pasur në dispozicion me mjet financiar me nivelin më të lartë të sigurisë.

6.1. Udhëzime bazë për menaxhimin e rezervave të huaja

Në vitin 2014, zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare ishin nën ndikimin e politikave divergjente monetare të bankave qendrore të SHBA-së dhe Eurozonës. Ashtu që, performanca e dobët e ekonomisë së eurozonës kontribuoi në mbajtjen e rendimenteve jashtëzakonisht të ulëta në tregjet financiare, si në Bashkimin Monetar Evropian, ashtu edhe në vendet e tjera në të cilat Eurozona është një partner kryesor tregtar. Në këtë kontekst, dhe në përputhje me parimet bazë të menaxhimit të rezervave valutore, strategjia e investimeve është përshtatur me kushtet e tregut. Kështu që, është rishikuar struktura e portofolit të likuiditetit, struktura valutore e rezervave valutore, dhe njëkohësisht është **thelluar diversifikimi i rezervave valutore** nëpërmjet shpërndarjes në një gamë më të gjerë të instrumenteve financiare. Banka popullore i ndërmorri **ndryshimet e mëposhtme në drejtimet themelore për menaxhimin e rezervave valutore në vitin 2014:**

- Në drejtim të plasimit të mjeteve nga portofoli i likuiditetit, u zgjerua përfshirja e instrumenteve të pranueshme duke futur investime në letra me vlerë të borxhit të qeverisë me afat maturimi të mbetur prej më së shumti një viti.
- Në drejtim të strukturës valutore, janë rritur investimet në dollarë amerikanë dhe funta britanike, në përputhje me lëvizjet e këtyre valutave kundrejt lëvizjeve të euros (me çka euroja e ka ruajtur dominimin).

- Në kuadër të portofolit të investimeve, u mundësua investimi në letrat me vlerë gjermane dhe franceze të siguruara⁶⁸ në bazë të kërkesave nga autoritetet shtetërore.

Në kontekst të përshtatjes së strategjisë së investimeve janë bërë dhe ndryshimet e duhura në kornizën për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me investimin në rezervat valutore:

- Me zgjerimin e fushës së veprimit të instrumenteve të lejuara brenda portofolit të likuiditetit janë rishikuar kriteret për vlerësimin e kredive afatgjatë për letrat me vlerë të qeverisë të cilat janë pjesë e portofolit të likuiditetit dhe njëkohësisht u vendosën kufijtë për vlerësimin e kredive afatshkurtër për këto plasmane, duke pasur parasysh afatin prej një viti;
- Për të arritur strukturën optimale të investimeve dhe kontrollin e duhur të rrezikut të kredive janë rishikuar edhe kufizimet sasiore sipas llojeve të letrave me vlerë dhe të emetuesve, duke rritur pjesën e letrave me vlerë të emetuara nga shtetet në një valutë të ndryshme nga valuta e tyre kombëtare, dhe nga agjencitë qeveritare;
- Në kushte të vërtetimit të një kornize rregullatore të përmirësuar dhe stabilitetin e sektorit bankar në ekonomitë ku investohen rezerva valutore, është lejuar plasimi i depozitave afatshkurtra në bankat komerciale;
- Në mënyrë që të menaxhohet në mënyrë më efektive rreziku i normës së interesit është themeluar portofoli i letrave me vlerë të cilat mbahen në dollarë amerikanë deri në maturim;
- Është bërë adaptimi i portofoleve të referencës me qëllim që karakteristikat e tyre më realisht të pasqyrojnë kornizën themelore strategjike për investime në rezervat valutore.

6.2. Kushtet për investime në tregjet financiare ndërkombëtare në vitin 2014

Në vitin 2014, ekonomia e SHBA-së regjistroi një normë solide të rritjes së PBB-së (prej 2.4% në bazë vjetore), para së gjithash si rezultat i kontributit pozitiv të konsumit privat dhe të investimeve, duke konfirmuar bazat e forta ekonomike të vendit. Në drejtim të reduktimit të normës së papunësisë dhe ringjalljes së aktivitetit ekonomik në SHBA, gjatë vitit FED vazhdimisht e ka ulur sasinë e blerjeve mujore të letrave me vlerë dhe në fund të tetorit solli vendim për të ndërprerë blerjen mujore të letrave me vlerë, në përputhje me programin e tretë të lehtësimit sasiar (QE3).

Euro-zona gjendej në rrugën e rimëkëmbjes ekonomike dhe realizoi rritje të moderuar (0.9% në bazë vjetore), e cila është e ulët në krahasim me rritjen e SHBA-së. Pavarësisht rimëkëmbjes së ngadaltë ekonomike, një sfidë shtesë në zonën e euros paraqite gjithashtu rënia e inflacionit, i cili ka rënë vazhdimisht dhe ishte dukshëm nën objektivin e periudhës afatmesme (2%). Në rrethana të tilla, në qershor BQE zbatoi paketë për masa stimulimi, të cilat përfshinë ulje të normave bazë të interesit⁶⁹, rritje të likuiditetit në afat të shkurtër dhe zbatimin e operacioneve me objektiva afatgjatë për rifinancim. Për të përmirësuar më tej flukset e kreditit dhe në këtë mënyrë, aktivitetin ekonomik, si dhe për rritjen e pritjeve të inflacionit, Banka qendrore Evropiane në shtator njoftoi se do të fillojë

⁶⁸ Obligacionet e siguruara janë letra me vlerë të borxhit të kolateralizuara nga flukset e mjeteve monetare nga kredi hipotekare apo kredi të sektorit publik.


⁶⁹ Më 05.06.2014, BQE i uli normat e interesit: normën e interesit për operacionet e rifinancimit, nga 0.25% në 0.15%, norma e interesit për kredi njëditore nga 0.75% në 0.40%, dhe norma e interesit të depozitave njëditore nga 0% në -0.10%. Gjithashtu më 09.04.2014, BQE vendosi sërish për të ulur normën e interesit për operacionet e rifinancimit (në 0.05%), normën e interesit të kredisë njëditore (në 0.30%) dhe normën e interesit për depozitat njëditore (në -0.20%).

me zbatimin e masave monetare jo-standardë në formën e programeve për blerjen e letrave me vlerë, të cilat do të zgjasin së paku dy vjet⁷⁰.


Në kushtet e implementimit të politikave divergjente nga ana e BQE-së dhe FED gjatë vitit, është vërejtur edhe zgjerimi i diferencës midis rendimenteve të obligacioneve qeveritare të këtyre vendeve. Në fakt, diferenca midis rendimenteve të obligacioneve qeveritare dhjetë-vjeçare të euro-zonës dhe SHBA-së u rrit nga rreth 105 b.p. në 167 b.p. në fund të vitit, duke reflektuar kryesisht dallimet në rritjen e pritshme ekonomike dhe trajektoreve divergjente në normat e interesit dhe rendimentet. Në të njëjtën kohë, brenda euro-zonës u vërejt ngushtimi i diferencës midis rendimenteve të obligacioneve qeveritare të vendeve kryesore të eurozonës në raport me rendimentet e obligacioneve të ekonomive periferike⁷¹, në kushte të kërimit të pjesëmarrësve të tregut për instrumente me rendiment më të lartë.

Grafik 74


Rendimentet e obligacioneve qeveritare (%)



Diferenca midis rendimenteve të obligacioneve qeveritare amerikane dhe evropiane (në p.p.)



Diferenca midis rendimenteve të obligacioneve qeveritare gjermane dhe italiane (në p.p.)



Lëvizjet në tregjet botërore valutore ishin nën ndikimin e vlerësimit të dollarit amerikan kundrejt valutave kryesore botërore. Pra, politika e relaksuar monetare e BQE-së dhe nga ana tjetër, lëshimi i lehtësimit sasior nga ana e FED, sollën deri tek vlerësimi i dollarit amerikan kundrejt euros. Duke pasur parasysh se valutat kryesore në tregun e këmbimit të huaj tregtohen përmes dollarit amerikan, marrëdhëniet e tyre ndaj euros përcaktohen nga performanca e tyre në raport me dollarin amerikan. Ndërsa, zhvlerësim më të lartë kundrejt euros shënoi Kruna norvegjeze dhe Kruna suedeze⁷². Në anën tjetër, Funta britanike, dollari australian dhe dollarit kanadez shënuan një zhvlerësim të moderuar kundrejt dollarit amerikan krahasuar me euron, gjë që çoi në vlerësimin e tyre kundrejt euros.


⁷⁰ Në tetor është iniciuar Programi për blerjen e obligacioneve të siguruara të denominuara në Euro, të emetuara nga institucionet financiare në euro-zonë (covered bond purchase programme, CBPP3), dhe në nëntor Programi për blerjen e letrave me vlerë të siguruara me aktivin (asset-backed securities purchase programme, ABSPP).

⁷¹ Përhapja e rendimenteve të obligacioneve dyvjeçare ka rënë nga rreth 225 b.p. në 134 b.p., nën ndikimin e uljes së pritshmërisë së rrezikut në euro-zonë.

⁷² Zhvlerësimi i Krunës norvegjeze ishte më i shprehur në gjysmën e dytë të vitit, për shkak se spekulimeve gjithnjë më të theksuara për lehtësimin e politikës monetare nga banka qendrore norvegjeze, të cilat u realizuan në fund të vitit, kur banka qendrore e Norvegjisë e uli normën bazë të interesit nga 1,5% në 1,25%. Zhvlerësimi i Krunës suedeze ishte nën ndikimin e lehtësimit të rëndësishme të politikës monetare nga ana e Bankës Qendrore suedeze, e cila e uli normën bazë të interesit dy herë, në korrik dhe tetor, duke e çuar në nivel prej 0%.

Grafik 75

Lëvizja e kurseve të këmbimit dhe çmimi i arit



Në vitin 2014, çmimi i arit pothuajse mbeti i pandryshuar në baza vjetore⁷³, por gjatë vitit janë regjistruar disa ndryshime. Në gjysmën e parë të vitit, çmimi i këtij metali të çmuar kishte lëvizje të ndryshueshme, me atë që tendenca rritëse ishin të pranishme për shkak të tensioneve politike në Ukrainë dhe kërkesës së rritur nga Kina, përderisa korrigjimi rënës kryesisht ishte për shkak të treguesve të favorshme ekonomike për ekonominë amerikane. Në gjysmën e dytë të vitit 2014, çmimi i arit kryesisht kishte tendencë rënëse, gjë që kryesisht pasqyronte makro indikatorët e favorshëm për ekonominë amerikane dhe forcimin e vlerës së dollarit amerikan, ashtu që ka fundi i vitit çmimi është stabilizuar në një nivel të ngjashëm si ka fundi i vitit të kaluar. Për më tepër, gjatë vitit 2014 vazhdoi rritja e kërkesës për ar nga ana e bankave qendrore, të cilat në bazë neto kanë blerë 477 ton, pra 17% më shumë se në vitin 2013⁷⁴. Ky është viti i dytë me blerje më të lartë neto të arit nga bankat qendrore në 50 vitet e fundit, pas vitit 2012, kur bankat qendrore blenë 544 ton, neto.

6.3. Investimi në rezerva valutore të huaja

Në menaxhimin e rezervave valutore struktura e investimeve është e kushtëzuar nga korniza themelore strategjike, si dhe veprimet e duhura të ndërmarra për të ruajtur fleksibilitet në menaxhimin e rezervave valutore, në kushte të lëvizjeve të paqëndrueshme të tregjeve financiare ndërkombëtare.

⁷³ Në fund të vitit 2014, çmimi i arit ishte 1,199.3 dollarë amerikan/onzë, që është më i ulët se sa çmimi në fund të vitit të kaluar vetëm për 2.25 dollarë amerikan.


⁷⁴ World Gold Council.

6.3.1. Struktura valutore

Gjatë vitit 2014, diversifikimi valutor, që realizohej në kuadër të investimeve të rezervave valutore në dy vitet paraprake, realizohet me respektimin e duhur të përcaktimit themelor strategjik në aspektin e strukturës valutore të rezervave valutore. Në këtë kontekst, në strukturën e rezervave valutore nga aspekti valutor dominojnë mjetet e investuara në instrumente financiare të denominuara në euro me një pjesëmarrje mesatare prej rreth 67%. Pjesëmarrja e dollarit amerikan në strukturën valutore ka regjistruar një rritje të moderuar, me një pjesëmarrje mesatare prej rreth 13% të rezervave. Pjesëmarrja mesatare vjetore të valutave tjera të investimeve ishte 9.8% dhe në krahasim me vitin e kaluar ka regjistruar një rënie të moderuar. Ndërsa, investimet në dollarë amerikanë dhe valutat e tjera gjatë vitit 2014 janë mbajtur në përputhje me kufizimet e parashikuara të investimeve.


Grafik 76

Struktura valutore e rezervave valutore
fondi i muajit



Burimi: BPRM.

mesatare vjetore



Në vitin 2014 pjesëmarrja e arit në strukturën valutore të rezervave valutore shënoi një rënie të moderuar, çka erdhi në kushte të rënies së moderuar të çmimit të arit në tregjet ndërkombëtare, por e cila është kryesisht për shkak të rritjes së sasisë së rezervave valutore⁷⁵, duke mos ndryshuar sasinë e arit në kuadër të rezervave.

6.3.2. Ekspozimi kreditor dhe likuiditetit të investimeve

Siguria e investimit në rezervat valutore ka rëndësi të madhe në përcaktimin e strategjisë së investimeve që zbatohet në Bankën popullore gjatë menaxhimit të rezervave valutore. Në këtë drejtim, në përcaktimin e përfshirjes dhe kufizimeve sasiore të investimeve sipas vendeve, përkrah vlerësimit të lartë afatgjatë të kreditit të dhënë nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, është marrë parasysh dhe vlerësimi i brendshëm i kreditit⁷⁶.

Në përputhje me kornizat e planifikuara të investimeve, pjesa më e madhe e rezervave valutore (mesatarisht rreth 57% gjatë vitit) është investuar në instrumente


⁷⁵ Gjatë vitit 2014, rezervat valutore u rritën për 443.5 milionë euro. Rritja e rezervave valutore ishte kryesisht për shkak të fluksit të mjeteve bazuar në emetimin e Euro-obligacioneve në shumë prej 491,1 milionë euro, që i ka tejkaluar në mënyrë të konsiderueshme daljet për shkak të kthimit të rregullt të borxhit publik dhe pagesave të detyrimeve të shtetit për jashtë vendit. Gjithashtu, vlera e tregut të rezervave valutore u rrit për 70 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së dollarit amerikan.

⁷⁶ Korniza për përcaktimin e vlerësimit të brendshëm të kreditit përfshin disa tregues makroekonomikë (borxhi publik, deficitit buxhetor, norma e rritjes vjetore të PBB-së, bilanci i llogarisë korente, inflacioni), treguesit e tregut (vlerësim që përcaktohet nga tregu) dhe treguesit financiarë (vlerësimi i rrezikut të sektorit bankar dhënë nga agjencioni për vlerësim „Standard dhe Poors” (Standard&Poors)).

financiare të vendeve kryesore të euro-zonës - Gjermani, Francë dhe Holandë, si dhe në institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankave zhvillimore ndërkombëtare (11%). Profili i themeluesve të këtyre institucioneve, niveli i kapitalit në dispozicion, si dhe politikat e kujdesshme operative dhe financiare të aplikuara, kontribuojnë që pjesëmarrësit e tregut të i njohin këto institucione financiare ndërkombëtare si emetuesit e instrumenteve financiare me një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe të sigurisë.

Grafik 77

Struktura gjeografike e rezervave valutore, mesatare vjetore




* Instituc. financ. ndërkomb. dhe banka investuese ndërkomb.

** të tjera: Belgjika, Danimarka, Finlanda, Zvicra, Luksemburgu, Norvegjia, Suedia, Kanada, Australia, Japonia

Burimi: BPRM.

Grafik 78

Struktura e investimeve sipas instrumenteve, mesatare vjetore




Likuiditeti i rezervave valutore është siguruar nga mbajtja e portofolit të likuiditetit në euro dhe në dollarë amerikanë, në aktive afatshkurtra likuide, kryesisht depozita në të parë dhe letra me vlerë afatshkurtër të qeverisë likuide. Likuiditeti i rezervave valutore realizohet nëpërmjet investimeve në letrat me vlerë, të cilat me një pjesëmarrje mesatare prej 80.4% janë më të pranishmet në kuadër të strukturës së rezervave valutore sipas instrumenteve. Gjatë vitit 2014, pjesa më e madhe e investimeve në letra me vlerë, gjegjësisht mesatarisht 68.3%, ishin të orientuara kah letrave me vlerë të qeverisë dhe letrave me vlerë me një garancion qeveritare eksplicit, që mundëson përputhshmëri optimale me parimin e sigurisë dhe parimin e likuiditetit të plasmanit. Pjesëmarrje më të konsiderueshme (13.6%) kishin edhe investimet në instrumente të emetuara nga institucionet financiare ndërkombëtare⁷⁷, të cilat përveç nivelit të lartë të sigurisë të mjeteve të plasuara, kanë edhe të ardhura më të larta në krahasim me letrat me vlerë të qeverisë. Kah fundi i vitit, në kuadër të procesit të diversifikimit të investimeve në instrumente financiare, janë nisur dhe investime në letra me vlerë të siguruar.

⁷⁷ Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Evropiane e Investimeve (EIB), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), Banka Nordike e Investimeve (NIB).


Grafik 79

Struktura e letrave me vlerë nga sipas emetuesve, mesatarisht, vjetore



Burimi: BPRM.

Struktura e letrave me vlerë në aspektin e mundësive për tregtim



Në përputhje me përcaktimin strategjik për kufizimin e ndryshimeve në çmime të shkaktuara nga lëvizjet në tregjet financiare ndërkombëtare mbi realizimet nga investimi i rezervave⁷⁸, gjatë vitit një e treta e investimeve në letra me vlerë janë mbajtur në kuadër të portofolit të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim. Në të njëjtën kohë, për të kufizuar efektet e luhatjeve të çmimeve, rezervat valutore janë investuar në letra me vlerë me kohëzgjatje relativisht të shkurtër të modifikuar (përafërsisht një vit), e cila u rishikua gjatë vitit.

Në vitin 2014, Banka popullore ka vazhduar të përdorë transaksionet e huamarrjes së letrave me vlerë, të cilat realizohen nëpërmjet kontraktimit njëkohësisht të transaksioneve-repo dhe transaksioneve-repo të kundërta⁷⁹. Ari, që zakonisht është një instrument financiar me një rendiment më të ulët të tregut, gjatë vitit u plasua në depozita afatshkurtra tek bankat e huaja komerciale. Gjatë zgjedhjes së bankave me të cilat kryhen këto transaksione, përveç rajtingut afatgjatë, analizohen edhe indikatorë shtesë për shqyrtimin e pozitës afatshkurtër të kredive të bankave të huaja.

6.3.3. Rezultatet nga investimi i rezervës valutore

Në vitin 2014, rendimentet për instrumentet financiare në të cilat investon Banka popullore u mbajtën në nivele të ulëta, ku megjithatë, performancat e arritura nga investimi në rezervat valutore e justifikojnë strategjinë e aplikuar të investimeve. Performanca në portofolet e investimeve në euro e tejkaloi kthimin e indekseve të tregut referencë⁸⁰, duke konfirmuar vendimet e Bankës popullore në drejtim të diversifikimit të strukturës së instrumenteve financiare në të cilat janë investuar rezervat e huaja. Në portofolin e investimeve në dollarë amerikanë performanca devijon pak nga kthimi i indeksit të tregut referencë, për shkak të përbërjes së vetë indeksit, në kuadër të të cilit pjesëmarrja e letrave me vlerë të agjencisë është më e lartë dhe përfshin emetuesit e letrave me vlerë që nuk janë të mbuluar nga strategjia e investimeve të Bankës popullore. Lidhur me vendimin për të investuar në një pjesë të rezervave në valuta tjera, edhe këtë vit konfirmohet arsyeshmëria nga ky vendim i investimeve, me çka kthimi i investimeve në valutë origjinale lëvizte në hapësirë prej 0.97% në 3.59%.


⁷⁸ Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim, në përputhje me praktikën ndërkombëtare të kontabilitetit, deklarohen me koston e amortizuar të blerjes dhe nuk janë subjekt i luhatjeve të paparashikueshme në çmim.

⁷⁹ Për sigurimin e letrave me vlerë të marra hua nga portofoli i Bankës popullore marren letrat me vlerë që plotësojnë kriteret për investimin e rezervat valutore.

⁸⁰ Indeksin referues të çmimeve të letrave me vlerë dhe indeksi i tregut të parasë, i përbërë nga instrumente reale financiare, me kohëzgjatje të modifikuar që korrespondon me kohëzgjatjen primare të portofolit të investimeve.

Shkalla e përgjithshme e kthimit të rezervave valutore në vitin 2014, e cila përveç të ardhurave të realizuara përfshin edhe ndryshimet e vlerësuara të çmimeve, ishte 0.89% në nivel vjetor.

Grafik 80
Kthimi në portofolet e investimeve



Burimi: BPRM.


VII. Roli i Bankës popullore në sistemin e pagesave

Një nga funksionet kryesore të Bankës popullore është të krijojë kushte për një operacion të qëndrueshëm, të besueshëm dhe efikas të sistemeve të pagesave. Për të arritur këtë funksion Banka popullore duke ndjekur praktikën më të mira të bankave qendrore të vendeve anëtare të BE-së, kryen katër role kryesore në sistemet e pagesave: operacionale, mbikëqyrëse, zhvillimore dhe rolin katalizator.

Banka popullore kryen rolin operativ në sistemet e pagesave me menaxhim dhe operim të Sistemit ndërbankar i pagesave të Maqedonisë (MIPS), një sistem pagesash për shlyerje bruto në kohë reale dhe është në pronësi nga Banka Popullore. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë⁸¹ në MIPS në vitin 2014 ka rënë për një, si rezultat i bashkimit të dy bankave, dhe duke përfunduar në dhjetor të vitit 2014 numri arriti në njëzet e tre pjesëmarrës të drejtpërdrejtë. Gjatë vitit 2014 sistemi ka punuar me disponueshmërinë e 100,0%. Sistemi ka përpunuar mesatarisht 20,403 transaksione në ditë, ndërsa numri maksimal i transaksioneve të procesuara në ditë arriti në 67,022. Në vitin 2014, rritja vjetore e numrit të përgjithshëm të transaksioneve të shlyera në MIPS qëndroi në 1.1%, ndërsa vlera mesatare për transaksion shënuar një rritje vjetore prej 6.9% dhe arriti në 609,450 denarë .

Grafik 81

Treguesit për qarkullimin pagesor, sipas sistemeve



Burim: BPRM.


Në vitin 2014, vlera e përgjithshme të operacioneve të pagesave në Republikën e Maqedonisë regjistruar një rritje vjetore prej 5.3% , e cila ishte kryesisht për shkak të rritjes së qarkullimit përmes MIPS, i cili regjistruar një rritje vjetore prej 8.0%. Rritja në vlerën e përgjithshme të operacioneve të pagesave është identike me rritjen e PBB-së nominale në vitin 2014⁸² (5.3%). Korrelacioni i lartë i operacioneve të pagesave së përgjithshme (0.98), qarkullimi i segmenteve MIPS saj (0.95), KIBS (0.99) dhe operacionet e brendshme e pagesave (0.95) me PBB-në nominale tregon se ringjallja e tanishme e aktivitetit ekonomik në vend reflekton pozitivisht në zhvillimet në operacionet e pagesave.

Grafik 82

Treguesit e transaksioneve të pagesave në sistemet e pagesave

⁸¹ Pjesëmarrësit në MIPS në fund të vitit 2014 janë: Banka popullore , katërmëdhjetë bankat komerciale , "Banka e Maqedonisë për përkrahje të zhvillimit" SHA Shkup, Ministria e financave e Republikës së Maqedonisë Fondit për sigurim Shëndetësor të Maqedonisë, "Sistemi ndërbankar i kliringut (KIBS)" SHA Shkup, "Depozituesi Qendrorë e letrave me vlerë" SHA, "Sistemi ndërkombëtar i kartelave-CASYS", "MasterCard International" dhe "Fershped Broker" SHA.

⁸² Të dhënat e vlerësuar, Burimi: Enti shtetëror për statistikë.




Burim: BPRM.

Në vitin 2014, shpërndarja e numrit të mesazheve të pagesave të kryera nga MIPS sipas pragjeve të përcaktuara të vlerës së një mesazhi pagesës individuale, tregon se pjesa më e madhe (22.7%) është e mesazheve të pagesave me vlerë prej 1,000 denarë deri 5,000 denarë, ose rreth 95% e numrit të përgjithshëm të mesazheve të pagesave janë me vlerë më pak se 1 milionë denar. Shpërndarja e vlerës së mesazheve të pagesave të bëra përmes MIPS tregon se pjesa më e madhe (48.4%) e mesazheve të pagesave janë me vlerë mbi 500 milionë, ose mesazhet e pagesave me vlerë mbi 1 milionë denarë llogariten me 95% të xhiros të përgjithshme të realizuara përmes MIPS.

Shpërndarja e transaksioneve të realizuara përmes MIPS në kohë brenda ditës tregon se numri më i madh i transaksioneve (21.5%) janë vendosur në mes të orës 15 dhe 16, ose rreth 80% e transaksioneve janë vendosur në mes të orës 11 dhe 16. Në aspektin e vlerës së transaksioneve, vlera më e madhe e transaksioneve (në një vlerë mesatare e transaksionit prej 4.2 milionë) është vendosur në mes orës 9 dhe 10 (29.1% të vlerës së përgjithshme të transaksioneve gjatë ditës), ndërsa, vlera më e vogël e transaksioneve (3.6%) është e vendosur në mes orës 8 dhe 9 (me një vlerë mesatare për transaksion prej 1.5 milionë denarë).

Grafik 83

Treguesit për ndarjen e mesazheve të pagesave dhe transaksioneve në MIPS⁸³



Burim: BPRM.

Me qëllim të forcimit të *rolit mbikëqyrës* të Bankës popullore në sistemet e pagesave gjatë vitit 2014 Parimet për infrastrukturën e tregut financiar, Korniza për zbulim dhe Metodologjia për vlerësimet⁸⁴ janë përkthyer. Gjithashtu, bashkëpunimi teknik është

⁸³ Mesazhi Pagesor është një formë elektronike e instrumentit të pagesës që mund të përmbajë transaksione të shumta individuale (p.sh., transferim agregat rendi PP32 cila lejon ngarkesën e një kryesor për të transferuar asetet në favor të më shumë përfituesve).

⁸⁴ Parimet për infrastrukturën e tregut financiar përcaktohen nga Komiteti për sistemin e pagesave dhe të shlyerjes pranë Bankës për rregullime ndërkombëtare në Bazel dhe Organizata ndërkombëtare e komisioneve të letrave me vlerë në prill 2012.

realizuar midis Bankës popullore dhe bankat qendrore të shteteve anëtare të BE-së me qëllim të shkëmbimit të përvojave në zbatimin e këtyre parimeve nëpërmjet përshtatjes së kuadrit rregullator për mbikëqyrjen në periudhën e ardhshme.

Në drejtim të arritjes të rolit zhvillimor dhe katalizator i Bankës popullore në sistemet e pagesave, në vitin 2014, Banka popullore përmes Këshillit kombëtar të sistemit e pagesave u përfshirë në mënyrë aktive në procesin e zbatimit të "Strategjisë për zhvillimin e sistemit të pagesave të Republikës së Maqedonisë në periudhën 2013 - 2017". Në këtë kuptim, Banka popullore ka zhvilluar një metodologji të re për mbledhjen e të dhënave mbi statistikën e pagesës në përputhje me kuadrin metodologjik të Bankës qendrore Evropiane, e cila pritet që të përfshihet në akte nënligjore gjatë vitit 2015.

Vazhdimi praktikën e transferimit të njohurive dhe informacionit për sektorin financiar të vendit në lidhje me trendet dhe rritjen në fushën e sistemeve të pagesave në nivel ndërkombëtar, Banka Popullore, në bashkëpunim me bankat qendrore të Holandës dhe Portugalisë, në vitin 2014, organizoi Konferencën Shtatë të sistemeve të pagesave dhe zgjidhje e letrave me vlerë. Konferenca kishte një karakter ndërkombëtar dhe u ndoq nga përfaqësues nga sektori bankar, operatorëve të sistemit të pagesave dhe rregullatorët e infrastrukturës së tregut financiar në vend, si dhe përfaqësues të bankave qendrore të Evropës qendrore dhe Juglindore. Në konferencën u promovua "Libri i Kuq për sistemet e pagesave, kliringut dhe shlyerjes në Republikën e Maqedonisë", lëshuar nga Banka për Rregullime Ndërkombëtare në bashkëpunim me Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë. Përveç kësaj, konferenca paraqiti tendencat e fundit në fushën e pagesave, me theks të veçantë në përfshirjen financiare, shpërndarjen dhe disponueshmërinë e shërbimeve të pagesave, si dhe panel diskutime mbi pagesat me kartë dhe telefonat mobil dhe tregtinë elektronike. Përveç kësaj, në konferencë u prezantuan tendencat e fundit në fushën e pagesave, me theks të veçantë në përfshirjen financiare, shpërndarjen dhe disponueshmërinë e shërbimeve të pagesave, si dhe panel diskutime mbi pagesat me kartë dhe telefonat celular dhe tregtinë elektronike. Në këtë drejtim, konferenca kontribuon për të pasuruar më tej njohuritë e ekspertëve vendas në fushën e sistemeve të pagesave dhe ka një ndikim pozitiv në rritjen e kapaciteteve për të përmirësuar gatishmërinë operacionale të Bankës popullore për t'u anëtarësuar në sistemin evropian të bankave qendrore në fushën e pagesave.

Shtojca 3. Trendet ne pagesat jomonetare

Përparimet në teknologji në fushën e pagesave në botë është transferuar me shpejtësi në qarkullimin pagesor të vendit duke ofruar zgjidhje të reja teknike dhe teknologjike për ekzekutimin e pagesave. Risi e rëndësishme në transferet e kredive në vitin 2014 ka qenë futja e "mikropagesës", dhe përdorimi i telefonit celular në blerjen e produkteve dhe shërbimeve në një sasi të vetme jo më të madhe se 1,000.00 denarë. Gjithashtu, ka vazhduar rritja e shpejtë të transfereve të kreditit të iniciuara nga telefon celular për të kryer lloje të ndryshme të pagesave nga ana e personave juridikë dhe fizikë, të cilët bankat i kanë ofruar për herë të parë në gjysmën e dytë të vitit 2013. Sa i përket pagesave me kartë, viti 2014 u karakterizua nga norma të larta të rritjes vjetore në numrin (318%) dhe vlera (353%) të transaksioneve të iniciuara nëpërmjet internetit.


Në aspektin e llojit të instrumentit të pagesës, në vitin 2014 transferet e kreditit⁸⁵ kanë një pjesë dominuese në vlerën e përgjithshme të realizuar nga instrumentet e

⁸⁵Me ndryshimet metodologjike në vitin 2014, urdhrat në këmbë, duke përfshirë vendimet ekzekutive, janë të mbuluara nën transfertat e kredive të cilat si pasojë pasqyrojnë në numrin dhe vlerën e transfertave të kreditit dhe norma vjetore e rritjes së tyre.

pagesave jomonetare, të cilat përbënin 96%, në krahasim me kartat e pagesës, pjesëmarrja e të cilave është 4%. Kështu, në vitin 2014 vlera përgjithshme e transfereve të kreditit (të letrës dhe urdhërat elektronike), arriti në 3,392 miliardë denar, duke regjistruar një rritje vjetore prej 5.2%. Numri i transfereve të kreditit në vitin 2014 arriti në 67.6 milionë dhe është rritur me një rritje të konsiderueshme vjetore prej 16.6%. Pavarësisht pjesën më të lartë të urdhrave të letrës në kryerjen e transferit të kreditit (72% në numër dhe 66% në vlerën e transfereve të kreditit), numri i transfereve elektronike të kreditit gjithashtu tregon normë të lartë të rritjes vjetore prej 12.9%, ndërkohë që vlera e elektronike e transferit të kreditit ka shënuar një rritje më të moderuar vjetore prej 1.2%.

Grafik 84

Treguesit e instrumenteve të pagesave




Burimi: BPRM.

Në fund të vitit 2014, numri total i kartave në qarkullim lëshuara nga bankat komerciale në Republikën e Maqedonisë arriti në 1,601,445.00, nga të cilat 76.9% janë karta debiti, ndërsa 23.1% janë kartat e kreditit. Përveç kësaj, kartat e debiti përbënin 86.3% të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartë. Në vitin 2014, vlera e përgjithshme e transaksioneve me kartela arriti në 139.3 miliardë denar, duke arritur norma të ngjashme të rritjes prej 3.8% siq në vitin e kaluar. Duke analizuar strukturën në vlerën e transaksioneve të krijuara nga kartave, shënohet rritje e pagesës jomonetare në pikat e shitjes në tregtinë, ose tendencë e reduktimit të tërheqjes së parave nëpërmjet ATM-ve. Gjegjësisht, zgjerimi i vazhdueshëm i pajisjeve për pagesën në tregtinë (POS терминалет) konfirmon trendin ekzistues rritës në prirjen e popullsisë për përdorimin e kartave të pagesës në tregtinë. Në vitin 2014 vlera e transaksioneve për pagesën e shitjes tregtar u rrit me 11.5% me bazë vjetore, me një rritje relativisht të ulët vjetore të tërheqjes para nëpërmjet ATM-ve prej 1.6%.

Grafik 85


Treguesit për operacionet e kartelës



Burimi: BPRM.

Gjatë vitit 2014, numri i përgjithshëm i llogarive të hapura shënuan një rritje të moderuar prej 3.5%. Numri i llogarive të individëve regjistruan një rritje vjetore prej 3.8%, duke e ruajtur pjesën dominuese të numrit të përgjithshëm të llogarive të hapura me 94.6%. Nga ana tjetër, numri i llogarive të hapura të personave juridikë në vitin 2014 regjistroi një rënie të moderuar prej 0.5 % si rezultat i aktivitetit të koordinuar të Bankës popullore, bankat, Regjistri qendror i Republikës dhe "Sistemet ndër bankar të Kliringut" SHA Shkup për fshirjen e llogaritë të subjekteve juridikë të mbyllura. Në vitin 2014, vazhdoi rritja e lartë e hapjes të llogarive për pagesë përmes internetit, me një normë rritjeje vjetore prej 22.0 %. Nga numri i përgjithshëm i llogarive për pagesë përmes internetit, 75.1% janë llogaritë e personave fizikë, dhe 24.9% janë llogaritë e personave juridikë, të cilat regjistruan një rritje më të shpejtë vjetore (23.7%) në krahasim me rritjen e llogarive të personave fizikë (21.4%). Megjithatë, pjesa e llogarive për pagesë përmes internetit në numrin e përgjithshëm të llogarive të hapura është ulët me 3.3% në fund të vitit 2014.

Grafik 86

Treguesit për zhvillimin e të sistemit të pagesave⁸⁶

Burimi: BPRM


⁸⁶ Të dhënat mbi numrin e depozituesve individual janë në dispozicion nga viti 2007.

VIII. Emetimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike në Republikën e Maqedonisë

8.1. Monedha në qarkullim

Sasia e monedhave në qarkullim me datë 31.12.2014 ishte 28,080 milionë denarë dhe në krahasim me sasinë në vitin 2013 regjistron rritje prej 3,035 milionë denarë, ose 12.1%.

Grafik 87
Monedha në qarkullim




Burimi: BPRM

Në strukturën e monedhave në qarkullim në fund të vitit, kartëmonedhat bëjnë pjesë me 97.4%, ndërsa monedhat metalike me 2.6% në vlerën e përgjithshme.

Për sa i përket numrit të monedhës në qarkullim, pjesa e kartëmonedhave është 28.0% (76.7 milionë copë), dhe monedha metalike 72.0% (197.3 milionë njësi).


Pjesë më të madhe në vlerën e përgjithshme të kartëmonedhave në qarkullim e bëjnë kartëmonedhat me emërtim prej 1000 denarë (77.7%) dhe 500 denarë (14.5%). Kartëmonedhat tjera përbëjnë 7.8% të vlerës së përgjithshme të kartëmonedhave në qarkullim. Në vitin 2014, vlera më e madhe të monedhat metalike kanë monedhat me prej 10 denarë (27.5%), 50 denarë (23.5%) dhe 5 denarë (22.1%).

Grafik 88
Pjesëmarrje vlerore e kartëmonedhave në qarkullim, në bazë të emërtimit




Burimi: BPRM

Pjesëmarrje vlerore e monedhave metalike në qarkullim, në bazë të emërtimit




Grafik 89

Pjesëmarrje sasiore së kartëmonedhave në qarkullim, ne bazë të emërimit



Burimi: BPRM

Pjesëmarrje sasiore së monedhave metalike në qarkullim, ne bazë të emërimit




Sipas numrit të sasisë e emetuar, në strukturën përgjithshme, kartëmonedhat me emërtim prej 10 denarë kane pjesëmarrje prej 38.1%, 1,000 (27,7%) dhe 100 (17,5%). Kartëmonedhat e mbetura përbëjnë 16.7% të shumës së përgjithshme të kartëmonedhave në qarkullim. Pjesa më e madhe në totalin e emetuar kanë monedhat metalike me emërtim prej 1 denarë (42,8%).

8.2. Furnizimi i bankave me kartëmonedha dhe monedha metalike

Gjatë vitit 2014, Thesari Qendror i Bankës popullore dhe pesë seksione për trajtimin e qarkullimit të parës jashtë Shkupit, disbursuan para bankave në vlerë prej 27.9 miliardë denarë (rënie prej 14.7% në krahasim me vitin 2013). Në të njëjtën kohë, ata pranuan para nga bankat në vlerë prej 24.9 miliardë (një rënie prej 21.2% në krahasim me vitin 2013). Analiza e strukturës së emërimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike sugjeron se, gjatë emetimit dhe pranimin, kartëmonedha më e zakonshme është emërtim prej 1000 denarë, me një pjesëmarrje prej 36.2% në vitin 2014 (dhe 34.7% në vitin 2013), ndërsa te monedhat metalike mbizotëron prerja prej 10 denarë me një pjesëmarrje prej 24% në vitin 2014 (kundrejt 29.1% në vitin 2013).


Grafik 90

Sasia e parës emituar për bankat
Kartëmonedha



Burimi: BPRM

Monedha metalike



8.3. Përpunimi dhe riciklimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike

Gjatë vitit 2014, gjatë procesit të kontrollit të cilësisë i kartëmonedhave në qarkullim në thesarin qendror dhe në seksionet për qarkullim te parasë në vend, janë të përpunuara të gjitha kartëmonedhat e pranuar. Nga totali i kartëmonedhave të përpunuara, përshkak të lashtësisë dhe dëmtimit 13.6 milionë kartëmonedha janë të shkatërruara (13.9 milionë kartëmonedha në vitin 2013). Kartëmonedhat më të shkatërruara janë me emërtim prej 1,000 denarë dhe 100 denarë (57.3%). Në vitin 2014, të gjitha monedhat metalike në emërtim prej 1, 2, 5, 10 dhe 50 denarë që janë pranuar janë përpunuar, nga të cilat 154 mijë copë u etiketuan si lashtë.


8.4. Ekspertiza për paratë e dyshimta/ falsifikuara

Brenda kompetencave të saj, Banka Popullore, si autoriteti i vetëm për të identifikuar vërtetësinë e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të denominuara në denarë ose në monedhë të huaj, edhe në vitin 2014 me sukses vazhdon të kryejë funksionin e ekspertizës së parave të falsifikuara. Në mënyrë që të forcojë kapacitetin për të zbuluar me saktësi paratë të dyshimta dhe të falsifikuara në vitin 2014, Banka popullore e ka vazhduar me trajnimin e stafit nëpër bankat. Përmes prezantimeve dhe trajtimin e drejtpërdrejtë të parave autentike dhe të falsifikuara, pjesëmarrësit njoftohen me ekspertizën.

Sa i përket numrit të ekspertizave të kryera gjatë vitit 2014, nga 297 kartëmonedha të dyshimta denarike të dorëzuara, ekspertiza profesionale konstatoj që 15 kartëmonedha ishin të vërteta, ndërsa 282 të mbetur ishin kartëmonedha të falsifikuara. Në vitin 2014, numri i kartëmonedhave të falsifikuara të zbuluara është rritur me 31.2% në krahasim me vitin 2013. Nga numri i përgjithshëm i zbuluar të kartëmonedhave të falsifikuara në denarë në vitin 2014 më të zakonshme janë emërtimi në 100, 500 dhe 1,000 denarë. Vlera e përgjithshme e falsifikuara në denarë në vitin 2014 arriti në 123,660.00 denarë dhe ka një peshë të papërfillshme në krahasim me vlerën e monedhës në qarkullim.


Grafik 91

Kartëmonedha të falsifikuara në denarë



Burimi: BPRM

Kartëmonedha të falsifikuara në valutë të huaj



Në lidhje me valutat e huaja të falsifikuara, në vitin 2014 janë të bëra 319 ekspertiza të kartëmonedhave dyshimta të paraqitura, nga të cilat 286 kartëmonedhave janë përcaktuar si të falsifikuara dhe 33 kartëmonedha origjinale. Nga numri i përgjithshëm i kartëmonedhave të falsifikuara, më të zakonshme janë kartëmonedhat në euro (262 copë). Konkluzioni i përgjithshëm është se kartëmonedhat e falsifikuara janë të një cilësie relativisht e varfër, duke lejuar identifikimin e thjeshtë dhe të lehtë të tipareve të tyre. Nga

ekspertiza e teknikës së përpunimit të kartëmonedhave të falsifikuara është përcaktuar se ata janë bërë kryesisht në letër të thjeshtë pa elemente të sigurisë, duke përdorur kompjuterin (për skanim dhe shtypje), apo makinë kopje me ngjyra.

8.5. Shitja e monedhave metalike për çështje koleksionimi

Gjatë vitit 2014, Banka popullore ka vënë në qarkullim dy seri të monedhave metalike për çështje koleksionimi ("Ikonat e shenjtoreve" dhe "Shenjat Zodiac").

Monedhat metalike për qëllime koleksionimi janë unike, përfaqësuese dhe me vlerë të madhe artistike që kontribuon në promovimin e Republikës së Maqedonisë. Interesi në blerjen e monedhave koleksioniste është i rëndësishëm dhe prezantimi i tyre i cili u mbajt më 1 gusht 2014, dhe deri në fund të vitit 333 copë janë të shitur.

IX. Statistika

Banka popullore është një nga organet e autorizuar për kryerjen e anketave statistikore brenda sistemit statistikor kombëtar në Republikën e Maqedonisë. Funkcioni statistikor i Bankës popullore është përcaktuar me Ligjin për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë dhe Ligjin për statistikën shtetërore. Hulumtimet statistikore të kryera nga Banka popullore janë paraqitur në Programin statistikor për hulumtime. Aktualisht, Banka popullore prodhon të dhëna të përgjithshme mbi statistikën monetare dhe statistikave të normave të interesit, të bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare, investimet direkte, borxhi i jashtëm dhe pretendimet, rezerva valutoare dhe likuiditetit në valutë të huaj. Statistikat janë bazë për informimin e publikut në lidhje me mjedisin financiar dhe makroekonomik dhe trendet në Republikën e Maqedonisë, por edhe paraqesin një mbështetje të rëndësishme për vendimet që kanë të bëjnë me funksionet bazë të bankës popullore.

Banka popullore, në kuadër të hulumtimit statistikor në juridiksionin e saj, ndërmerr aktivitete të përhershme për monitorim dhe pajtueshmërisë me standardet statistikore ndërkombëtare dhe evropiane. Për këtë qëllim, Banka popullore vazhdimisht bashkëpunon me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bankën për Rregullime Ndërkombëtare, Bankën qendrore Evropiane dhe Eurostat-in, për përmirësimin e cilësisë së të dhënave në dispozicion, në njërin anë, dhe për shpërndarjen e rregullt të të dhënave statistikore për këto institucione, nga ana tjetër. Aktivitetet më të rëndësishme të kryera gjatë vitit 2014 kanë qenë përputhja me standardet e reja statistikore ndërkombëtare⁸⁷ në fushën e statistikave të jashtme, dhe në përputhje me këto aktivitete, edhe në Shtetet Anëtare të BE-së. Janë ndërmarrë aktivitete të rëndësishme për harmonizimin e mëtejshëm me rregulloret evropiane edhe në kuadër të statistikave të normave të interesit. Ky progres i rëndësishëm në fushën e kërkimeve statistikore është konfirmuar nga vlerësimi në Raportin e Progresit për Republikën e Maqedonisë në vitin 2014, të Komisionit Evropian, ku edhe u vuri në dukje përparimin në krijimin e statistikave të llogarive financiare. Theks i veçantë në Raportin u vu në faktin se statistikën e reja të jashtme janë botuar në seri të qëndrueshme kohore nga viti 1998 deri 2014.

Në veçanti, është bërë progres në statistikën e fushave të mëposhtme:

- Në qershor të vitit 2014, Banka popullore ka publikuar një seri të re të raporteve standarde në fushën e statistikave të jashtme (të bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare (MIP) dhe borxhit të jashtëm bruto dhe pretendimet e jashtme bruto), të përgatitura në përputhje me standardet e reja ndërkombëtare të përcaktuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në Bilancin e Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare Manual (BPM6) dhe udhëzimin e Statistikave të Borxhit të jashtëm (2013). Me qëllim të sigurimit të krahasueshmërisë së të dhënave, Banka popullore ka botuar edhe seri të rishikuara kohore, si dhe shpjegime të reja metodologjike. Për të përmirësuar komunikimin me përdoruesit, informacione të detajuara mbi ndryshimet prezantuese, ndryshimet metodologjike dhe efektet e tyre, janë publikuar në faqen e internetit. Në të njëjtën kohë, institucionet ndërkombëtare (FMN, Banka Botërore, BIS, Eurostat) ka dorëzuar të dhëna të reja të serive kohore mbi statistikën e jashtme, me një prezantim të detajuar të përshtatshëm.

⁸⁷ Manuali i bilancit të pagesave dhe pozicioni ndërkombëtar i investimeve, edicioni i gjashtë, FMN 2009 (BPM6) Balance of Payments and International Investment Position Manual, Sixth Edition IMF 2009.

- gjithashtu, në fushën e statistikave të jashtme, janë ndërmarrë aktivitetet që lidhen me përmirësimin e mbulimit dhe prezantim të detajuar të të dhënave të borxhit të ndërmarrjeve bazuar në kreditë tregtare. Në mënyrë që të sigurohet harmonizim metodologjik i mëtejshëm i burimeve të të dhënave për statistikën e jashtme me standardet e reja ndërkombëtare statistikore, janë miratuar aktet nënligjore të reja të cilat ofrojnë raportim më të detajuar mbi aktivitetet dhe detyrimet nga lloji i marrëdhënieve kapitale me jorezidentët dhe aplikimi tërësisht i ri softuerik për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave është zhvilluar. Sipas planit të aktivitetëve për përmirësimin e komunikimit me gazetarët, softueri i ri i aplikuar ka prezantuar nënshkrimin digjital të të dhënave me certifikata elektronike. Gjithashtu, trajnimi për gazetarët është zhvilluar, të cilat duhet të lehtësojnë raportimin dhe kontribuojnë për një cilësi më të mirë të raportimit statistikor;
- si pjesë e aktivitetëve për krijimin e statistikave të letrave me vlerë, akt i ri nënligjor për investitorët vendas që tregtojnë në tregjet e huaja financiare në parimin sigurinë – pas - sigurisë u miratuan. Për këtë qëllim, bashkëpunimi është themeluar me organet rregullator të fondeve të pensioneve, kompanive të sigurimit dhe fondeve të investimit, për raportimin për investime në letra me vlerë të institucioneve që ata drejtojnë. Për këtë qëllim, është krijuar një program i ri softuerik për mbledhjen dhe procesimin e të dhënave, trajnime për subjektet raportuese janë kryer, dhe raportimi i rregullt fillon në janar të vitit 2015;
- në fushën e statistikave monetare, Banka popullore njoftoi të dhëna të reja mbi statistikën e normave të interesit, në përputhje me standardet evropiane⁸⁸. Seria e re e të dhënave ofron qasje në informata më të hollësishme mbi normat e interesit për kreditë dhe depozitat dhe zgjeron mbulimin e të dhënave. Për të siguruar krahasueshmërinë e të dhënave në kohë, të dhënat e serive kohore për periudhën nga viti 2005 e këtej janë publikuar gjithashtu. Në kuadër të këtyre aktivitetëve, u krijua një sistem tërësisht i ri për transmetimin elektronik të të dhënave, e cila pranë bankave, përfshin edhe shtëpitë e kursimeve si subjekte raportuese;
- gjatë vitit 2014, në fushën e statistikave të llogarive financiare, një sërë aktivitetesh u ndërmor për të krijuar burime të reja dhe më të racionala të përdorimit të të dhënave ekzistuese për nevojat e llogarive financiare. Në kuadër të këtyre aktivitetëve, në bashkëpunim me Zyrën e Statistikave Shtetërore (ZSHS), Banka popullore organizoi trajnime të cilat organizohen për raportimin e kompanive. Gjithashtu, aktivitetet për kompozimin e matricës së flukseve monetare ka vazhduar, me përpjekjet e vazhdueshme për të siguruar konsistencë më të madhe të të dhënave për sektorë të veçantë institucionale;
- në kuadër të angazhimit strategjik për përmirësimin e cilësisë së komunikimit, dhe në përputhje me planin e veprimit të ngritur mbi bazën e anketave për konsumatorët dhe kënaqësinë e raportuesve të kryera në vitin 2013, ishin ndërmarrë një numër i aktivitetëve në pjesën e komunikimit me gazetarët dhe përdoruesit. Në këtë drejtim, Banka popullore ka rritur të dhënat e përcaktuara në dispozicion për përdoruesit, duke përfshirë: për statistikën monetare - të dhëna më të hollësishme tremujore mbi bilanci dhe të anketave e institucioneve

⁸⁸ Rregullorja e BE-së mbi statistikën e normave të interesit ECB/2009/7.

të tjera financiare, nga nën-sektori; dhe për statistikën e jashtëm - të dhëna të detajuara mbi borxhin e jashtëm (sipas maturitetit të mbetur) dhe planin e shlyerjes (sipas sektorit dhe instrumentit) dhe informacionet tremujore mbi borxhin e jashtëm dhe IIP ka filluar të publikohen rregullisht në faqen e internetit të Bankës popullore;

- në tetor të vitit 2014, Banka popullore filloi projektin për zhvillimin e një "depo" të vetme të të dhënave statistikore, e cila ka për qëllim që të sigurojë menaxhimin optimal të bazave të të dhënave statistikore në BPRM, si dhe shpërndarjen e ardhshme për të dhëna më të detajuara deri në Eurostat dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Për të kryer funksionin e saj statistikor, Banka popullore bashkëpunon me organet e tjera të autorizuar për anketat statistikore. Bashkëpunimi ndërmjet Bankës Popullore, ESHS dhe Ministrisë së Financave (MF) në lidhje me shkëmbimin e të dhënave dhe informatave të nevojshme për zhvillimin e llogarive financiare sipas sektorëve, ka përparuar dhe intensifikuar gjatë vitit 2014. Përveç kësaj, në bazë të marrëveshjes së re në shkëmbimin e të dhënave në mes të Bankës popullore dhe ESHS, që përfundoi në janar të vitit 2014, shkëmbimi i rregullt i të dhënave për sektor të njësive institucionale ka filluar, si një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të konsistencës së të dhënave statistikore në nivel kombëtar.

Praktika për përmirësimin e vazhdueshëm të kapacitetit të Bankës popullore në fushën e statistikave, ka vazhduar gjatë këtij viti. Prandaj, praktika e trajnimit dhe bashkëpunimit me disa banka qendrore të Shteteve Anëtare të BE-së përmes Instrumentit të Asistencës së Para-aderimit të vendeve candidate për anëtarësim në BE - TAIEX vazhdon.

X. Funkcioni mbikëqyrës dhe rregullator i Bankës popullore

Në mënyrë që të mbajë një sistem bankar të qëndrueshëm të shëndoshë dhe si një parakusht themelor për stabilitetin financiar, në vitin 2014, Banka popullore ka vazhduar të kryejë mbikëqyrje të rregullt të operacioneve të bankave dhe institucioneve⁸⁹ të tjera të rregulluara, duke kryer kontrollet e plota dhe në shënjestër on-faqe si dhe mbikëqyrja e përhershme off-site nga operacionet e tyre. Së bashku me mbikëqyrjen mikroprudente, banka popullore zbaton analizë të përhershëm makro të kujdesshme dhe në veçanti, analizën e tendencave dhe vlerësimin e rreziqeve më të rëndësishme në sistemin bankar. Sigurisht, kuadri i përshtatshëm rregullator aktualisht në fuqi, në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, është një parakusht themelor për mbikëqyrje efektive bankare dhe një sistem bankar të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Gjatë vitit të kaluar një rregullore e re u miratua mbi rolin dhe përmbytjen e auditimit të jashtëm të bankave, i cili ndër të tjera, sjell harmonizimin me standardet e reja të Bazelit. Përveç kësaj, aktivitetet për caktimin e ashtuquajtura Basel 3, vazhduan në fushat e mëposhtme: 1) standardet e reja të likuiditetit, d.m.th Analiza e artikujve që janë pjesë e pozicioneve të raportit të mbulimit të likuiditetit; dhe 2) harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit vendas me kërkesat në lidhje me komponentët e fondeve të veta të bankës. Banka popullore ka vazhduar për të testuar më tej projekt metodologjinë për përcaktimin e bankave me rëndësi sistimore, për shkak të përshtatjes së saj me karakteristikat e sistemit bankar të Maqedonisë.

10.1. On-site dhe off-site mbikëqyrje

Aktivitetet mbikëqyrëse të Bankës popullore janë të bazuara në të ashtuquajturën qasje mbikëqyrëse të orientuar drejt vlerësimit të rreziqeve në operacionet e bankave. Kjo qasje u prezantua në vitin 2008 dhe është përmirësuar në mënyrë të përsëritur në vitet e fundit.

Së bashku me vlerësimin e rreziqeve, në kuadër të aktiviteteve të saj kontrolluese Banka popullore e vlerëson përputhshmërinë e veprimeve të bankave me rregulloret⁹⁰, veçanërisht në fushën e pagesave, veprimeve të këmbimeve valutore dhe mbrojtjen e konsumatorëve të cilët përdorin kredi konsumatore nga bankat.

Gjatë vitit 2014, Banka popullore ka kryer 24 kontrolle të bankave, 4 kontrollet e shtëpive të kursimeve, 2 kontrolle të ofruesve të transferimit të shpejtë të parave, 42 kontrolle të nën agentet dhe 123 kontrollet e zyrave të këmbimit të autorizuar. Nga kontrollet e bankave dhe shtëpive të kursimeve, dymbëdhjetë ishin kontrollet e rreziqeve. Kontrollet e tjera ishin në pajtueshmëri me rregullat. Në këtë periudhë, është realizuar edhe një kontroll nga një kompani që ofron shërbime ndihmëse në sistemin informativ të një banke.

Kontrollet e rreziqeve janë përqendruar në rrezikun e kredisë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij rreziku për profilin e rrezikut të bankave⁹¹ në Republikën e Maqedonisë, por edhe ndryshimet në aktet nënligjore që rregullojnë menaxhimin e këtij rreziku, zbatimi i të

⁸⁹ Në bazë të Ligjit për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë, banka popullore mbikëqyr dhe kontrollon bankat, shtëpitë e kursimeve, zyrat e këmbimit, kompanitë që kryejnë transferim të shpejtë të parave, kompanitë për emetim e parave elektronike dhe ndërmjetësve në mikropagesat.

⁹⁰ Kontrolli i pajtueshmërisë me Ligjin për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, Ligjit për veprimeve të këmbimeve valutore, Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit në marrëveshjet e kredisë konsumatore, Ligji për transferimin e shpejtë të parave dhe Ligjit për qarkullim pagesor.

⁹¹ Analiza e rreziqeve në sektorin bankar është i mbuluar në Raportin mbi rreziqet në sektorin bankar në vitin 2014.

cilave filloi në vitin 2014. Gjithashtu, disa banka kanë qenë subjekt i vlerësimit të përshtatshmërisë së sistemeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, menaxhimin e sigurisë së informacionit, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e normës së interesit, rrezikun operacional, operacione fitimprurëse dhe të qeverisjes korporative.

Kontrollet kanë treguar se bankat kanë sisteme të kënaqshme të menaxhimit të rrezikut dhe se ata janë përgjigjur me masat korrigjuese të vendosura nga Banka Popullore. Për të përmirësuar rregullat dhe praktikën e përcaktuara për administrimin e rrezikut rekomandimet përkatëse janë dhënë, që në kushtet e rrezikut të kredisë kanë të bëjnë me: përmirësimin e kriterëve në procesin e miratimit, forcimi i kontroleve të dizajnuara për të siguruar përdorimin e duhur të kredive të miratuara, përmirësimin e sistemeve për identifikimin dhe monitorimin e palëve të lidhura, sistemet për përcaktimin e humbjeve nga zhvlerësimi, sisteme për monitorimin e konsumatorit dhe përmirësimin e operacioneve të Departamentit të Auditimit të Brendshëm. Për sa i përket rrezikut të përfshirjes në aktivitete të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, rekomandimet jepen si në vijim: përmirësimin e procesit të përcaktimit të profilit të rrezikut të klientëve në krijimin dhe monitorimin e marrëdhënieve të biznesit, rregullim i duhur i masave dhe aktiviteteve që bankat duhet të marrë në drejtim të klientëve të tyre në varësi të nivelit të caktuar të rrezikut, dhe përkufizimi i mëtejshëm i rregulloreve dhe praktikave të brendshme për sa i përket treguesve për zbulimin e transaksioneve të dyshimta.

Për të përmirësuar sistemet e administrimit të rrezikut operacional, janë dhënë rekomandimet lidhur me: proceset e vlerësimit të riskut, kontrollit administrativ, teknik dhe fizik, veçanërisht në fushën e menaxhimit të parave të gatshme, mënyrën e raportimit të ngjarjeve negative, rishikimi i rregullt i planeve për vazhdimësinë e operacioneve, përmirësimin e angazhimit të organeve të bankës në lidhje me këtë rrezik. Në aspektin e sigurisë së informacionit, rekomandimet janë bërë për të përmirësuar procesin e analizës së rrezikut, të përforcojë masat e kontrollit, për të përmirësuar sistemet e gjurmës së auditimit dhe rekomandimet për alokimin më të përshtatshëm të përgjegjësisë të atyre që janë përfshirë në menaxhimin operativ të sigurisë së informacionit.

Në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i sigurisë së informacionit, një analizë e rreziqeve nga përdorimi i sistemit të vjetruar operativ nga bankat në vend është bërë, standardet për sigurinë e informacionit për shtëpitë e kursimit janë definuar dhe standardet për sigurinë e informacionit në bankat me rëndësi sistemore janë analizuar, me referencë të veçantë për testet e vazhdimësisë në operacionet e tyre.

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta në fushën e licencimit të bankave dhe shtëpive të kursimeve në pajtim me Ligjin Bankar, gjatë vitit 2014 Banka popullore ka kryer 49 procedura për dhënien e licencave dhe lejeve. Licenca për ndryshimin e statusit është lëshuar - fitimin e "Banka postare" SHA Shkup nga "Eurostandard Banka" SHA Shkup, kur "Banka postare" AD ka pushuar së ekzistuari si person juridik. Procedura të tjera të kryera gjatë vitit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 3.

Procedurat e licencimit kryer në vitin 2014

Lloji i lejesë/pëlqimit (bankat)	lëshuar	refuzuar	ndalur
Miratimi për blerjen e 100 % të totalit të aksioneve në bankë	1	/	/
Pëlqim për ndryshimin e statutit	5	/	/
Pëlqim për emërimin e anëtarit të Bordit Mbikëqyrës	27	/	2
Pëlqim për emërimin e anëtarit të Bordit Drejtues	9	/	3
Lloji i lejes /pëlqimit (Banka e Kursimeve)	lëshuar	refuzuar	ndalur
Leja për shndërrimin e kursimeve në institucionet financiare	1	/	/
Totali	43	/	5

Burimi: BPRM

Banka popullore ka realizuar edhe dy procedura të licencimit në pajtim me Ligjin e sistemit të pagesave, në mënyrë që dy kompanive ju është dhënë leje për kryerjen e mikropagesave.

Në vitin 2014 Banka popullore ishte e përfshirë në mënyrë aktive në përgatitjen dhe mbrojtjen e raportit "Manival" (Moneyval) (Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Evropës), në kuadër të raundit të katërt të sistemit të vlerësimit të Republikës së Maqedonisë për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit (në tekstin e mëtejme PPPFT). Në raportin "Manival" është vërejtur progres në aspektin e përputhshmërisë së legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe zbatimin e saj praktik nga subjektet përgjegjëse për zbatimin e masave dhe veprimeve për PPPFT. Duke u bazuar në rekomandimet e "Manival-it" në shtator të vitit 2014, është adoptuar ligj i ri për PPPFT për të cilin propozimet e Bankës popullore janë mar parasysh.

Në maj të vitit 2014 ka filluar procesi i vlerësimit kombëtar të rrezikut ndaj lavanderisë të parave dhe financimit të terrorizmit. Vlerësimi kryhet në përputhje me metodologjinë e Bankës Botërore, dhe në zbatimin e saj marrin pjesë më shumë autoritete dhe subjekte mbikëqyrëse që kanë detyrime në bazë të Ligjit për PPPFT .

XI. Auditimi i brendshëm

Në vitin 2014, Departamenti i auditimit të brendshëm (DAB) plotësisht e zbatojë Programin e vet të punës. Nëpërmjet të një vlerësimit sistematik dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e procesit të menaxhimit të rrezikut, përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe proceseve të menaxhimit, auditimi i brendshëm i kryen objektivat e tija kryesore, duke u dhënë siguri rreth:

1. Përdorimit efikas dhe ekonomik të burimeve;
2. Ruajtjen e mjeteve;
3. Besueshmërisë dhe integritetit të informacioneve financiare dhe të tjera; dhe
4. Përputhshmërisë së operacioneve me ligjet dhe rregulloret, politikat e brendshme dhe procedurat e punës.

Në vitin 2014, janë realizuar 18 auditime të rregullta të 35 proceseve të punës, duke u dhënë 61 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Realizimi i rekomandimeve është monitoruar në baza të rregullta tremujore dhe gjetjet e monitorimit sugjerojnë se rekomandimet kryesisht respektohen dhe zbatohen brenda afatit të caktuar. Në vitin 2014, 96.4% e rekomandimeve janë zbatuar.

Auditimi i brendshëm, përveç operacioneve të rregullta kishte aktivitete shtesë për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e operacioneve të veta. Nga ky këndvështrim, gjatë vitit 2014, Rregullorja e punës së DAB-it dhe procedurat e brendshme të punës janë rishikuar, Udhëzime të detajuara për funksionimin e DAB-it janë zhvilluar, Programi për vlerësimin e brendshëm të funksionimit të DAB-it është aplikuar, dhe bashkëpunim teknik është themeluar me Bankën qendrore të Holandës për zbatimin e strukturës së re të raportit të auditimit, implementimi i auditimeve të shkurtra dhe në fushën e qeverisjes me IT-në (IT governance).

Operacioni i Departamentit të Auditimit të Brendshëm ishte e mbikëqyrur nga afër nga Komisioni i Auditimit, i cili ka mbajtur pesë takime gjatë vitit 2014.

XII. Përmirësimi i kapacitetit institucional i Bankës popullore

12.1. Planifikimi strategjik

Sipas praktikës së vendosur, gjatë vitit ishte sjellë Plani strategjik i Bankës për vitin 2015 - 2017. Në bazë të Planit Strategjik ishin sjellë Udhëzimet për punë dhe Programi për punë për vitin 2015 i cili paraqet përpunim të detajuar të qëllimeve të vendosura dhe udhëzime për të periudhën e ardhshme, në aspekt të bartësve, afateve dhe statusin e realizimit të tyre.

Orientimi kryesor i Bankës popullore në periudhën e ardhshme trevjeçare, edhe me tej është e drejtuar drejt arritjes së suksesshme të qëllimeve kryesore strategjike tashmë të vendosura, inflacion i ulët dhe i qëndrueshëm nëpërmjet strategjisë së mbajtjes së kursit të qëndrueshëm të denarit kundrejt euros, ruajtjes së stabilitetit financiar si një element përbërës i stabilitetit makroekonomik dhe parakusht për arritjen e rritjes ekonomike dhe prosperitetit. Në të njëjtën kohë, Plani strategjik për tre vitet e ardhshme paraqet një vazhdimësi të qëllimeve strategjike të përcaktuara më parë në sferën e krijimit dhe zbatimit të politikës monetare dhe mbështetjes së tregjeve financiare, menaxhimit me rezervat valutore, ruajtjes së stabilitetit financiar, emetimit dhe menaxhimit me kartëmonedhat dhe monedhat, sistemit të pagesave, statistikës, hulumtimit dhe revizioni i brendshëm. Në të njëjtën kohë, Banka Popullore edhe më tej do ta zhvillojë qeverisjen korporative dhe ta thellojë sistemin e vlerave. Në këtë kuptim, do të vazhdojë procesi i krijimit të kapitalit njerëzor kompetent dhe bashkëkohor, krijimit të inovacioneve më të reja teknologjike në proceset e biznesit dhe në zhvillimin e bashkëpunimit me institucione e vendit dhe të huaja.

12.2. Menaxhimi me rreziqet operative dhe sigurimi i vazhdimësisë në punë

Gjatë vitit 2014, është punuar në krijimin e një kornize të strukturuar për identifikimin dhe menaxhimin me rreziqet operationale në realizimin e qëllimeve dhe detyrave strategjike të Bankës popullore. Në drejtim të tillë, ishin studiuar praktikrat dhe standardet të përcaktuara me standardet ndërkombëtare, COSO II (COSO II ERM, Enterprise Risk Management - Integrated Framework), standardi për menaxhim me rreziqet ISO 31000:2009, parimet e Komitetit të Bazelit për mbikëqyrjen bankare, si dhe nga përvojat e disa bankave qendrore, para së gjithash, Banka qendrore Evropiane, Banka qendrore e Holandës, Banka e Polonisë dhe Banka e Italisë.

Në fund të vitit ishte përgatitur Politika për menaxhimin me rreziqet operative, i cili në fakt paraqet një përpunim të vazhdueshëm dhe qartësim i sistemit të vendosur për menaxhim të rreziqeve në Bankën popullore. Qëllimi kryesor i Politikës së menaxhimit me rreziqet operative është që të sigurojë një sistem për menaxhim sistematik, gjithëpërfshirës dhe të koordinuar me rreziqet operationale, me qëllim që të identifikohen ngjarjet që mund të ndikojnë në punën e bankës, ruajtjes së ekspozimi nga rreziqet brenda kornizave dhe realizim i suksesshëm i qëllimeve të Bankës popullore.

Politika për menaxhimin me rreziqet operative përfshinë kornizë metodologjike e cila përfshinë: klasifikimin e rreziqeve, toleranca e riskut operativ dhe procedura për menaxhim me rreziqet operationale.

Duke u nisur nga qëllimet e përcaktuara strategjike, zhvillimi i menaxhimit me rreziqet operacionale duhet të mundësojë:

1) rritjen e efikasitetit të punës nëpërmjet përmirësimit të sistemit për shpërndarje të mjeteve në varësi të nivelit të pranueshëm të rrezikut dhe kostove për tu përballuar me riskun;

2) parashikimin dhe shfrytëzimin më të mirë të burimeve në dispozicion nëpërmjet përcaktimit të rreziqeve më të rëndësishme gjatë realizimit të funksioneve themelore dhe mobilizimit të burimet në dispozicion për tu përballuar me rreziqe e përcaktuar; dhe

3) vendim-marrje më të mirë.


Banka popullore zbaton proces të rregullt dhe të strukturuar të planifikimit, revidim dhe testim të masave të nevojshme për të siguruar mos ndërprerje të punës së proceseve afariste në situata të krizës. Gjatë vitit 2014, njësitë organizative të Bankës popullore relizuan revidimin e planeve për të siguruar mos ndërprerjen e e gjithsej 120 proceseve afariste. Gjithashtu, për të verifikuar mundësinë e zbatimit të planeve për mos ndërprerjen e proceseve afariste në vitin 2014 ishte përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për testim, ishte realizuar trajnim për të punësuarit dhe për disa proceseve afariste u realizua testim i planeve për mos ndërprerje në kushte të ndryshme krize.

12.3. Administrimi i burimeve njerëzore

Banka Popullore është institucion e cila vazhdimisht kujdeset dhe investon tek punonjësit e saj, me qëllim të përforsimit të aftësive dhe kompetencave të tyre dhe rritjen e njohurive profesionale me qëllim të krijimit të një kuadri të kualifikuar, i cili në mënyre adekuate do ti përgjigjet sfidave për realizimin e suksesshëm të qëllimeve të saja. Gjatë vitit 2014, Drejtoria e burimeve njerëzore solli një sërë aktivitete në drejtim të përmirësimit të proceseve të administrimit me burimet njerëzore.

Grafik 92

Struktura e kualifikuar e të punësuarve në Bankën popullore në vitin 2014 (numri i të punësuarve)



Burimi: BPRM.


punësuarve me arsim të mesëm për 7.2%, ndërsa një rritje prej 8.9% shihet tek numri i punëtorëve të cilët kanë përfunduar studimet e magjistraturës. Tek kategoritë e tjera nuk ka ndryshime të mëdha.

Në vitin 2014 numri i përgjithshëm i të punësuarve ka qenë 439, kundërt 441 të të punësuarve në vitin 2013. Në vitin 2014, nuk është vërejtur ndryshim në aspekt të gjinisë dhe strukturës së moshës të të punësuarve në Bankën popullore në krahasim me vitet e mëparshme.

Në vitin 2014, përqindja e grave ka qenë 59%, në krahasim me përqindjen e meshkujve (41%). Në aspekt të strukturës së moshës, moshë mesatare e të të punësuarve ka qenë 44.8 vjeç në vitin 2014, kundërt moshës mesatare prej 44.6 vjeç në vitin 2013. Struktura e kualifikuar shënon rënie në numrin e të të

Grafik 93

Numri i zhvillimeve profesionale



Burimi: BPRM.

të lidhura me cilësinë e punës, sasisë, aftësitë për punë dhe komunikim grupor, si dhe paraqitja e inovacioneve, kreativitetit dhe autonomisë në punën e punëtorëve. Ky sistem shfrytëzohet si një mjet për angazhim më të madh, produktivitet, shfrytëzim të potencialit kreativ të institucionit. Gjithashtu, për kryerjen cilësore të të këtyre proceseve në mënyrë intensive është punuar në zhvillimin e aftësive menaxheriale të të gjithë udhëheqësve në institucion.

Gjatë vitit 2014 janë organizuar gjithsej 279 trajnime profesionale në vend dhe jashtë vendit. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i zhvillimeve profesionale shënon rritje për 19.2%, përderisa numri i të punësuarve të cilët ndoqën trajnime profesionale është rritur për 1.2%. Një rritje të veçantë shënojnë trajnime profesionale të realizuara në vend, të cilët u rritën për 66.2%, për shkak të trajnimeve për ndryshimet aktuale të dispozitave ligjore të cilat janë fushën e punës së Bankës popullore, kundrejt rritjes së lehtë të trajnimeve profesionale të realizuara jashtë vendit, për 2.3 %.

Organizatorët kryesorë të jashtëm për trajnime profesionale janë Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Bankat qendrore të Bashkimit Evropian, me të cilat Banka Popullore bashkëpunon nëpërmes programeve për bashkëpunimit reciprok, ndërsa organizatorët kryesorë të formimit profesional në vend ndodhin qendra në shtëpi për arsim në fushën e mbrojtjes së personale të dhënave dhe ndryshimi i rregullave ligjore (lidhur me punën e Bankës popullore).

Banka popullore e Republikës së Maqedonisë i ndjek trendet në fushën e administrimit të burimeve njerëzore, i nxit të mësuarit të vazhdueshëm dhe zhvillimin e punonjësve e sidomos të kuadrit të ri. Në vitin 2014 u realizuan 16 trajnime të brendshme dyditore, në tetë tema në lidhje me përf forcimin e aftësive të buta të punonjësve në Bankën popullore. Gjithsej shënohen 209 pjesëmarrje, dhe një pjesë e trajnimeve ishin të përkushtuara për zhvillimin e aftësive menaxheriale të udhëheqësve.

Për stimulim të komunikimit të mirë profesional dhe lidhjen më të mirë rrjetore të punonjësve në Bankën popullore, u organizuan gjithsej shtatë ngjarje për ndërtim të grupeve në nivel sektorial. Ngjarjet që lidhen me ndërtimin e grupeve kanë për qëllim zhvillimin e shpirtit të grupeve, sigurimit të sinergjisë dhe kulturës për ndarjen e njohurive në proceset e punës si një vlerë e rëndësishme organizative e institucionit.

Në masë të madhe u avancuan edhe funksioni analitik dhe raportues i administrimit me burimet njerëzore duke përgatitjen e raporteve gjithëpërfshirëse vjetore të cilët i sublimojnë analizat e proceseve dhe aktiviteteve që janë nën mbikqyrjen e saj.

12.4. Veprimtaria kërkimore

Veprimtaria kërkimore e Bankës popullore në vitin 2014 ishte e orientuar në fushat të cilat janë të rëndësishme për arritjen e qëllimeve themelore dhe përforcimin e kapaciteteve institucionale. Në këtë aspekt, projektet e realizuara kërkimore kontribuan për mbështetje të procesit të vendimmarrjes në Bankën popullore dhe të paturit parasysht në kohë të sfidave të ardhshme. Gjatë vitit 2014 u realizuan nëntë projekte kërkimore në lidhje me: analizën e politikave të formimit të çmimeve dhe pagave në Maqedoni, vlerësim empirik i qëndrueshmërisë së borxhit të jashtëm dhe borxhit publik, ndikimi i politikës fiskale në shërimin e post-krizës në vendet evropiane, ndikimi i politikës fiskale në llogarinë rrjedhëse, vlerësim në nivel ekuilibruës së rritjes kreditore për ekonominë e Maqedonisë, ndikimi i politikës monetare në sektorin real të ekonomisë, vlerësimi i ekonomisë informale në Republikën e Maqedonisë, efikasiteti i sistemit bankar. Programi për aktivitetet kërkimore në periudhën nga 2015 deri në vitin 2017, e sjellë në maj të vitit 2014, ishte e plotësuar me projekte të reja në fushën e politikës monetare dhe të transmisionit monetar, stabilitetit financiar dhe të sistemit bankar si dhe në sferën e fushave të tjera. Nga fundi i vitit ishin ndërmarrë aktivitete për avancimin e kornizës së aktiviteteve kërkimore në drejtim të zhvillimit të mëtutjeshëm dhe nxitjen e hulumtimeve.

Më 28 dhe 29 prill 2014, në shenjë të përvjetorit të pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë, u mbajt konferenca e tretë me titull: "Në rrugën drejt rimëkëmbjes dhe rritjes së qëndrueshme në mjedisin e ndryshuar ekonomik" Konferenca ishte e organizuar në gjashtë seancat të cilët mbulonin tema të rëndësishme për bankat popullore, institucionet akademike dhe kërkimore. Në konferenca u prezantuan materialet kërkimore të përfaqësuesve të bankave qendrore dhe institucioneve akademike nga rajoni dhe BE. Në kuadër të kësaj ngjarje ishte ndarë edhe çmimi i rregullt vjetor i Bankës popullore për veprën më të mirë nga hulumtuesi i ri, në fushën e makroekonomisë.

Në kuadër të aktiviteteve për të mbështetje të zhvillimit të aktiviteteve analitike dhe hulumtuese vazhdoi puna e pandërprerë e Klubit të hulumtuesve, i cili mbajti katër seanca kuartale gjatë vitit 2014, në të cilat u prezantuan dhe u diskutuan shumë punime kërkimore shkencore që i adresohen pyetjeve vijuese kërkimore: multiplikatori i investimeve publike dhe konsumit publik, regjimi i kursit të këmbimit dhe rritjes ekonomike, determinatet e kapitalit teprues tek bankat, veprimi i përbashkët i politikës monetare dhe fiskale, efikasiteti i kostos i sistemeve bankare, indekset për stabilitetin bankar dhe aktivitetit kreditues në periudhat e krizës. Gjatë vitit 2014, në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të veprimtarisë kërkimore, Banka popullore realizoi bashkëpunim teknik me bankat e tjera qendrore në sfera të ndryshme të operimit që kanë të bëjnë me punën e bankimit qendror, ku veçanërisht duhet të theksohet bashkëpunimi me Bankën qendrore të Austrisë dhe Bankën qendrore të Holandës. Të punësuarit në Bankën popullore me punimet dhe prezantimet e tyre morën pjesë në shumë konferenca dhe ngjarje ndërkombëtare.

XIII. Aktivitete tjera

13.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë vitit 2014, Banka popullore vazhdoi me aktivitetet për përparimin dhe përforcimin e bashkëpunimit në baza multilaterale, përmes pjesëmarrjes në takimet e rregullta të institucioneve ndërkombëtare dhe të forumeve ndërkombëtare, si dhe në baza bilaterale, duke arritur bashkëpunim me banka tjera qendrore.

Sa i përket Fondit monetar ndërkombëtar (FMN), përfaqësuesit e FMN-së e vizituan Bankë popullore në kuadër të konsultimeve të rregullta në përputhje me nenin IV të Statutit të Fondit, si dhe në kuadrë të mbikqyrjes pas progamit e cila pasonte pas mbylljes së aranzhmani me FMN-ën për linjën kreditore për kujdes. Kurse nga ana tjetër, guvernatori dhe zëvendës guvernatori i Bankës popullore morrën pjesë në takime e rregullta pranverore si dhe në Kuvendin vjetor të FMN-së dhe Bankës Botërore, si dhe në takimin e konstituencës holandeze. Gjatë vitit 2014, gjithashtu vazhdoi bashkëpunimi teknik me FMN-ën për përparimin e statistikës monetare dhe financiare. Sa i përket bashkëpunimit me Bankën Botërore u realizuan një sërë takimesh me përfaqësues të këtij institucioni të ndërlidhura me aranzhmanet aktuale, përgatitjes së raporteve dhe publikimeve të rregullta të Bankës Botërore, si dhe u siguria ndihmë teknike në fushën e stabilitetit financiar. Gjatë vitit 2014, Banka popullore morri pjesë në një pjesë të takimeve të rregullta të Bankës për Rregullim Ndërkombëtar në Bazel, si dhe në takimet e organizuara të Klubit të guvernatorëve të bankave qendrore të rajonit të Detit të Zi, Ballkanit dhe Azisë qendrore. Pas pranimi të Bankës popullore në Iniciativën e Vienës 2, përfaqësues nga BPRM-së morri pjesë në takimet e mbajtur nga ana e këtij forumi. Anëtarësia e Bankës popullore në këtë forum i mundëson pjesëmarrje aktive dhe këmbim të përvojave me qëllim të rrualtjes së stabilitetit financiar në rajon.

Në kuadër të bashkëpunimit me bankat qendrore, Banka popullore e vazhdoi bashkëpunimin teknik të vendosur me Bankën qendrore Holandeze, Bankën qendrore Gjermane, Bankën popullore të Polonisë, si dhe me bankat tjera qendrore të BE-së dhe vendeve në rajon. Edhe këtë vit Banka popullore realizoi bashkëpunim më të frytshëm me Bankën qendrore Holandeze, si partneri strategjik më i rëndësishëm. Përshkak të përparimit të bashkëpunimit bilateral, gjatë vitit 2014 Banka popullore nënshkroi Memorandum mirëkuptimi me Bankën popullore të Kroacisë.

Në vitin 2014 Banka popullore, gjithashtu vazhdoi të marr pjesë në mënyrë aktive në procesin e aderimit të Republikës së Maqedonisë drejt Bashkimit European përmes pjesëmarrjes së saj përkatëse në zbatimin e detyrimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (MSA), në përgatitjen dhe realizimin e Programit vjetor kombëtar për miratimin e të drejtës së Bashkimit European (NPAA), si dhe në kuadër të përgatitjes së Programit kombëtar për reforma ekonomike (NERP). Gjithashtu në maj, guvernatori morri pjesë në Dialogun ministror (EKOFIN) me vendet candidate.

Në kuadër të Progamtit multipërdorues nga instrumentet e para-anëtarësimit, IPA, në vitin 2014 u financuan disa projekte. Banka popullore ka qenë e kyçur në Programin Rajonal për bashkëpunim mes BQE-së dhe bankave qendrore të Ballkanit Perëndimor, qëllimi i së cilës ishte përforcimi i kapaciteteve institucionale dhe përgatitja e tyre për anëtarësim në Sistemin Evropian të bankave qendrore. Gjithashtu, u siguruar përkrahje financiare për pjesëmarrje të përfaqësuesve të BPRM në takimet e rregullta të EUROSTAT-it në fushën e statistikës së bilanceve të pagesave dhe statistikës së llogarive financiare. Në kuadër të

instrumentit për ndihmë teknike të BE-së, me sukses u realizuan 15 projekte, prej të cilave nëntë janë vizita studimore, dy janë misione ekspertësh dhe katër projekte janë punëtori në më shumë fusha të punës së bankës qendror.

13.2. Marrëdhëniet me publikun

Në vitin 2014 Banka popullore vazhdoi të mbaj politikë transparente me qëllim të informimit në kohë të publikut më të gjërë për punën e saj. Informimi i krye përmes komunikimit të rregullt me mediat publiku e cila përfshinte lëshim të njoftimeve për shtypin, dhënie të përgjigjeve të pyetjeve gazetareske, organizimi i intervistave, konferenca për shtyp, dhënia e njoftimeve të shkurtra të dedikuara për gazetarët, si dhe publikimi i përmbajtjeve në internet-faqen (www.nbrm.mk).

Në faqen fillestare të internet-faqes në mënyrë të përditësuar publikoheshin njoftimet e rregullta nga mbledhjet e Këshillit të Bankës popullore dhe të Komisionit për politikë operative monetare të Bankës popullore si dhe njoftime për përdorimin e përdorimin e instrumenteve të politikës monetare, të cilat u publikoheshin në gjuhën Maqedonase dhe angleze. Në të njëjtën kohë, është rritur edhe numri i kumtesave me përmbajtje të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me punën e Bankës. Gjatë vitit 2014 guvernatori dhe zëvendësguvernatori i Bankës popullore kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në shumë ngjarje në të cilat kanë mbajtur fjalime dhe prezantime.

Banka popullore komunikon në mënyrë të drejtpërdrejt me publikun edhe përmes postës elektronike info@nbrm.mk e cila është e vendosur në internet-faqen e Bankës Popullore. Gjithashtu në internet-faqen është e shpallur edhe adresa për qasje të lire tek informatat me karakter public, si dhe adresa contac.statistika@nbrm.mk dhe supervizija@nbrm.mk për parashtrim të pyetjeve dhe përgjigjeve nga fusha përkatëse profesionale.

Gjatë vitit 2014, në internet faqen rregullisht janë azhuruar materialet e vendosura si në gjuhën maqedone ashtu edhe në atë angleze. Me qëllim që të ketë një përkthim kualitativ dhe të shpejtë në gjuhën angleze, nga viti 2014 u fillua të përdoret një mjet i ri softuerik për përkthim. Përveç përmbajtjeve të rregullta, është zgjeruar edhe gama e përmbajtjeve të reja në internet faqen. Është shtuar rubrika "Monedha për qëllime koleksionimi" në të cilën janë publikuar përmbajtje për monedhat e lëshuara nga Banka popullore (të cilat janë ligjërisht janë mjet pagese në Republikën e Maqedonisë).

Banka popullore ka informuar publikun edhe përmes botimit të publikimit vjetor në formë të shtypur për punën e Bankës popullore me titull "Raporti vjetor për vitin 2013". Ky, si dhe raportet tjera vjetore, kuartale, mujore dhe të tjera për punën e bankës, janë të publikuara edhe në formë elektronike në internet faqen e Bankës popullore.

13.3. Edukimi financiar

Në kuadër të projektit "Edukimi financiar" gjatë vitit 2014 u realizuan disa aktivitete për të informuar për së afërmi popullatën me financat dhe ekonominë. Për këtë qëllim, u përgatitën materiale edukative në të cilat janë përpunuar më shumë aspekte lidhur me rolin dhe funksionet e bankës, institucioneve financiare kryesore, kursimeve, produkteve financiare si dhe mbrojtja e përdoruesve të shërbimeve financiare, ku gjithashtu u organizuan edhe ngjarje me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në bashkëpunim me revistat me tirazh më të madh për fëmijët e shkollave fillore, janë publikuar përmbajtje nga më të ndryshmet nga fusha e financave dhe ekonomisë në formën e vizatimeve komike të shkurtra të përshtatura për moshën e nxënësve.

Është përgatitur Politika për edukim financiar, e cila doli si dokument strategjik nga puna e Trupit Koordinues të institucioneve rregullatore për edukim financiar në Republikën e Maqedonisë.

Edukimi financiar është ngushtë i ndërlidhur me informimin e publikut, pasi që edukimi është i dedikuar pikërisht për publikun. Gjatë kohës së mbajtjes së Javës Globale të parave në mars të vitit 2014, u organizua ngjarje publike nën organizimin e Trupit Koordinues, në të cilën morrën pjesë pjesa më e madhe e medie. Gjithashtu, publiku rregullisht informohet për aktivitetet e ndërlidhura me Projektin për edukim financiar përmes kumtesave.

Është vendosur bashkëpunim me shumë organizata dhe institucione ndërkombëtare me renome, dhe atë si vijon: Organizata ndërkombëtare për edukim financiar të fëmijëve dhe të rinjve, Aleanca për përfshirje financiare dhe Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik. Banka Popullore, si institucion partner i këtyre organizatave ndërkombëtare, zbaton iniciativë, organizon aktivitete dhe merr pjesë në ngjarje të ndryshme ndërkombëtare. Konkretisht, në bashkëpunim me Organizatën ndërkombëtare për edukim financiar të fëmijëve dhe të rinjve, u organizua ngjarje publike: Takim i tretë rajonal për edukim financiar për Europë dhe Azi qendrore, i cili u mbajt më 2 dhe 3 Tetor të vitit 2014 në Shkup. Organizator i kësaj konference ishte Organizata ndërkombëtare për edukim financiar të fëmijëve dhe të rinjve kurse nikoqir i ngjarjes ishte Banka popullore.

Me rastin e Ditës Botërore për Kursim, Banka popullore e Republikës së Maqedonisë dhe Agjencioni për mbikëqyrje të sigurimeve hapën konkurs për fëmijë dhe të rinjë, në temat në vijim: "Edhe unë di të kursej" ose "Çfarë do të thotë për mua siguri i shtëpisë dhe familjes". Për këtë qëllim, në Ditë e Kursimit, në hapësirat e Agjencionit u shpërndanë 12 shpërblime të barabarta në para, prej të cilave gjashtë për punime artistike të nxënësve të shkollave fillore dhe gjashtë për vepra letrare të nxënësve të shkollave të mesme.

13.4. Veprimtari muzeore, bibliotekare dhe historike-arkivore

Në përputhje me aktivitetet e planifikuara, gjatë vitit të kaluar Muzeu i Bankës popullore punoi në mënyrë intensive në një varg të gjerë kohor në projektin kërkimor për rindërtim të flukseve monetare në Maqedoninë Jugperëndimore, duke filluar nga shekulli IV para erës sonë, e deri në mbarim të periudhës mesjetare. Aktualisht ky projekt është në fazën përfundimtare para publikimit të saj si ndërveprim ko-botues i Muzeut dhe Entit për mbrojtje të monumenteve kulturore të kulturës në Ohër. Lidhur me kërkimet në fushën e konservimit aplikativ dhe hulumtues, përfundoi ekzaminimi i përbërjes së metaleve prej të cilëve janë bërë produktet të monedhës të Bizantit në fillim të shekullit XIII.

Aktivitetet e bibliotekës dhe arkivit të Bankës popullore gjatë vitit të kaluar kanë përfshirë përcaktimin e kornizës hulumtuese për digjitalizim të dokumentacionit për punën e Këshillit të Bankës popullore për periudhën nga viti 1991 e deri në vitin 1994, të cilat janë të arkivuara në Bankën Popullore, ku veçse ka filluar procesi i përzgjedhjes dhe përshkrimit arkivor të tyre.

13.5. Zhvillimi në fushën e teknologjisë informative

Në kuadër të aktiviteteve të ndërmarra për realizimin e Programit vjetor të Bankës popullore për vitin 2014, dhe me qëllim të plotësimit të nevojave të njësive organizative në bankë dhe nëpërmjet tyre, të publikut më të gjerë, gjatë vitit 2014 në fushën e teknologjisë informative (IT) u punua në më shumë se 4.500 raste pune. Prej tyre, pjesa më e madhe apo 65%, janë kërkesa për shërbime nga katalogu i IT shërbimeve, 24% kanë të bëjnë me zgjidhjen e incidenteve dhe ndihmesë gjatë punës së të punësuarve në lidhje me aplikimin e IT-së, ndërsa 11% kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rregullt të infrastrukturës informative dhe përmirësimin e saj.

Në kuadër të projekteve të zbatuara në vitin 2014 për përmirësimin e IT-së, nga projektet më të rëndësishme është projekti për migrim të tërë të softuerit aplikativ në infrastrukturën e re të IT-së, e cila i përdor versionet aktuale të softuerit sistemor si "Windows" 2012 dhe serverit SQL (SQL server) 2012 e cila është tërësisht e virtualizuar.

Përveç kësaj, në korrik Këshilli i Bankës popullore solli Vendimin për lidhje me sistemin informativ të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë. Me këtë vendim parashikohet lidhja e subjekteve të cilat komunikojnë në mënyrë elektronike me sistemin informativ të Bankës Popullore. Përfitimi më i rëndësishëm nga ky vendim është përshkrimi i aspekteve të komunikimit elektronik si vijon: komunikim formal mes Bankës popullore dhe subjekteve, lidhjet komunikuese elektronike dhe kriteret të cilat duhet ti përmbushin subjektet në komunikimin elektronik për të siguruar qasje të sigurt në sistemin informativ të Bankës Popullore. Ky koncept është thelbësor për sigurimin e qasjes së shpejtë, të sigurtë dhe të kontrolluar, nga ku institucionet mund të zgjedhin më shumë kanale të komunikimit.

Pas hyrjes në fuqi të Vendimit, janë definuar kontakte administrative me 27 institucione në Republikën e Maqedonisë të cilat komunikojnë me Bankën Popullore, janë zbatuar mbi 150 lidhje të komunikimit elektronik në përputhje me parametrat e përcaktuara në Vendim, janë mbajtur trajnime dhe prezantime për personat e përfshirë në zbatimin e Vendimit, si nga Banka Popullore, ashtu edhe nga institucionet tjera me të cilat komunikohet.